

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI MJEKESOR I TIRANËS  
FAKULTETI I MJEKËSISE  
DEPARTAMENTI I SËMUNDJEVE INFKEKTIVE  
DHE DERMATOLOGJISË

## DISERTACION

PËR MARRJEN E GRADS SHKENCORE  
“DOKTOR”

TEMA:

MENAXHIMI KLINIKO-DIAGNOSTIK DHE TERAPEUTIKO-PROFILAKTIK  
I NDËRLIKIMEVE TË BRUCELOZËS NË KOSOVË

Disertanti:


Emine QEHAJA BUÇAJ

Udhëheqës Shkencor:

Prof. Dr. Arben PILACA

TIRANË

2022



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

UNIVERSITETI MJEKËSISË TIRANË

FAKULTETI I MJEKËSISË

DEPARTAMENTI I SËMUNDJEVE INFЕKTIVE DHE DERMATOLOGJISË

## DISERTACION

I PARAQITUR NGA

Znj. EMINE QEHAJA BUÇAJ

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

“DOKTOR”

SPECIALITETI: INFETOLOGJI

TEMA:

”Menaxhimi Kliniko-Diagnostik Dhe Terapeutiko-Profilaktik I  
Ndërlilikimeve të Brucelozës në Kosovë”

MBROHET ME DATË: 22/07/2022 PARA JURISË:

1. Prof. As. Najada Çomo                    KRYETAR
2. Prof. Arjan Harxhi                        OPONENT
3. Prof. Dhimitër Kraja                        OPONENT
4. Prof. Polikron Pulluqi                      ANËTAR
5. Prof. As Ergys Ramosaço                    ANËTAR

## **FALENDERIME**

Falenderoj udhëheqësin tim shkencor, Prof. Dr. Arben Pilaca, për ndihmën dhe përkrahjen e tij të pandërprerë gjatë gjithë periudhës të studimit tim.

Njëherësh falenderoj Prof. Dr Muharem Bajramin për përkrahje të vazhdueshme profesionale si mjeke infektologe, po ashtu edhe gjatë gjithë rrugëtimit të këtij studimi.

Falenderim i veçantë dhe dedikim për familjen time: prindërit e mi Ramadan dhe Nazmie Qehaja, vajzat e mia Erna e Festa, dhe bashkëshorti im Samiri.

## **PËRMBAJTJA**

1. Hyrje.....	13
1.1. Emërtimet.....	14
1. 2. Historiku.....	14
I. 3. Aspekti mikrobiologjik i brucelozës.....	16
1. 4. Rezistenca e brucelave në ambientin e jashtëm.....	17
1. 5. Epidemiologja e brucelozës.....	18
I. 6. Transmisioni i brucelozës në njerëz.....	21
I. 7. Transimsioni interhuman.....	21
I. 8. Transmisioni nga ambienti i kontaminuar.....	21
I. 9. Ekspozimi profesional.....	21
I. 10. Transmisioni alimentar.....	22
I. 11. Faktorët sezonal.....	23
I. 12. Distribuimi sipas moshës dhe gjinisë.....	23
I. 13. Bruceloza e fituar nga udhëtimet.....	24
I. 14. Bioterrorizmi.....	24
I. 14.1. Patogjeneza.....	25
I. 14.2. Përgjegja e bujtësit human.....	28
I. 14.3. Anatomia patologjike.....	30
I. 15. Karakteristikat klinike.....	31

I. 15.1 Bruceloza klasike e ecurisë së zakonshme.....	31
I. 15.2. Format klinike.....	32
I. 15.3. Bruceloza asimptomatike.....	32
I. 15.4. Forma e lehtë (abortive) e brucelozës.....	32
I. 15.5. Bruceloza malinje.....	33
I. 15.6. Bruceloza akute.....	33
I. 15.7. Bruceloza subakute.....	33
I. 15.8. Bruceloza kronike.....	33
I. 15.9. Relapset.....	33
I. 15.10. Reinfekzioni.....	34
I. 16. Format e lokalizuara të brucelozës – Ndërlikimet.....	34
I. 16.1. Lokalizimi osteoartikular.....	34
I. 16.2. Neurobruceloza.....	36
I. 16.3. Meningjiti brucelar.....	37
I. 16.4. Meningoencefaliti.....	37
I. 16.5. Mieliti dhe mielopatitë.....	37
I. 16.6. Bruceloza e sistemit nervor periferik.....	39
I. 16.7. Dëmtimi i rrënjeve të nervave spinal.....	39
I. 16.8. Lokalizimi hepatobiliar.....	39
I. 16.9. Shpretka.....	39
I. 16.10. Sistemi kardiovaskular.....	39
I. 16.11. Sistemi respirator.....	40
I. 16.12. Format më të rralla të lokalizuara të brucelozës.....	40

I. 17. Bruceloza te shtatëzanet.....	41
I. 18. Bruceloza pediatrike.....	41
I. 19. Diagnoza.....	42
I. 19.1. Reaksioni i aglutinimit (reaksioni Wright).....	42
I. 19.2. Rose Bengal testi.....	43
I. 19.3. Testi i fiksimit të komplementit.....	43
I. 19.4. Reaksioni Coombs- antiglobulin.....	44
I. 19.5. Testi i koagulimit.....	44
I. 19.6. Testi i 2-mercaptoethanol aglutinimit ('reduction' reaction).....	45
I. 19.7. Brucelacapt testi.....	45
I. 19.8. Testi kutan alergjik i Burnetit.....	45
I. 19.9. ELISA (Indirect enzyme-linked immunosorbent assays).....	46
I. 19.10. Pika e shpejtë e testev të kujdesit (Rapid point-of-care assays).....	46
I. 19.11. PCR (Polimerase chain reaction).....	47
I. 19.12. Aplikimet në vlerësimin e trajtimit të brucelozës.....	48
I. 19.13. Aplikimet tjera të PCR.....	48
I. 19.14. Hemokultura.....	49
I. 19.15. Diagnozat diferenciale të brucelozës.....	49
I. 20. Terapia.....	50
I. 21. PEP.....	53
I. 22. Prevenimi.....	53
I. 23. Vaksinimi.....	53

II. Qëllimi dhe objektivat e punimit.....	54
II. 1. Metodologja.....	54
II. 2. Analiat statistikore.....	55
III. Rezultatet.....	56
IV. Diskutimi.....	95
V. Përfundimi.....	111
VI. Rekomandimet.....	112
VII. Bibliografia.....	113
Clinical-diagnostic and therapeutic-profilactic managment of complications brucellosis in Kosova.....	137

## **Listë e Tabelave**

Tabela 1. Rastet me brucelozë të trajtuar në Klinikën Infektive, sipas viteve.....	56
Tabela 2. Raste me bruceloze sipas vendbanimeve dhe Komunave.....	57
Tabela 2b. Rastet me brucelozë sipas vendbanimeve dhe Komunave.....	58
Tabela 3. Mosha mesatare e rasteve me brucelozë.....	60
Tabela 4. Mosha mesatare e pacientëve Fshat/ Qytet.....	61
Tabela 5. Pacientët sipas grup-moshës dhe gjinisë.....	63
Tabela 6. Lloji i ekspozimit.....	65
Tabela 7. Numri i rasteve sipas muajve.....	65
Tabela 8. Rastet me brucelozë sipas gjinisë dhe profesionit.....	66
Tabela 9. Anamneza pozitive për brucelozë në familje.....	67
Tabela 10. Kohëzgjatja e hospitalizimit të pacientëve me brucelozë sipas gjinisë.....	68
Tabela 11. Mesatarja e ditëve të hospitalizimit sipas gjinisë.....	69
Tabela 12. Kohëzgjatja e hospitalizmit sipas moshës.....	70
Tabela 13. Mesatarja e ditëve të hospitalizimit ndarë sipas viteve.....	70

Tabela 14. Rastet me brucelozë sipas numrit te hospitalizimeve në klinikën infektive.....	71
Tabela 15. Spitalet/Klinikat e diagnostikimit të parë me brucelozë.....	72
Tabela 16. Pacientët e diagnostikuar në mënyrë ambulantore para hospitalizimit.....	73
Tabela 17. Ecuria klinike e pacientëve të trajtuar në klinikën infektive.....	75
Tabela 18. Rangu i simptomeve kryesore te rastet me brucelozë të përfshira në hulumtim.....	76
Tabela 19. Prezenca e dhembjes sipas lokalizimit dhe gjinisë.....	77
Tabela 20. Simptomat tjera prezente te rastet me brucelozë sipas gjinisë.....	78
Tabela 21. Vlerat e SE te rastet me brucelozë sipas gjinisë.....	79
Tabela 22. Vlerat e eritrociteve sipas gjinisë.....	79
Tabela 23. Vlerat e hemoglobinës te rastet me brucelozë sipas gjinisë.....	80
Tabela 24. Vlerat e leukociteve sipas gjinisë.....	80
Tabela 25. Përqindja e limfociteve ne formulen leukocitare.....	81
Tabela 26. Rezultatet e Trombociteve sipas gjinisë.....	81
Tabela 27. Rezultatet e CRP te rastet me brucelozë.....	82
Tabela 28. Rezultatet e Bil T te rastet me brucelozë.....	82
Tabela 29. Rezultatet e Bil D te rastet me brucelozë.....	83
Tabela 30. Rezultatet e AST te rastet me brucelozë.....	83
Tabela 31. Rezultatet e ALT te rastet me brucelozë.....	84
Tabela 32. Ehosonografia e ekzaminimit të abdomenit.....	85
Tabela 33. Rezultatet e titrit Wright.....	86
Tabela 34. Shkalla e prevalencës së komplikimeve në mesin e pacientëve të egzaminuar..	86
Tabela 35. Prevalenca e llojeve të ndërlikimeve në mesin e të gjithë pacientëve.....	88
Tabela 36. Prevalenca e llojeve të ndërlikimeve sipas moshës.....	89
Tabela 37. Koinfekzionet, pacientet gravide dhe lehonat me brucelozë.....	91
Tabela 38. Trendi i titrit Wright pas 2 jave.....	92
Tabela 39. Antibiotikët e aplikuar për trajimin e pacientëve me brucelozë.....	93
Tabela 40. Kombinimet e aplikuara të antibiotikëve në trajtim të pacientëve.....	93

## **Lista e Grafikoneve**

Grafiku 1. Numri i rasteve sipas viteve.....	56
Grafiku 2. Shpërndarja rasteve me brucelozë sipas komunave.....	59
Grafiku 3. Numri i rasteve sipas vendbanimit rurale dhe urbane.....	59
Grafiku 4. Rastet me brucelozë sipas gjinisë.....	60
Grafiku 5. Mosha mesatare e rasteve sipas vendbanimit rural / urban.....	61
Grafiku 6. Numri i rasteve sipas moshës kategorike.....	62
Grafiku 7. Struktura e rasteve me brucelozë sipas grup-moshës.....	63
Grafiku 8. Struktura e rasteve me brucelozë sipas grup-moshës dhe gjinisë.....	64
Grafiku 9. Llojet e transimisonit të brucelozës.....	64
Grafiku 10. Shpërndarja e rasteve sipas muajve të hospitalizimit.....	66
Grafiku 11. Rangu i rasteve me bruceloze sipas profesionit .....	67
Grafiku 12. Struktura e rasteve sipas kohës së hospitalizimit.....	68
Grafiku 13. Parametrat e kohëzgjatjes së hospitalizimit sipas gjinisë.....	69
Grafiku 14. Mesatarja e ditëve të hospitalzimit sipas viteve.....	71
Grafiku 15. Mesatarja e ankesave në ditë e rasteve.....	73
Grafiku 16. Mesatarja e ankesave sipas viteve.....	73
Grafiku 17. Mesatarja e ankesave sipas moshës.....	74
Grafiku 18. Mesatarja e ankesave sipas moshës kategorike.....	75
Grafiku 19. Rastet sipas ecurisë klinike .....	76
Grafiku 20. Gjetjet patologjike me ehosonografi të abdomenit.....	76
Grafiku 21. Prevalanca e ndërlikimeve në mesin e pacientëve të ekzaminuar.....	86
Grafiku 22. Prevalanca e ndërlikimeve sipas gjinisë.....	87
Grafik 23. Prevalanca e llojeve të ndërlikimeve në mesin e pacientëve të ekzaminuar ...	87
Grafiku 24. Korrelacioni i ndërlikimeve dhe kohëzgjatjes së hospitalizimit.....	89
Grafiku 25. Korrelacioni i ndërlikimeve me Sedimentacionin e gjakut.....	90
Grafiku 26. Korrelacioni i ndërlikimeve me mesataren e Leukociteve.....	90
Grafiku 27. Korrelacioni i ndërlikimeve me Proteinën C-reaktive.....	91
Grafiku 28. Trendi I reaksionit Wright pas dy javë nga fillimi i trajtimit.....	92

Grafiku 29. Kombinimet antibiotike të aplikuara te pacientët me brucelozë .....94

## **Shkurtesat**

B - Brucela

Mb - Megabase, njësi e informatës e barabartë me 1000 kilobite

SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës

MME - Mediterranean and Middle East

H2 – Hidrogjeni

MHC: Major histocompatibility complex

Spp - Species

LPS - Lipopolisaharidi

ORF - Open reading frames

BvrR/BvrS - Komponente të sistemit rregullator të brucelozës

Bp - Binding protein

Hsp - Heat Shock Protein

NK - Natural Killer

IgM - Imunoglobulin M

IgG - Imunoglobulin G

IgA - Imunoglobulin A

TNF - $\alpha$  -Tumor necrosis factor alfa

SNQ - Sistemi nervor qëndror

LTSH - Lëngu truro-shpinor

ALS - Amyotrophic lateral sclerosis (Lou Gehrig's disease)

TBC - Tuberkulozi

ELISA - Indirect enzyme-linked immunosorbent assays

HLA-B 27 - Human leukocyte antigen B27 (protein)

TMP/SMX - Trimetoprim/Suflametoksazol

OBSH - Organizata botërore e shëndetësisë

2-ME - 2 merkaptoethanol

FPA - Imunoesej i polarizimit fluorescent

LFA - Esej i rrjedhjes laterale imunokromatografike

PCR - Polimerase chain reaction

DNA - Acidi deoksiribonukleik

mg - miligram

kg - kilogram

im - intramuscular

iv - intravenoz

PEP - Profilaksa pas ekspozimit

BICHAT - the European Commission's Task Force on Biological and Chemical Agent Threats

SE – Sedimentacioni i eritrociteve

Er - Eritrociti

Hb - Hemoglobina

Le - Leukocitet

CRP – C- reactive Protein

AST - Aspartat aminotransferaza

ALT - Alanin aminotransferaza

Bil T - Bilirubina totale

Bil D - Bilirubina direkte

ECHO - Echosonografija

C/F – Kokso-femorale

Sy - Syndroma

E.Coli - Escherichia coli

## **Menaxhimi kliniko-dagnostik dhe terapeutiko-profilaktik i ndërlikimeve të brucelozës në Kosovë**

**Hyrje:** Në këtë punim prezantojmë pacientët e trajtuar nga bruceloza në klinikën Infektive në Prishtinë dhe përshkruajmë karakteristikat demografike, epidemiologjike, klinike, laboratorike, imazherike, ndërlikimet dhe trajtimin.

**Qëllimi:** Ky studim ka për qëllim të evidentojë aspektet epidemiologjike, klinike, ndërlikimet si dhe menaxhimin terapeutik.

**Materiali dhe metodat:** Të gjithë pacientët e shtruar nga fillimi i muajit janar 2006 deri në mbarim të muajit dhjetor 2011, në klinikën Infektive QKUK në Prishtinë të diagnostikuar me brucelozë janë përfshirë në këtë studim retrospektiv. Me qëllim të realizimit të punimit të dhënat janë marrë nga historitë mjekësore të të sëmurëve të trajtuar në Klinikën Infektive në Prishtinë.

**Rezultatet:** Në studim, janë përfshirë 124 pacientë, mosha mesatare 30.8 vjeç [rangu 2-74 vjet], me 64.5 % mashkuj. Kontakti direkt me kafshët shtëpiake ishte burimi kryesor i transmisionit në 48.4% të rasteve, nga vendbanimet rurale ishin 67.7%. Kohëzgjatja mesatare e hospitalizimit të pacientëve të përfshirë në hulumtim ishte 28.8 ditë. Për diagnostikim kemi përdorur testin e shpejtë të aglutinimit dhe titrin Wright. Me ecuri akute të brucelozës ishin 79.0%. Ndërlikimet më të shpeshta ishin ato osteoartikulare 37.1%. Terapia e kombinuar nga streptomicina dhe doksiciklina në tre javët e para duke vazhduar me doksiciklin dhe rifampicin së paku edhe 3 javët në vazhdim u aplikua në 72.6% të rasteve.

**Konkluzione:** Në Kosovë ndërlikimet më të shpeshta të brucelozës janë osteoartikulare. Rekomandohet trajtimi me kombinimin e tre antibiotikëve.

**Fjalë kyç:** bruceloza, trajtimi, ndërlikimet, titri Wright.

## **1. HYRJE**

Bruceloza, e njohur edhe si “ Ethet undulante ”, “Ethet Mediterane” ose “Ethet e Malta-s” është zoonozë që transmetohet nga kontakti direkt ose indirekt me kafshët e infektuara ose produktet e tyre. Kjo sëmundje atakon njerëzit e të gjitha moshave dhe të dy gjinjët. Edhepse është arritur progres në kontrollin e sëmundjes në shumë vende të botës, ende mbeten vende ku infekzioni perziston në kafshët shtëpiake, dhe në mënyrë konsekutive, transmisioni në njerëz ndodhë shpesh.

Bruceloza është e shpeshtë në shumë pjesë të botës sidomos në vendet Mediterane të Evropës, Afrikën veriore dhe lindore, Lindjen e Mesme, Azinë jugore dhe qëndrore, Amerikën qëndrore dhe Jugore dhe ende është e pa detektuar dhe shpesh e paraportuar (1). Disa vende të botës janë në mënyrë oficiale të lira nga kjo sëmundje infektive edhepse rastet që shfaqen te njerëzit në këto vende janë raste që kthehen nga vendet endemike.

Ekspanzioni i industrisë animale dhe urbanizimi, si dhe masat e dobëta higjienike në blegtori dhe në trajtimin e ushqimit kundër Brucelozës llogaritet të mbetet rrezik për shëndetin publik. Ekspanzioni i udhëtimeve internacionale që mundëson shijimin e produkteve ekzotike të qumështit siq janë djathi i ri i cili mund të jetë i kontaminuar, dhe importimi i këtyre produkteve në vendet e liruara nga bruceloza, gjithashtu kontribon në shfaqjes së brucelozës humane. Kohëzgjatja e sëmundjes dhe konvaleshenca e gjatë tregon që bruceloza është problem i rëndësishëm ekonomik dhe mjekësorë për pacientët sepse humbin kohë për aktivitetet e tyre normale jetësore dhe të punës. Por, diagnoza dhe terapia e shpejtë ka redukuar shumë kohën e paaftësisë për punë.

Sidoqoftë, ekzistojnë shumë vende ku diagnoza dhe trajtimi efektiv, programet për detektimin dhe prevenimin e infeksionit të njerëzve dhe kafshëve nuk janë adekuate. Në këto vende, bruceloza mbetet kërcënim konstant i mirëqenjes njerëzore, posaçërisht për vendet ku popullata është tejet vulnerable në aspektin socio-ekonomik. Sëmundja mund të jetë e fshehtë dhe tinzare dhe të prezentojë forma atipike.

Duhet theksuar se edhe te format e rënda të brucelozës diagnoza diferenciale mund të jetë e vështirësuar. Aplikimi i procedurave laboratorike mirë të kontrolluara dhe interpretimi i mirë i tyre mund të sjellë progres në këtë aspekt. Edhe kur bruceloza në kafshë nuk është nën kontrollë të mjaftueshme ekzistojnë masa të cilat mund të ndërmiren për prevencën e infeksionit në njerëz dhe

të trajtohet personi i infektuar. Bashkëpunimi ndërsektorial në përkrahje të kujdesit primarë shëndetësor luan rol të rëndësishëm në kontrollin e brucelozës dhe mund të kontribojë në zhvillimin e infrastrukturave të përshtatshme në vendet e rritjes së kafshëve, higjienën e ushqimit, dhe kujdesin shëndetësor. Në anën tjetër prevanca dhe kontrolli i brucelozës ka nevojë për aksione mbështetëse nga sektorë të ndryshëm, duke përfshirë përgjegjësinë për ushqimin e sigurtë si dhe edukimin e konsumatorit. Në këto dokumente theksohen masat fundamentale të higjienës së mjedisit dhe të higjienës profesionale si dhe aktivitete për detektimin dhe trajtimin e pacientëve (1).

## I.1. Emërtimet (Synonimet)

Emrat obsolet që janë përdorur më parë për brucelozën humane ishin: Malta Fever, Undulant Fever, Mediterranean Fever, Rock Fever of Gibraltar, Gastric Fever, Cyprus Fever, Napolitan Fever, Melitococcosis, Melitensis septicemia, Brucelliasis, Crimean fever, Satan's fever.

Ndërsa te bruceloza animale: Bang's Disease, Enzootic Abortion, Epizootic Abortion, Slinking of Calves, Ram Epididymitis, Contagious Abortion, Goat fever, etj.

## I. 2. Historiku

Historikisht bruceloza ka qenë e njojur në regionin e Mediteranit, veqanërisht në dhi dhe në dele, që daton nga kohët e lashta. Sëmundjet e tipit të brucelozës kanë qenë të njoitura nga Hippocrates në shkrimet e tij "Epidemics Writings" në vitin 450 para erës sonë. Apostoli Paul ka konsideruar që është infektuar me rastin e përmbytjes s' anijes së tij në ishullin Malta dhe ka lënguar nga sëmundja rekurente ose siq e ka quajtur " Gjemb nën mishin tim " (2).

Në vitin 1853, Jeffery Allen Marston bëri përshkrimin e parë të saktë të sëmundjes te ushtarët e trupave të Armatës Britanike në Malta, gjatë luftës së Crimesë (2).

Në vitin 1887, mikrobiologu David Bruce izoloi kokobacilin Gram negative nga shpretka e rasteve të vdekura, të quajtur më vonë brucella melitensis.

Në vitin 1895, Bernard Bang izoloi brucella abortus nga indi i placentave të lopëve.

Në vitin 1897, M.L. Hughes publikoi një rishikim të karakteristikave klinike dhe patologjike të sëmundjes dhe sygjeroi emrin ethet undulante (2, 242).

Në po të njëjtin vit 1897, Wright dhe Semple arritën sukses në aplikimin e metodës së aglutinimit në serum për diferençimin e brucelozës nga sëmundjet tjera febrile.

Në vitin 1904, u implementua Komisioni për Ethet Mediterane (2).

Në vitin 1905, mjeku grek i cili punonte me mjekun David Bruce, Themistocles Zammit identifikoi dhitë Malteze si kafshë amvise të brucelozës të cilat shpesh nuk kishin shenja klinike të sëmundjes por që kanë qenë burim i infeksionit për ushtarët dhe personelin ushtarak që kanë konsumuar qumshtin dhe produktet e qumështit të papasterizuar të dhive.

Në të mes të viteve 1904-1907 u publikuan raporte të shumta për epidemiologjinë, bakterologjinë dhe patologjinë e brucelozes.

Në vitin 1918, Alice Evans publikoi të dhënata e relacioneve antigjenike në mes të brucella melitensis dhe brucella abortus. Më pas, gjinia u quajt brucellae për ndër të David Bruce.

Tabela 1. Të dhënat bazike mikrobiologjike të brucela specieve

Speciet	Biotipi	Amvisi kafshë	Përshkrimi i parë	Virulenca humane
<b>B. melitensis</b>	1-3	Dhitë, delet, devet	Bruce, 1887	E lartë
<b>B. abortus</b>	1-6, 9	Lopët, devet, biz onët dhe buajt	Bang, 1897	Intermediare
<b>B. suis</b>	1-5	Derrat, lepujt e egër, dreri, kaprolli, brejtësit e egër	Traum, 1914	E ulët
<b>B. canis</b>	-	Qejtë	Carmichael Bruner, 1968	E ulët
<b>B. ovis</b>	-	Delet	Van Drimmelen, 1953	Nuk ka
<b>B. neotomae</b>	-	Brejtësit	Stoenner dhe Lackman, 1957	Nuk ka
<b>B. pinnipediae</b>	-	Balenat Minke, delfinët, derrat e detit dhe fokat	Ewart dhe Ross, 1994	Nuk ka
<b>B. cetaceae ( e perkohshme)</b>				

Në vitin 1924 infekzioni human me Brucela abortus u dokumentua nga Orpen ne Mbretërinë e Madhe. Studimet e ngjajshme në Brucela abortus u kryen nga Morales-Otero në Puerto Rico (239).

Në vitin 1914 Jacob Traum izoloi Brucela suis nga fetuset e abortuara të derrave (Tabela 1), (239).

Në vitin 1953 Van Drimmelen identifikoi Brucela ovis në dele.

Në vitin 1957 Stoenner dhe Lackman identifikuani Brucela neotomae në brejtës (Tabela 1).

Në vitin 1964 Carmichael dhe Bruner identifikuani Brucela canis në qenë.

Në vitin 1994 Ewalt dhe Ross me kolegë, identifikuan *Brucela pinniae* dhe *Brucela cetacear* në balenat Minke, delfin, derra të detit si dhe në foka (Tabela 1) (239,242).

### I. 3. Aspekti mikrobiologjik i brucelës

*Brucela* i takon nëndarjes α-2 të proteobakteres, së bashku me *orchobactrum*, *rhizobium*, *rhodobacter*, *agrobacterium*, *bartonella* dhe *rickettsia* (3).

Ky organizëm është kokobacil Gram negativ, asporogen, i pakapsuluar, fakultativ mbrendaqelizor (4). Karakteristikë e kësaj baktere është që nuk ka faktorë klasik të virulencës siq është kapsula, proteaza të sekretuara, ekzotoksine, endotoksine, pilie dhe fimbriae ose plasmide të virulencës, dhe që lipopolisaharidet e saj nuk janë me patogenitet tipik.

Brucelat janë baktere të vogla me diametër 0.5 deri në 0.7; 0.6 deri 1.5 µm (5,9, 10, 11, 12, 13).

Temperatura optimale për shumëzimin e tyre është 37 gradë Celsius, temperaturat kufitare janë prej 22-40 gradë Celsius. Vlerat optimale të pH sllen prej 6.6 - 7.4.

Brucelat rriten lehtë në terrenet e pasura me mëlcë të kafshëve, me ekstraktin e tharmit. Për rritjen e tyre nevojiten edhe vitaminet. Brucelat janë strikt aerobe, përderisa disa specie të *Brucella abortus* rriten në prezencë të CO<sub>2</sub> (koncetrimi i CO<sub>2</sub> është 5-10%).

Ekzistojnë edhe terrene tjera speciale për rritjen e brucelave si psh Castaneda e cila konsiderohet si terren i shkëlqyeshëm, pastaj Albimi dhe agari me serum dekstrozë. Gati të gjitha tipet e brucelave në metabolizmin e tyre shfrytëzojnë glykozën, shumë prej tyre e zbërthejnë D-ribozën, D-galaktozën, alaninën, asparaginën dhe acidin glutaminik. Brucelat janë oksidazë, katalazë, nitrat, reduktazë dhe ureazë positive.

Për të shkaktuar infeksion te njeriu nevojitet koncentrimi i 10-100 baktere të brucelave.

Gjenomi i brucelës përmbanë 2 kromozome cirkulare njëra ka 2.1 Mb dhe tjetra 1.5 Mb përveç biovar-it të *Brucella suis* i cili ka vetëm një kromozom pre 3.1 Mb.

Janë dy tipe të antigeneve sipërfaqësore të lipopolisaharidit të butë në murin qelizor të cilat janë të emëruara antigen tip A dhe antigen tip B të zbuluara në vitin 1930 nga Wilson dhe Miles. Struktura e ngjajshme antigenike e lipopolisaharidit është përgjegjëse për reaksionet e kryqëzuara me speciet e tjera gram negative si *Francisela Tularensis*, *Escherichia Coli* 0:157, *Pseudomonas maltophilia*, *Yersinia enterocolitica* 0:9, *Vibrio cholera*. Antigeni A është kryesisht te *B. abortus* dhe *B. suis* përderisa antigeni M është antigeni kryesor i *B. melitensis*. Janë të

karakterizuara edhe një mori e proteineve të membranës së jashtme dhe të mbrendshme, citoplazmike dhe periplazmike.

Brucelat kryesisht janë të lokalizuara në organe me shumë makrofagë: mushkëri, melçi, shpretkë, palcë kockore dhe në synovie. Së paku 6 specie janë të njohura, 4 prej tyre janë patogjene për njeriun: *B. melitensis*, *B. abortus*, *B. suis* dhe *B. canis* (4).

Ky organizëm ndodhet në: qumësht, membranat fetale, spermë dhe sekretimet uterine të kafshëve të infektuara.

Reservoaret e infekzionit me Brucela janë: dhitë, delet, devet, gjedhat, lopët, viqat, qejtë, derrat dhe drerët (158). Në terrene të forta pas inkubacionit prej 2-3 ditësh, maximum 1-2 javë lajmërohen koloni të imta konvekse që ngjajnë në pikën e vesës.

Kolonitë janë me madhësi 2-3 mm, mund të paraqiten në tri varijetete “S”, “R”, dhe “M”. Kolonitë me formë “S” janë të tejdukshme, ato në formën “R” janë të turbullta përderisa kolonitë me formë “M” janë viskoze (7,8,9,10,11,12,13).

#### I. 4. Rezistenca e Brucelave në ambientin e jashtëm

Në ambientin e jashtëm Brucelat mbijetojnë rreth 40 ditë, në ujë 6 deri 150 ditë, në tokë dhe pluhur ku nuk ka prezencë të rrezeve të diellit 6-10 javë. Përndryshe brucelat janë të ndijshme në dritën e diellit por arrijnë ti rezistojnë ngase janë të mbuluara kryesisht me sekrete dhe ekskrete të kafshëve si dhe në dezificantë, sidomos në tretësirën e fenolit (10 gram fenol në një litër ujë i mbyt brucelat për 15 minuta). Tretësira e formaldehidit është shumë efikase, me të mund të kryhet dezinfektimi edhe kur temperatura është më e ulët se 15 gradë Celzijus. Tretësirat me fenol dhe alkool përdoren edhe për dezinfektimin e lëkurës. Brucelat në fetusë të abortuar jetojnë 75 ditë. Temperatura e pasterizmit të qumështit prej 65 gradë Celzijus i mbyt brucelat për 30 minuta. Në djathin e ri mund të jetojnë deri në 100 ditë, në kos rreth një muaj, në kefir 11 ditë në gjalp 25-142 ditë. Brucelat kanë rezistencë relativisht të mirë në temperaturë të ultë p.sh. në temperaturë prej -15 gradë Celzijus jetojnë 100-300 ditë, në -23 gradë Celzius rreth një muaj (29)

## I. 5. Epidemiologja e brucelozës

Vlerësohet se 60% e patogenjave human emergjent në mbarë botën janë zoonozat (17). Brucelozë është infekzion i rëndomtë në tërë botën që raportohet në 56 shtete (14). Gjithashtu, mbi 500,000 raste të reja të brucelozës raportohen në vit (18).

Sidoqoftë, shkalla e incidencës së raportuar në vit e brucelozës humane në zonat endemike në mbarë botën varirojnë  $< 0.01$  deri në  $>200$  raste për 100.000 njerëz.

Në vitin 2005, shkalla e incidencës së raportuar në vit për 100,000 njerëz ishte: 160.30 në Siri, 60.60 në Mongoli, 26.20 në Turqi dhe 21.40 në Arabinë Saudite (19).


Epidemiologja e brucelozes humane ka ndryshuar në mënyrë dramatike në 25 vitet e fundit, për shkak të arsyeve të ndryshme sanitare, socioekonomike, politike dhe përveç kësaj edhe të evolucionit të udhëtimeve internacionale në erën e globalizimit.

Regjione të shumta të cilat janë konsideruar tradicionalisht si endemike siq janë Franca dhe Amerika Latine, kanë arritur kontrollin ndaj kësaj sëmundjeje (18). Në disa vende siq janë Portugalia, Spanja, Tunizia dhe Jordania, incidenca e brucelozës në mënyrë signifikante është ulur. Përkundër kësaj, incidenca është në rritje në vendet siq janë Turqia, Algjeria, në regjione të shumta të Evropës jugore dhe në Afrikë, përderisa situata në vende të tjera si Siria është përkeqësuar në mënyrë rapide.

Njëzet e pesë shtete në Lindjen e afërt mbajnë rekordin e sëmundjes dhe 6 prej tyre raportojnë 90.000 raste të reja në vit (14).

Për brucelozë, strukturat gjeografike në mënyrë konstante janë duke ndryshuar me vatra të reja emergjente dhe ri-emergjente. Arsyet dhe spjegimet për rishfaqjet dhe për rritjet e fundit të incidencës së brucelozës përfshijnë: ndryshimet socioekonomike, luftërat dhe turbulencat politike në disa vende të MME, programet joadekuante të kontrollit në disa vende, liria e udhëtimeve të njerëzve së fundmi, transporti i pakontrolluar i kafshëve nëpër kufijtë e hapur (14, 15, 16, 21, 22, 239, 242).

Figura 1: Incidenca e brucelozës humane në botë



Faktorët e rrezikut për infeksionin me brucela përfshijnë: konsumimi i qumështit dhe produkteve të qumështit të papasterizuar, kontakti direkt me kafshët dhe produktet e tyre, gjinia mashkullore dhe mosha mes 40 deri 49 vjeçare (19,20, 23, 24, 25, 26).

Bruceliza është sëmundje profesionale që përbën rrisk për: barinjët, punëtorët në therëtore, veterinarët, profesionistët e industrisë së qumështit dhe mishit dhe personeli në laboratoret mikrobiologjike (27).

Shtamet e brucelave janë izoluar nga gjitarët tokësorë dhe detarë. Në mënyrë eksperimentale, speciet e izoluara në gjitarët detarë nga fokat e portit Pacifik kanë përfshirë serokonverzim dhe abort në lopë. Së fundmi, brucelat nga gjitarët detarë janë identifikuar në 2 pacientë në Peru me neurobrucelozë dhe granuloma intracerebrale (28).

Në Kosovë rastet e para me brucelozë janë paraqitur në vitin 1980 me tetë raste (29). Sipas një hulumtimit të bërë në Kosovë në vitin 2001 nga British Veterinary Association, ekzaminimi i kulturave të qumështit të lopëve në katër raste ka rezultuar me izolim të *B. melitensis* biovar 3 dhe nga gjaku i deleve në një rast. *B. abortus* biovar 2 është izoluar nga qumështi i lopës në një rast, dhe *B. abortus* biovar 1 është izoluar nga delet në dy raste. Ndërsa shtam i paspecifikuar i *B. abortus* ka qenë i izoluar në një rast nga gjaku i deles (L. Pite, personal communication). Sidoqoftë prevalenca më e madhe e brucelozës është konstatuar në dele dhe dhi se sa në lopë dhe gjedhe dhe

me predominim të B. melitensis sepse këto kafshë janë bujtës natyror të saj. B. abortus është e rrallë në dele e dhi.

Sipas të dhënave të Institutit Kombëtarë të Shëndetit Publik të Kosovës, para vitit 1985 kanë qenë të raportuara më pak se 10 raste me brucelozë, trendi i paraqitjes së rasteve të reja me brucelozë ka vazhduar gjatë periudhës 1985-1989 me incidencën më të lartë në regjionin e Prizrenit dhe Lipjanit.

Në vitin 1991, janë raportuar 241 raste dhe incidenca vjetore gjatë viteve 1990-ta ka qenë mes 3-5 raste në 100,000 banorë (30).

Gjate periudhës 2000-2004 në 11 komuna të Kosovës, mesatarja e morbiditetit ka qenë 2.97/100,000 banorë.

Mesatarja më e lartë e brucelozës humane ishte në regjionin e Prizrenit me 211 raste respektivisht 8.29/100,000, është konkluduar se regjioni i Prizrenit është regjion endemik me incidencën më të lartë në Kosovë me brucelozë humane (31).

Brucelozë edhe me tutje paraqet problem shëndetësor dhe social në Kosovë. Sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës, incidenca më e lartë e rasteve me brucelozë sa i përket periudhës nga viti 2006-2011 ishte në vitin 2010 me MB 4.9/100,000 banorë .

Tabela 2. Rastet dhe Incidenca e brucelozës në Kosovë, 2000-2011

Vit	Brucelozë	
	Rastet	MB/100.000
2000	91	4.3
2001	81	3.8
2002	73	3.4
2003	54	2.56
2004	86	4.08
2005	41	1.9
2006	58	2.7
2007	57	2.7
2008	73	3.5
2009	64	3.04
2010	105	4.9
2011	65	3.08
		Totali 3.3

## **I. 6. Transmisioni i brucelozës në njerëz**

- Ekspozimet profesionale - kontakti direkt me kafshë të infektuara
- Transmisioni me anë të ushqimit
- Transmisioni nga ambienti i kontaminuar
- Transmisioni interhuman

**I.7. Transmsioni interhuman:** është mjaft i rrallë. Janë raportuar raste të rralla ku evidencat jo të hollësishme sygjerojnë për kontaktin seksual si rrugë të transmisionit.

Signifikancë me potenciale është transmisioni nëpërmes donacionit të gjakut ose të transplantimit të indeve.

Transferi i palcës kockore veçanërisht bartë signifikancë të rrezikut (32,33,34,35).

**I. 8. Transmisioni nga ambienti i kontaminuar :** është vështirë të dokumentohet por me gjasë ndodh më shpesh se sa që është e njojur. Kafshët e infektuara të cilat kalojnë nëpër zonat e populluara ose mbahen afér shtëpive mund të prodhojnë kontaminim të lartë të rrugëve, oborreve dhe vendeve ku mbahen tregjet, posaçërisht nëse ndodhin abortet e tyre.

Nga kjo mund të rezultojë inhalimi i brucelave si pasojë e ekspozimit ndaj pluhurit të kontaminuar, fekaleve të thara etj. Infekzioni mund të zhvillohet edhe me kontaminimin e lëkurës dhe të konjuktivave nga sipërfaqet e ndotura.

Burimet e ujit siq janë puset, gjithashtu mund të jenë të kontaminuara nga kafshët që së voni kanë abortuar ose me anë të qarkullimit të ujit të shiut nga zonat e kontaminuara.

Brucelat mund të mbijetojnë për kohë të gjatë në pluhur, në feqe dhe sekrete viskoze, fetuse të abortuara, baltë, mish dhe produkte të qumështit e që mvaret nga shumë faktorë siq është natyra e substratit, numri i organizmave, temperatura, pH, rrezet e diellit, prezenca e kontaminuesve tjerë mikrobial.

**I. 9. Ekspozimi profesional:** disa profesione janë të ndërlidhura me rrisk të lartë të infeksionit me brucelozë. Këtu bëjnë pjesë njerëzit të cilët punojnë në ferma të kafshëve sidomos të lopëve, gjedhave, deleve, dhive dhe derrave: fermerët, punëtorët e fermave, barinjët, qethësit e deleve, mbajtës të dhive, mbajtës të derrave, veterinarët dhe ndihmësit e veterinarëve, të gjithë këta janë në rrisk të lartë nga kontakti direkt ose nga ekspozimi në ambientit shumë të kontaminuar.

Infekzioni mund të zhvillohet me inhalim, ingestion aksidental, kontaminim të lëkurës sidomos lëkurës me abrazione dhe mikrolezjone, si dhe vetë-inokulum aksidental me vaksinë të gjallë. Familjet e fermerëve, ruajtësit e kafshëve mund gjithashtu të jenë në rrisk të madh nga ekspozimi i vazhdueshëm pasiqë kafshët mbahen shumë afër vendbanimeve të tyre.

Në disa regjione, kafshët mbahen në oborre të shtëpive dhe mund të futen dhe mbrenda, sidomos gjatë motit të keq. Gjithashtu edhe fëmijët në veçanti janë të rrezikuar sepse ata lozin me kafshët e posalindura.

Në disa regjione ata mund të jenë i vetmi grup që manifestojnë simptome akute të sëmundjes përkundër anëtarëve adultë dhe të moshuar në familje, sepse ata mund të jenë me infeksion kronik. Personat të cilët miren me zhvillimin e produkteve të kafshëve mund të jenë gjithashtu në rrisk të lartë nga ekspozimi ndaj brucelozës. Këtu hyjnë, kasapët, paketues (ambalazhues) të mishit, punëtorët ilegal të lëkurës dhe leshit të kafshëve, punëtorët e qumshtit etj. Personeli i cili punon në laboratore për kultivimin e brucelave janë gjithashtu me rrisk të lartë. Në disa vende në të cilat bruceloza nuk është më endemike, mund të jetë rrezik potencial nga neglizhimi ose konsiderimi i mëtejshmë jo relevant.

Inhalimi i aeroslove gjatë manipulimeve në hemokultura paraqet rrezik të lartë, sidomos nëse ndodh thyerja e kontejnerëve gjatë procesit të centrifugimit.

Përgatitja dhe aplikimi i vaksinës së gjallë gjithashtu paraqet rrezik nga shtami *B. abortus* S19 dhe *B. melitensis* Rev 1 të cilat nuk janë avirulente për njeriun (32,33,34,35, 36, 37).

**I. 10. Transmisioni alimentar:** zakonisht burimi kryesor i brucelozës te popullata urbane është transmisioni alimentar. Konsumimi i qumështit të freskët ose produkteve të qumështit të papasterizuar është burimi kryesor i infeksionit në shumicën e popullatës.

Qumështi i kontaminuar i lopëve, deleve, dhive ose deveve i kontaminuar me *B. melitensis* është posaqërisht i rrezikshëm nëse është i konsumuar në sasi të madhe ngaqë mund të përmbajë numër shumë të madhë të organizmave. Gjalpi, kremi ose akullorja e përgatitur nga një qumësht i tillë gjithashtu paraqet rrezik të lartë. Djathi i ri ose i butë i deleve dhe i dhive me shtimin e majës-mullëzës (ujë ose tharmë djathi) posaqërisht janë burim i shpeshtë i infeksionit në vendet Mediterane dhe të Lindjes së mesme dhe të largët.

Djathrat e forta të prodhua nga fermentimi laktik dhe propionik paraqesin rrisk më të vogël se sa djathrat e butë. Njësojë edhe jogurti ose kosi janë me rrisk më të vogël. Brucela vdes mjaft shpejtë kur aciditeti është nën pH 4, edhe më shpejtë kur është pH nën 3.5.

Mjetet e transportimit ose të procesimit të qumështit të kontaminuar dhe produkteve tjera të qumështit mund të kontaminojnë produktet tjera të pakontaminuara nëse mungon praktika adekuate e higjenës. Produktet e mishit janë më rrallë të ndërlidhura me infeksionin, kryesisht për shkak që ato nuk konsumohen të gjalla. Indet muskulare zakonisht përbajnjë koncentrim të ulët të brucelave, por mëlçia, veshkët, shpretka, gjinjët dhe testisët mund të përbajnjë koncentrim të lartë të brucelave.

Perimet e pa përgatitura termikisht mund të jenë gjithashtu të kontaminuara nga kafshët e infektuara dhe të paraqesin rrisk. Në vendet endemike, turistët duke konsumuar produkte “etnike” ushqimore mund të jenë veqanërisht të rrezikuar.

Personat me ahlorhidri që rezulton nga shkaqet shëndetësore që marin antacide ose antagonist të H<sub>2</sub> mund të kenë rrisk më të lartë për të fituar brucelozën nga konsumimi i ushqimeve të kontaminuara. Personat me imunodeficiencë ose me trajtim me agjentë imunosupresiv gjithashtu janë me rrisk të lartë nga bruceloza e formave të rënda (32,33, 34, 35, 36, 37).

**I. 11. Faktorët sezonal:** në vendet me klimë të butë ose të ftohtë ka variacione në incidencën e brucelozës akute, me paraqitjen e rasteve kryesisht në pranverë dhe verë.

Kjo sezonë koincidon me pikun e periudhës së aborteve dhe lindjeve të kafshëve në ferma prandaj ekspozimi është shumë i madhë ndaj organeve dhe indeve të kafshëve dhe konsumimi i qumështit të tyre. Efekti sezonal është më i dukshëm te bruceloza ovine / caprine se sa për atë bovine, kjo për arsyet të kohës më të gjatë të laktacionit në lopë.

Në vendet tropikale dhe subtropikale, ku mbarësimi i kafshëve zgjatë gjatë tërë vitit, nuk ka influencë sezonale në incidencën e brucelozës (33, 33, 34, 35, 36, 37).

**I. 12. Distribuimi sipas moshës dhe gjinisë.** Në vendet e industrializuara dhe në vendet ku higjiena ushqimore prevenon brucelozën alimentare, sëmundja është më së shumti profesionale dhe shumica e rasteve janë mashkuj të moshës rrëth 45 vjeç.

Në këtë situatë, sëmundja zakonisht është e shkaktuar nga *B. abortus* ose *B. suis*. Në vendet ose zonat ku *B. melitensis* është prevalente, veqanërisht praktika e shitjeve dhe distribuimit te

qumështit dhe produkteve të qumështit të papasterizuar të deleve dhe dhive në veçanti bënë që zbatimi i masave higjenike të jetë i vështirë.

Në këtë situatë e tërë popullata është në rrisk dhe shumë raste të infektuara janë femra dhe fëmijë. Në shoqëritë nomade, adultët janë më shpesh të eksposuar ndaj infeksionit qysh në fëmijëri dhe nuk manifestojnë sëmundje akute, shumica e tyre kanë sekuela nga infeksioni kronik. Në këto rrethana konsiderohet që fëmitë paraqiten me brucelozë akute dhe si problem i madh pediatrik (33, 34, 35, 36, 37).

**I. 13. Bruceloza e fituar nga udhëtimet:** turistët ose udhëtarët për biznes në zonat endemike mund të fitojnë brucelozën, zakonisht me konsumim të qumështit dhe produkteve të qumështit të papasterizuar. Turistët gjithashtu mund të importojnë djathrat e kontaminuara ose edhe produktet tjera të qumështit në vendet e tyre dhe të infektojnë familjet e tyre ose persona tjerë të kontaktit. Sot, rastet e importuara me brucelozë akute janë më të shpeshta në Amerikën veriore dhe Evropën veriore (32, 33, 34, 35, 36, 37).

**I. 14. Bioterrorizmi:** *B. melitensis* dhe *B. suis* janë zhvilluar në mënyrë eksperimentale si armë biologjike të sponzorizuara nga programet shtetërore. Stabiliteti i tyre relativ në formë të aerosoleve, e kombinuar me dozë të vogël infektive i bënë që të jenë agjensi të përshtatshëm për këto qëllime. Brucellat mund të përdoren kundër njerëzve ose edhe kafshëve.

Impakti edhe më i madh do të ishte në ato vende ku sëmundja nuk është endemike. Organizmat mund të miren nga burimet natyrore në shumë pjesë të botës.

Autoritetet shëndetësore dhe veterinare duhet të jenë të vetëdijshme dhe vigjilente për këto burime potenciale të infeksionit (32, 33, 34, 35, 36, 37).

Në vitin 1954, *Brucella suis* është agjensi i parë infektiv i përdorur për herë të parë si armë biologjike në SHBA në shtetin Arkansas në kohën e programit ofenziv të armëve biologjike. Por deri tani nuk është raportuar asnjë sulm bioterrorist me brucella.

Brucelat nuk është vështirë të rriten dhe të shpërndehen, e që transmisioni i tyre në njerëz mund të rezultojë me sëmundje të prolonguar dhe me sekuela të përhershme. Aerozolet dhe kontaminimi i ushqimit do të ishin burimet e infeksionit.

Është vërtetuar që 10-100 organizma janë suficiente të shkaktojnë sëmundjen si dozë me aerosole. Impakti ekonomik i atakut bioterrorist me brucelozë do të kishte koston 477.7 milion dollar për 100.000 persona të eksposuar.

Edhepse brucela për një kohë të gjatë është konsideruar si organizëm i mundshëm për bioterrorizëm deri më tani asnje aplikim i tillë nuk është raportuar (38).

#### I.14.1. PATOGJENEZA

Brucela spp janë baktere fakultative mbrendaqelizore që kanë aftësi ti shmangen mekanizmit të vrasjes qelizore dhe të proliferojnë në makrofagë, ngjajshëm me patogenët tjerë mbrendaqelizorë. Që të jetë agjent i suksesshëm infekcioz, brucela kërkon katër shkallë: adherencën, invazionin, implementimin, dhe diseminimin. Brucelat e opsonizuara dhe jo të opsonizuara mund të infektojnë makrofagët. Në makrofagë brucelat mbijetojnë dhe replikohen duke inhibuar fuzionin fagozom-lizozom. Në fund bakteret e akumuluara janë të diseminuara në qelizat tjera të bujtësit (39,40).

Pas infektimit të bujtësit, patogenët arrijnë të sekuestrohen mbrenda qelizave të sistemit retikuloendotelial.

Mekanizmi me të cilin brucelat hyjnë në qeliza dhe arrijnë ti shmangen vrasjes mbrendaqelizore dhe sistemet imunitar të bujtësit është ende temë e debateve dhe hulumtimeve të shumta. Studime të shumta përfaktorët e virulencës janë të drejtuara në komponentën kryesore të membranës së jashtme. Membrana e jashtme përmbanë lipopolisaharide të cilat janë faktori kryesorë i virulencës së brucelave. Brucela posedon një lipopolisaharid jo klasik të veçantë, karakteritsikë që krahasuar me lipopolisaharidin klasik të enterobakterieve siç është escherichia coli ndryshon dukshëm (39, 41).

Tabela 3. Diferencat në mes të LPS klasik dhe LPS jo klasik

Diferencat në mes të LPS klasik & LPS jo klasik	
LPS klasik	LPS jo klasik
Manifeston toxicitet të lartë	Manifeston toxicitet të ultë për minjtë dhe lepujt të ndjeshëm në endotoksinë
Pirogenitet të lartë	Pirogenitet të ultë
Nxitës të lartë të interferonit dhe faktorit tumor nekrozë	Nxitës të dobët të interferonit dhe tumor nekrozë faktorit
Shembull: E. coli	Shembull: Brucella. Abortus

LPS e buta kanë rol në hyrjen brenda në qelizë dhe shmangjen nga sistemi imunitar i qelizave të infektuara. Ato ndryshojnë aftësinë e qelizave të infektuara të prezentojnë antigenet e huaja antigen ll të klasës MHC, e me këtë duke penguar vrasjen e qelizave të infektuara me ndihmën e sistemit imunitar (9).

LPS kanë tri fusha: Lipid A, oligosaharidi i bërthamës, dhe O-antigjeni. Polisaharidet O të tipit të butë të LPS të brucelave janë homopolimere të padegëzuara të 1-2 lidhjes së 4,6 dideoksi 4-formamido dhe alfa-D mannopyranozil-it, zakonisht me mesataren e gjatësisë së zingjirit prej 96-100 nën njësi të glykozilit (42).

Polysaharidi O është i lidhur me polisaharidin e bërthamës, i përbërë nga manozë, glykozë, 2-amino-2,6-dideoksi-D-glykozë, 2-amino-2-deoksi-D-glykozë, 3 deoksi-D-mano-2-acidi oktulosonik dhe sheqernat e paidentifikuara. Lipidi A është në lidhje me përbajtjen e polisaharidit të bërthamës 2,3-diamino-2,3 dideoksi-D-glykozës dhe zingjiri i gjatë i lidhur me ester të ngopur (C 16:0 to C 18:0) dhe acidet yndyrore të hidroksiluara (43).

Heterogeniteti i enterobaktereve është i lidhur me gjatësinë e O-polisaharideve të veta dhe zëvendësuesit e ndryshëm kimik në oligosaharidet bërthamore dhe në lipidin A (44).

Në lipidin A enterobakterial, shkalla e heterogenitetit mvaret nga kombinimet e ndryshme të lidhjeve të acideve yndyrore me amide dhe estere, fosfate, sheqernat neutrale, etanolamine dhe tipet e ndryshme të amino sheqernave që ndodhin në molekulë (45), kurse në lipidin A të brucelave heterogeniteti mvaret kryesisht nga zëvendësuesit e ndryshëm të acidit yndyor. Ekziston mungesa e përbërësve të shtyllës kryesore dhe lidhja e ester-acil-oksacil mbetjeve në lipidin A të brucelave, të krahasuar me lipidin A enterobakterial (46).

Determinimi i heterogenitetit në LPS e brucelave është i rëndësishëm për qëllime praktike, pasiqë është antigeni më relevant gjatë infeksionit dhe vaksinimit (11,47).

Duke përdorur sekuencat e gjenomit komplet të *B. melitensis*, Dricot me bashkëpunëtorë (47) ka nxjerur databazën e kodimit të proteinës, portën e hyrjes së kloneve duke e përbajtur secila ORF e definuar.

Sekuenca e gjenomit të *B. melitensis* shtamit 16M përbanë 3.294,935 bp e cila është e shpërndarë nëpër dy kromozomet cirkulare të 2,227,144 bp dhe 77,787 bp, kodimin 3,197 të ORF s. Gjenomi i *B. abortus* biovar, shtami 9-941 ka 3.3 Mb i përbërë nga dy kromozome cirkulare të 2,124,242 dhe 1.162,780 bp (48).


Gjenomi i *B. suis* është gjenomi 1330 i përbërë nga dy kromozome cirkulare nga 2,107,7892 bp dhe 1,207,381 bp (49,56). Gjenomi i *B. abortus* këmbej më shumë fragmente me *B. suis* dhe *B. melitensis*, pastaj *B. suis* dhe *B. melitensis* me njëra tjetrën.

Shumica e gjeneve të studiuara janë të involvuara në biosintezën e brucelave dhe O- zingjirin persominesintetazë, manozyl transferazë, fosfoglykomutazë, ABC tipe të transporterëve, dhe manozë.

Brucela ka dy sisteme të komponenteve të quajtura BvrS/BcrR, të cilat kodohen për senzorë të histidin kinazës dhe kontrollon shfaqjen e determinantëve molekularë të nevojshme për invazionin qelizor (58).

Gjenet BvrR/ BvrS sillen si kaskadë e fosforilimit të proteineve për të moduluar ekspresionin kyç, këta faktorë kyç janë të involvuar në lidhjet qelizore dhe penetrat. Pas ingestionit, numri më i madh i brucelave në mënyrë rapide eliminohet nga fuzioni fagolizozomal. Nga ato baktere, 15 deri 30 përqind mbijetojnë (52). Se si ky mjedis acidik unik formohet nuk është tërësisht e kuptuar, por është përgjegjës për kufizimin e aktivitetit të antibiotikëve dhe tregon diskrepancën në mes të studimeve in vitro dhe zhvillimeve in vivo (59). Këto dy sisteme, BvrS/BcrR kanë efekt në ekspresionin e proteineve të sipërfaqës qelizore Omp25 dhe Omp 229 (50).

Figura. 2. Patogjenza e brucelozës



Replikimi i bakteres bëhet në retikulumin endoplazmatik pa e afektuar integritetin e qelizës së bujtësit. Pas replikimit, brucelat lirohen me ndihmën e hemolizinës dhe nekrozës qelizore të indukuar. Ky ndryshim i ekspresionit qelizor i proteineve sipërfaqësore i lejon brucelave të lidhen dhe të penetrojnë rrugën lizozomale.

Tipi A i sistemit sekretues IV (VirB) në mënyrë selektive transporton proteinet dhe makromolekulat nëpër membranë dhe është esencial për mbijetesën mbredha qelizore, siq është rasti edhe te brucelat. Kjo ndihmon gjithashtu edhe në adherencë të bakteres për qelizat e bujtësit dhe për hyrjen në qelizë (51).

Numër i madh i mutantëve të atenuuar, me defekte strukturale në LPS e veta, konfirmon rëndësinë e kësaj molekule në virulencën e brucelës (52). Proteina e shokut të nxehjes 60 (Hsp 60), anëtare e GroEl familjes të qaperonineve, është e shprehur në sipërfaqe të qelizave të tipit të egër të brucelave por jo në mutantin VirB. Kjo protein duket të ketë pjesë në adherencën qelizore dhe bënë lidhjen për prionin qelizor të molekulës së quajtur Prpr.

Me eksportimin e Hsp60 VirB të pamvarur, është postular që Hsp60 mundet në fakt të bëhet faktor i virulencës (53). Endozomet lizohen me acidifikim. Ky acidifikim mendohet që indukon VirB ekspresionin (54,52).

#### I.14.2. Përgjegja e bujtësit human


Përgjegja e bujtësit human reflekton karakteristikë unike te brucelat. LPS nuk aktivizojnë rrugë alternative të komplementit. Brucela është rezistente ndaj dëmtimit nga qelizat polimorfonukleare që është i duhur të bëjë suprimimin e sistemit myeloperoksidazë- hidrogen, peroksidazë-halid dhe bakër-zink dismutazë superoksidazë si dhe prodhimin e inhibitorëve të adenilat monofosfatit dhe guanil monofosfatit.

Paaftësia e aktivitetit të qelizave natyrale vrasëse (NK) dhe paftësia e gjeneratave të makrofagëve në oksigjenin reaktiv intermediarë dhe faktorët rregulator të interferonit janë dokumentuar (60,61,62).

Linfocitet CD4 luajnë rol të kufizuar, duke vepruar në lehtësimin e ekspanzionit klonal nga qelizat tjera citolitike sikurse CD8 qelizat, ose me funksionimin e qelizave stimuluese citolitike. Rritje e  $\gamma/\delta$  CD4 dhe CD8 limfociteve është karakteristike te bruceloza (63) sikur që është rëndësia edhe e qelizave receptore  $\gamma/\delta$  CD4 (64).

Studimet e bëra me vullnetarë që janë vaksinuar me vaksinën Rev1 kundër *B. melitensis* kanë përcaktuar evolucionin e antitrupave specifik kundër brucelave. Imunoglobulinet e klasës M kundër LPS shfaqen gjatë javës së parë të infekzionit, ndërsa Imunoglobulinet e klasës G në fillim të javës së dytë. Të dy klasat e Imunoglobulineve arrijnë pikun gjatë javës së katërt, dhe përdorimi i antibiotikëve është në asociacion me ramjen e titrit të të dy klasave të Imunoglobulineve. Shfaqja e Imunoglobulineve A së bashku me Imunoglobulinet e klasës G për më shumë se 6 muaj është në përputhje me prezencën e sëmundjes kronike.

Figura 3. Përgjegja immune e bujtësit human



Ag: antigen, APC: antigen-presenting cell, IL: interleukin; MHC II: major histocompatibility complex type II; TCR: T-cell receptor; TLR: Toll-like receptor; TNF $\alpha$ : tumour necrosis factor alpha; B7: CD80/CD86 co-stimulatory molecules; BCV: *Brucella*-containing vacuole; CTL: cytotoxic lymphocyte; IFN $\gamma$ : interferon gamma

Interferon- $\gamma$  luan rolin qëndrorë në patogjenezën e brucelozës (65, 66) duke aktivizuar makrofagët, prodhuar specie oksigjen reaktive dhe nitrogjenin intermediarë; me indukimin e apoptozës, rritjen e diferencimit qelizorë dhe prodhimin e citokineve; me konvertimin e imunoglobulineve G në Imunoglobuline G2a; dhe me rritjen e ekspresionit të molekulave antigjenike. Interferon- $\gamma$  ka rol

qëndrorë në evolucionin e brucelozës që është parë nga efekti i polimorfizmit gjenetik në të (+874A alele).

Pacientët të cilët janë homozigotë për alelen +847 mund të jenë relativisht më të prekur nga bruceloza dhe që është shumë interesante edhe në tuberkulozë (67). Tipike për pacientët me brucelozë janë vlerat e rritura të nivelit interferon- $\gamma$  në serum (68,69).

Përkundrazi, rëndësia e faktorit tumor nekrozë  $\alpha$  (TNF- $\alpha$ ) në brucelozën humane është temë e debatit. Edhe pse induksioni i TNF- $\alpha$  është vërejtur në modelet murine të brucelozës, inhibimi i TNF- $\alpha$  në sëmundjen humane është shkallë e hershme kruciale e infeksionit. Inhibimi mund të jetë i involuar në dobësimin e aktivitetit dhe funksionit citotoksik të NK qelizave të dobishme për mekanizmin aktiv bakteror i cili involvon proteinën e jashtme membranoze 25, e cila është identifikuar si regullatorë i poshtëm i TNF- $\alpha$  (70).

Vlerat e TNF- $\alpha$  në serum kanë qenë të padetektueshme në pacientë me brucelozë aktive në një studim (69) por një studim tjeter ka raportuar vlera të rritura në serum në nivel linear me vlerat e interferon- $\gamma$  në së bashku me markerët e tjerë inflamatorë (68).

Roli i interleukinës 12, kryesisht si rregullatorë i prodhimit të interferon- $\gamma$ , është studiuar në mënyrë të gjërë në modelet animale dhe në njerëz (69,71).

#### I.14. 3. Anatomia patologjike

Sëmundja sipas dekursit kalon në tri fazë:

- Faza akute ku vihet re hiperplazi e sistemit retikulo-endotelial dhe leziona vaskulare në formë të vaskultit trombotikë
- Faza subakute që karakterizohet nga formimi i granulomave të çrregullta në organet parenkimatoze të përbëra nga qelizat epiteloide, gjigante plazmocitare, eozinofilike dhe nga nekroza qëndrore.
- Faza kronike përveç proceseve granulomatoze karakterizohet nga procese distrofike në organet viscerale, kryesisht në ato parenkimatoze. Në këtë fazë mund të hasim edhe endokarditin aortal të tipit polipo-ulqeroz dhe meningoencefalo-mijelitin granulomatoz (72,73).

## I. 15. Karakteristikat klinike

Koha e inkubacionit është mjaft variabile, zakonisht zgjatë 2-4 javë, rangu: 5ditë deri në 5-6muaj (74). Periudha e inkubacionit mvaret nga rruga e transmisonit, numri i baktereve të futura në organizëm, patogeniteti i brucelave si dhe statusi imunologjik i personave të infektuar. Mortaliteti te bruceloza është i ulët, më i ultë se 1% dhe atë më së shpeshti mund të ndodhë për shkak të endokarditit të zhvilluar.

### I. 15.1. Bruceloza klasike e ecurisë së zakonshme

**Fillimi i sëmundjes-** kjo sëmundje fillon pa u vërejtur me zhvillim spontan dhe progresiv të simptomeve. Në stadin prodromal pacienti ankohet në një dobësim të përgjithshëm, lodhje, molisje, humbje të oreksit, gjumë të parehatshëm dhe febrilitet. Mirëpo, në këtë periudhë të sëmundjes pacienti e përballon mirë febrilitetin, ashtuqë është i aftë për të kryer punë, deri në javën e dytë nga fillimi i sëmundjes kur qartë shfaqet trijasë: febriliteti, djersitja, artralgjia (75).

**Febriliteti-** më së shpeshti lajmërohet me tipin e temperaturave undulente ose valore, të përcjellura me ethe e dridhje, dhe që epizodat febrile zgjasin nga disa ditë deri në dy javë ndërsa temperaturat subfebrile zgjasin më shkurtë. Intervalet pa temperaturë gjithashtu mund të zgjasin nga disa ditë deri në 2-3 javë (75).

Më rrallë janë këto temperatura remitente ose intermitente. Përkundër këtij febriliteti të gjatë vetëdija e patientit është e ruajtur. Te format akute të brucelozës febriliteti lajmërohet te 95%, ndërsa molisja e plogështia në rreth 90% të patientëve.

**Djersitja-** është e theksuar dhe voluminoze, dhe atë sidomos gjatë natës, kundërmon shpesh në kashtën e kalbur, lajmërohet edhe në epizodat e temperaturave subfebrile.

**Dhembjet-** janë asimetrike, të paqëndrueshme, me intezitet të ndryshueshëm. Zakonisht manifestohen në formë të artralgjive dhe mialgjive dhe mund të jenë aq të theksuara sa që patienti fiton lëvizje të kufizuara të ekstremiteteve apo edhe të tërë trupit. Pacientët më së shpeshti ankohen në dhembje vertebrale, të kofshave dhe gjunjëve.

Artikulacioni i atakuar është mesatarisht ose pak i ajur, pa hiperemi të lëkurës, me kufizim të lëvizjeve pasive dhe aktive, shpesh me përhapje të dhembjeve përgjatë tetivave. Mialgjitet manifestohen te 1/3-2/3 e patientëve dhe zakonisht janë të shoqëruara me dhembje dhe ajtje të lidhjeve muskulare (Tendovaginitis).

Gjatë ekzaminimit pacienti është i vetëdijshëm, i zbehur, i djersitur, i plogësht, për shkak të dhembjeve me lëvizje të kufizuara.

Shpesh palpohen gjëndrat limfatike të zmadhuara të cilat janë të forta të padhembshme dhe të veçuara. Më së shpeshti manifestohet limfadenopatia e gjeneralizuar se sa ajo e lokalizuar. Nëse është vetëm një gjëndër limfatike e zmadhuar atëherë është ajo gjëndër që ndodhet në vendin e hyrjes të infekzionit (75).

Splenomegalia mund të gjendet në rreth 30% e hepatomegalia në rreth 50% të të sëmurëve (7). Edhe organet tjera mund të jenë të atakuara por më rrallë se sa organet e lartëpërmendura.

### **I. 15.2. Format klinike**

Sëmundja e brucelozës sipas peshës së manifestimit klinik ndahet në: asimptomatike, të lehtë, të zakonshme dhe malinje.

#### **I.15.3. Bruceloza asimptomatike-inaparente**

Bruceloza asimptomatike është është forma më e lehtë apo mund të themi më e butë e manifestimit të kësaj sëmundjeje. Diagnostikohet me analiza serologjike (76).

Kjo formë klinike e brucelozës është karakteristike ngase pacienti nuk ka kurfarë simptomesh apo mezi ndonjë simptom të vërejtur (74).

Incidenca e kësaj forme është e paqartë. Autorët amerikanë kanë punuar ekzaminime serologjike te punëtorët në industrinë e mishit dhe te 50% e tyre, dhe 1/3 e veterinarëve kanë gjetur titër të lartë serologjik duke mos pasur asnjëherë shenja të sëmundjes. Sipas autorëve të ndryshëm, raporti i formave subklinike ndaj formave klinike sillet 1:1 deri 12:1 (76)

#### **I. 15. 4. Forma e lehtë – abortive**

Bruceloza e lehtë apo abortive është mjaft e shpeshtë në mbi 50% të rasteve sipas studimeve. Karakterizohet me tablo klinike të një infekzioni banal ose të një gripi, me temperaturë të lartë dhe me një syndromë diskrete mioartralgjike (76). Diagnostikohet me testet serologjike. Kërkon tretman të plotë.

### I. 15. 5. Bruceloza malinje

Bruceloza malinje në ditët e sotme shfaqet më rrallë duke iu falenderuar terapisë antibiotike (76). Kjo formë e sëmundjes manifestohet me një endotoksemi të theksuar me vatra nekrotike të diseminuara, me endokardit dhe vaskulit të diseminuar. Këto ndryshime mund të sjellin pacientin në shok Gram-negativ me sindromë hemoragjike dhe letalitet (77).

Sot flasim për brucelozën malinje nëse pacienti vuan nga një sëmundje kronike që e sjell në anergji dhe sëmuret edhe nga bruceloza. Sipas kohëzgjatjes së sëmundjes bruceloza ndahet në: akute, subakute, kronike, recidivante dhe reinfeksion.

**I. 15. 6. Bruceloza akute:** simptomet e brucelozës akute zgjasin deri 2 muaj (202). Manifestimi i tablosë klinike të sëmundjes mund të jetë në të gjitha format e përmendura më lartë. Më së shpeshti mungojnë lezionet fokale por gati se rregullisht manifestohet me simptomatologji algjike fokale në sistemin osteoartikular. Nëse pacienti në këtë formë klinike të sëmundjes nuk trajtohet kalon në formën subakute por është i mundshëm edhe qetësimi spontan i ataqeve febrile ose shërimi i plotë por me rrisk për recidiv (29).

**I. 15.7. Bruceloza subakute:** simptomet e brucelozës subakute zgjasin mbi 2 muaj deri 12 muaj (202). Bëhet fjalë për zhvillimin e infekzionit akut e cila nuk është njohur, nuk është trajtuar ose nuk është trajtuar në mënyrë adekuate. Me progređimin e sëmundjes shenjat e sindromës infektive qetësohen ose tërhiqen dhe në rend të parë manifestohen ndryshimet fokale. Mirëpo, tabloja klinike te kjo formë e sëmundjes mund të jetë edhe shumë e rëndë dhe me përfundim letal.

**I.15. 8. Bruceloza kronike:** simptomet e brucelozës kronike zgjasin mbi 12 muaj dhe mund të zgjasin disa vite, zakonisht 3-5 vite (202). Kjo formë karakterizohet me mungesën e plotë të sindromës infektive me shenja lokale pak apo më shumë të theksuara të dëmtimeve lokale të organeve të veçanta (78). Është karakteristike se te kjo formë e sëmundjes mund të vie deri te reaktivizimi i vatrave fokale dhe përhapja hematogjene e bacileve të brucelozës.

**I. 15. 9. Relapset:** relapsi është rishfaqja e shenjave klinike 2-3 muaj pas mbarimit të mjekimit veçanërisht kur terapia ndërpritet para kohe ose ndoshta si pasojë e tendencës së brucelave për të

qëndruar mbrenda qelizave dhe për ti shpëtar veprimit të antitrapave dhe antibiotikëve, por jo nga shfaqja e rezistencës ndaj antibiotikëve.

Interpretimi nga pikëpamja serologjike është i vështirë por ELISA është një nga testet më efektive në këto raste pasi tregon një ringritje të titrit të IgG (79, 73).

**I. 15. 10. Reinfekzioni:** reinfekzioni nënkuption kur shenjat e brucelozës akute lajmërohen sërisht pas tre viteve nga ajo paraprake. Mund të lajmërohet si superinfekzion e cila zhvillohet gjatë kohës së brucelemisë dhe testeve pozitive serologjike, dhe si reinfekzion në kuptimin e saj të ngushtë që mund të zhvillohet gjatë kohës së testeve serologjike pozitive ose atëherë kur ato janë të negativizuara respektivisht kur brucelat nuk janë më në gjak.

Për nga pasqyra klinike reinfekzioni është identik me brucelozën akute. Mundësia e zhvillimit të reinfekzionit fletë për imunitet të dobët që lenë kjo sëmundje.

## **I. 16. Format e lokalizuara të brucelozës- Ndërlifikimet**

Kjo forme e brucelozës karakterizohet me simptomatologji dominante nga ana e sistemit të atakuar të organeve. Zakonisht kjo formë dhe ajo kronike duken të njëjtë, edhepse kjo formë mund të lajmërohet edhe te bruceloza akute dhe subakute. Bruceloza mund të lokalizohet në gati të gjitha sistemet e organeve por më së shpeshti në sistemin osteoartikular, sistemin nervor, zemër, mëlqi, shpretkë, testise, tëmth etj.

**I.16.1. Lokalizimi osteoartikular:** lajmërohet në 20-85% të të sëmurëve me brucelozë në të gjitha fazat e sëmundjes (80,81). Nga të gjitha tipet e brucelave afinitet më të madh ndaj sistemit osteoartikular ka B. melitensis (82).

Procesi ne artikulacione më së shpeshti fillon si synovit prej nga infekzioni përhapet në sipërfaqet artikulare të vetë kockës, duke kaluar fazat nga artroza dhe skleroza e skajeve deri në erozionet e vogla ose të mëdhaja në kocka. Në sistemin osteoartikular mund të gjenden shenjat e inflamacionit seroz ose purulent, për arsy se në procesin e këtij inflamacioni përvëç proceseve infektive zhvillohen edhe proceset reaktive - postinfektive.

Lokalizimi më i shpeshtë osteoartikularë i brucelave është në formë të sakroiletit. Manifestimi është me dhembje në kofshë, e nganjëherë përhapet përgjatë tërë këmbës duke e imituar ishialgjinë.

Shkak i atakimit më të shpeshtë të artikulacionit sakroiliak është vaskularizimi më i dobët në këtë region (82,84, 85).

Spondiliti brucelitik fillon si infeksion i diskut intervertebral, prej nga përhapet dhe përcillet në trupin e vertebrës. Në trupin e vertebrës zhvillohet ndarja ose shkulitja e periostit e pastaj erozioni i indit kockor.

Spondiliti, në 60-80% të rasteve lokalizohet në pjesën lumbale dhe sakrale të kolonës vertebrale. Në 10-20% të spondilitit mund të gjenden apseset paravertebrale.

Radiologët prezentojnë dy forma të spondilitit brucelitik: fokal ku atakohet ana e përparme e trupit të vertebrës dhe lidhja diskovertebrale dhe difuze ku shpërbërja fillon në brendësi të trupit të vertebrës me përhapje të vonshme në disk (85,80,86).

Duke pasur parasysh që vendi i predileksionuar i tuberkulozit dhe spondilitit brucelitik mund të jetë i ngajshëm është e nevojshme që të dallohen këto dy procese.

Spondiliti brucelitik zhvillon destruksion fokal dhe deformitete më pak të theksuara të boshtit kurrizor për dallim nga tuberkulozi. Nga shumë autorë si dhe në literaturë janë të prezantuara edhe rastet me spondilolistezë, discit me kalcifikate, destruksione të këndeve të vertebrave (85).

Të afeksioni i shtyllës kurrizore ekziston mundësia e propagimit të infeksionit në strukturat paravertebrale e me të edhe në rrënjet spinale. Në përqindje më të vogël janë të raportuara rastet me inflamacione të kockave të mëdhaja: femuri, humerusi, tibia, brinjët, etj (87).

Këto ndryshime inflamatore janë në formë të formacioneve cistike mbrenda kockave apo edhe apsesë ose edhe erozione të sipërfaqeve kockore të artikulacioneve. Inflamacioni i artikulacioneve te bruceloza zhvillohet me diseminim hematogen të baktereve ose në formë të imunokomplekseve.

Së pari zhvillohet inflamacioni i synovies, e që në kulturë të lëngut synovijal në 50% të punktave mund të gjenden brucelat. Lëngu synovial mund të jetë i kthjellë ose purulent, mvarësisht nga faza e sëmundjes dhe tipi i inflamacionit.

Në 91.5% të rasteve me artritet seroze brucelare në lëngun synovial janë të gjetura imunokomplekset qarkulluese.

Është konstatuar që ekziston korrelacioni në mes të këtij tipi të artritit brucelar dhe antigenit HLA-B 27 dhe atë vetëm te ato artrite të shkaktuara me B. abortus (88).

Me aplikimin e terapisë antimikrobike në fazën e hershme të sëmundjes vjen deri te tërheqja e simptomeve të artritit për shkak të eliminimit të antigenit dhe në atë mënyrë ndërprenë reaksioni imunologjik.

Në fazën e vonshme, destruktive, terapia ndërprenë proceset destruktive por sekvelat mbresin të përhershme.

**I. 16. 2. Neurobruceloza:** në vitin 1934 Roger i pari ka prezantuar ekzistimin e ndërlikimeve neurologjike te sëmundja e brucelozës ndërsa Rimbaud dhe Janbon në vitin 1947 simptomet më të shpeshta të sistemit nervor te bruceloza i kanë sistematizuar në trijasin: çrregullimet psiqike, dobësimin e dëgjimit dhe konvulzione.

Neurobruceloza mund të lajmërohet në të gjitha fazat e sëmundjet së brucelozës, dhe mund të jetë: akute, subakute, kronike. Mekanizmi i dëmtimit të sistemit nervor është:

- infekzioni direkt
- imuno-reaktiv
- proceset kompresive

Dëmtimi i indit nervor me infeksion direkt është karakteristik për formën akute ndërsa proceset imuno-reaktive për formën kronike të brucelozës. Mund të jenë të përfshira vetëm strukturat në sistemin nervor qëndror ku flasim për formën qëndrore, ose vetëm në sistemin nervor periferik ku flasim për formën periferike ose mund të ekzistojë edhe kombinimi i të dy formave.

Brucelat si dhe disa nga bakteret tjera, tregojnë afinitet ndaj endotelit të vazave të gjakut dhe atë sidomos ndaj endotelit të vazave të gjakut të SNQ.

Me këtë rast zhvillohet vaskuliti infektiv ose dëmtimi inflamator i endotelit të shkaktuar me sedimentimin e imunokomplekseve qarkulluese.

Për shkak të këtyre proceseve zhvillohet vazospazëm (89, 90) e në rastet më të rënda nekrozë e mureve të enëve të gjakut, shumë rrallë aneurizma. Si pasojë e këtyrë zhvillimeve patologjike, te meningoencefaliti brucelar mund të lajmërohen: ataqet ishemike tranzitore, insultet cerebrovaskulare (ishemike dhe hemoragjike), hemoragjia subarahnoidale.

**I. 16. 3. Meningjtit brucelar:** meningjiti brucelar mund të lajmërohet në formë akute, rekurrente, tranzitore dhe kronike (84,86).

Te forma akute e meningjtit lëngu trunoshpinor është i kthjelltë, me pleocitozë limfo-monocitare të moderuar, hiperproteinorahi dhe hipoglikorahi. Është shumë vështirë që në bazë të tablosë klinike dhe të të gjeturave patologjike në LTSH të dallojmë meningjitin brucelar nga ai tuberkular. Në rast të meningjtit akut të pa trajtuar mund të zhvillohet forma kronike të cilin e karakterizojnë granulomet e pakazeifikuara (84).

Meningjiti brucelar ka prognozë më të mirë se sa format tjera të meningjtit kronik, mortaliteti për arsyen ende te paqarta është i ultë, ndërsa incidenca e sekvelave të vogla është e lartë (91). Antirupat në LTSH vështirë mund të verifikohen sepse janë në titër shumë të ulët. Kultura e LTSH është në rreth 45% të rasteve pozitive.

Nga testet klasike të aglutinimit shpesh është pozitiv testi i Coombs-it test me të cilin zbulohen IgG dhe antirupat jokomplete.

**I. 16. 4. Meningoencefaliti:** mund të manifestohet me ndryshime motorike, sensitive, senzoriale ose psiqike.

Mund të janë të atakuara nervat kranijal dhe atë në rreth 50% të rasteve (7) e më së shpeshti nervi kranial i II, III, VI, VII dhe VIII. Te dëmtimi i n. VIII më i shpeshtë është dëmtimi nervit akustik dhe atë i tipit të përzier (94). Janë të raportuara edhe raste të amaurozës tranzitore (93). Çrrregullimet psiqike mund të manifestohen në formë të konfuzitetit, gjendjes delirante, halucinacioneve, apatisë, amnezisë etj. Ecuria subakute dhe kronike e sëmundjes mund të përkeqësohet me kokëdhembjet epizodike, paraliza, deficite senzitive dhe neuralgjitet e fytyrës, të regionit okscipital, nervave interkostale. Në të shumtën e rasteve ekziston rigori i qafës i përhershëm ose intermittent (95). Është reportuar edhe rasti me parkinsonizëm tranzitor (100).

**I.16. 5. Mieliti dhe mielopatitë:** Mieliti dhe mielopatitë mund të zhvillohen:

- 1). me rrugë hematogjene,
- 2). me përhapje direkte të infeksionit te rastet me spondilit, arahnoidit dhe apsceset ekstraduale,
- 3). me kompresion të palcës kurrizore nga ana e apscesit ekstradural.

Mieliti mund të shfaqet si mielit tranzverzal ose infarkt spinal.

**I. 16. 6. Bruceloza e sistemit nervor periferik:** bruceloza e sistemit nervor periferik mund të zhvillohet me:

- 1). përhapje hematogjene të infekzionit,
- 2). përhapje direkte të infekzionit te arahnoiditi, disciti dhe spondiliti,
- 3). me dëmtim kompresiv të radikseve të nervave spinal,
- 4). me mekanizma imunologjik.

Nëse ëshhtë zhvilluar sëmundja e brinjëve të përparme të palcës kurrizore atëherë bruceloza imiton ALS (121,123) dhe poliomielitin anterior akut. Si pasojë e ngjarjeve imunologjike mund të lajmërohen poliradikuloneuriti, polineuropatia.

**I. 16.7. Dëmtimi i rrënëve të nervave spinal:** dëmtimet më të shpeshta të rrënëve të nervave spinal janë traumatike, dhe atë të shkaktuara me hernijim të diskut intervertebral dhe me ngushtimin e foramen intervertebralis me osteofite.

Për shkak të kompresioneve të përsëritura apo të vazhdueshmë në rrënë mund të vjen deri te ishemia. Mbi dhe nën kompresionin krijohet një edeme dhe më pas zhvillohet fibroza, rrënja është e fiksuar dhe çdo lëvizje sidomos lëvizjet e përnjëhershme, për rrënjen e sëmurë paraqet traumë të re.

Deri te ndryshimet e ngajshme sjell edhe menigoradikuliti me arahnoiditin konsekutiv (97). Poliradikuloneuropatitë demijelinizuese inflamatore janë neuropati të fituara në patogjenezën e të cilës me gjasë rolin kryesor e kanë proceset imunologjike.

Në format akute (Syndroma Guillain Barre) të këtij ndërlidhimi, hulumtimet patoanatomike kanë treguar demijelinizimin segmentar me infiltrim perivaskular me qelizat mononukleare. Edhepse demijelinizimi segmentar mund të atakon cilën do pjesë të nervit, pjesa më e madhe e dëmtimit është e grupuar në rrënjet proksimale ventrale të nervit. Infiltratet inflamatore kryesisht përbëhen nga qelizat monocito-makrofage dhe të T limfociteve, me një numër të vogël të limfociteve B. Me këto ndryshime shoqërohen edhe degjenerimi aksonal, por që kryesisht mendohet se ka të bëjë me

efekt sekondar të inflamacionit dhe demijelinizimit (98). Në literaturë janë të përshkruara rastet me radikulite brucelare të plexusit lumbo-sakral dhe brahial (96, 99,100,101), poliradikuloneuriti akut brucelar (90, 96,100), polineuropatitë brucelare (96,102). Duhet ditur që diagnostikimi i neurobrucelozës nuk është i lehtë. Efekti i trajtimit të brucelozës akute dhe kronike është i ndryshëm. Efekti më i mirë është te forma akute, qka tregon në nevojën e diagnozës me kohë të kësaj sëmundje. Me testet serologjike në brucelozë e diferencojmë neurobrucelozën nga infeksionet e tjera kronike të SNQ sidomos TBC dhe neurosifilisin (90).

**I. 16. 8. Lokalizmi hepatobiliar:** ky tip i brucelozës mund të lajmërohet te një numër i konsideruar i të sëmurëve. Te 25-50% e të sëmurëve zhvillohet hepatomegalia. Melcia është lehtë e rritur, e butë, e lëmuar, lehtë e ndijshme në prekje. Çrregullimi i funksionit të mëlçisë mund të gjendet te rrith 50-70% të të sëmurëve me hepatomegali (103).

Çrregullimi i metabolizmit të bilirubinës është më i rrallë, më e shpeshtë është rritja e vlerave të transaminazave për shkak të zhvillimit të nekrozës së hepatociteve.

Nekroza e hepatociteve është më e theksuar te infekzioni me Brucela melitensis, rrallë te infekzioni me këtë specie të brucelave mund të lajmërohen mikroabscese në mëlçi si dhe hepatiti difuz me nekrozë të theksuar, pa ndryshime granulomatoze.

Për dallim nga Brucella melitensis, B abortus shkakton ndryshime më të vogla nekrotike dhe atë në fazën e krijimit të granulomave si dhe rrallë në kuadër të sëmundjes mund të paraqitet holecistiti (104).

**I. 16. 9. Shpretka:** splenomegalia mund të zhvillohet në të gjitha fazat e sëmundjes dhe është mjaft e shpeshtë 20-66% (105). Në shpretkën e sëmurë mund të zhvillohen ndryshimet granulomatoze ose vatra të absceduara gjë e cila mvaret nga forma e sëmundjes dhe nga shkaktari. Në shpretkë pas shërimit të sëmundjes mund të gjenden kalcifikatet.

**I. 16. 10. Sistemi kardiovaskular:** ndërlikimet në zemër mund të lajmërohen në formë të perikarditit, endokarditit dhe miokarditit. Miokarditi është pasojë e natyrës toksike dhe shpejt tërhiqet me terapi antibiotike. Endokarditi është komplikacion tejet i rëndësishëm te bruceloza , ngase është shkaktari më i shpeshtë i përfundimeve letale. Raportohet incidencë e endokarditit brucelarë në 1-2% të rasteve. Në esencë bëhet fjalë për sëmundje të valvulave ( 43%) dhe atë më

të shpeshta aortale, pastaj ato mitrale. Në 88% të rasteve me endokardit zhvillohen embolitë, si dhe embolitë në sistemin nervor qëndror. Perikarditi është komplikacion më i rrallë i brucelozës por sikurse edhe miokarditi tërhiqen mirë me terapi antibiotike.

Si pasojë e afinitetit të bacileve të brucelozës ndaj endotelit të vazave të gjakut mund të lajmërohen: tromboza e e enëve të gjakut të trurit, më rrallë tromboza e enëve të gjakut të palcës kurrizore, tromboflebiti i enëve të gjakut të ekstremiteteve sidomos atyre të poshtme (106).

**I. 16. 11. Sistemi respirator:** ndërlikimet brucelare në sistemin respirator lajmërohen në 10-15% të të sëmurëve (7). Rruga më e shpeshtë e infekzionit është aerogjene e më rrallë hematogjene gjatë sepsës. Mund të lajmërohen te të gjitha format e brucelozës dhe atë si: bronhit, bronhopneumoni, pneumoni, pleurit, empijem, efuzion pleural, absces pulmonal.

Të gjeturat më të shpeshta rëndgenologjike janë bronkopneumonitë perihilare, intersticiale dhe pneumonitë bazale. Pas shërimit medikamentozë ose atij spontan mbesin kalcifikate.

Nëse zhvillohet forma kronike e brucelozës pulmonare atëherë lajmërohet tendencia për fibrotizim (7).

**I. 16. 12. Format më të rralla të lokalizmit brucelarë:** Ndryshimet në lëkurë te bruceloza lajmërohen në rreth 5% të të sëmurëve (76). Mund të manifestohen në formë pustuloze, makulopapuloze, urtikarie, ekcematoze, ndyshimeve impetiginoze ose në formë të eritema nodosum.

Lokalizimi genito-urinar është i rrallë në 5-10% të rasteve në formë të nefritit intersticial, pyelonefrtit akut, glomerulonefrtit eksudativ dhe nefropatisë IgA (106), prostatitit (105) orhiepididimitit në 20% dhe mund të zhvillohen atrofitë e tubuleve seminifere ose edhe më rrallë në formë të endometritit dhe adneksitit ose absceseve të pelvikut (106).

Ndryshimet në sy janë të rralla: konjuktiviti, uveiti si manifestim i vonshëm, keratiti, retinopatia dhe gjakderdhjet retinale. Në kuadër të neurobrucelozës mund të lajmërohet inflamacion i nervit optik. Te bruceloza zhvillohet hipoplasia në lozën eritocitare, leukocitare dhe trombocitare si dhe kësaj anemie i kontribon edhe hipersplenizmi (29, 105).

Këto manifestime janë leukopenia, trombocitopenia e cila mund të jetë mjaft e rëndë e shoqëruar me purpurë kutane. Në 75% të rasteve janë vërejtur granuloma të vogla dhe mezi të dallueshme në punksion-biopsi të palcës kockore (106).

**I. 17. Bruceloza te shtatëzanet:** bruceloza është sëmundje zoonotike e cila haset edhe gjatë shtatëzanisë. Kjo sëmundje mund të zhvillojë abort te gruaja shtatëzane, infekzion kongjenital dhe neonatal si dhe infekzion të mundshëm të ekipit mjekësor që bën lindjen.

Trajtimi i gruas shtatëzane është mjaft sfidues por që duhet të fillojë menjëherë me kombinim të rifampicinës dhe TMP/SMX, me qëllim që të prevenohen ndërlikimet e mundshme (107) . Brucelozën aktive gjatë shtatëzanisë e ka përshkruar i pari Eyre në vitin 1908.

Relacionin mes brucelozës te gruaja shtatëzane dhe abortit i pari e ka përshkruar De Forest në vitin 1917.

Carpenter dhe Boak në vitin 1931, ishin të parët që izoluan brucelat me kulturë nga fetusi human i abortuar, ndërsa përshkrimin e lindjes premature i pari e ka raportuar De Carle në po të njëjtin vit 1931 (108).

Besohet se abortin spontan bruceloza humane e shkakton më rrallë se sa te kafshët për shkak të mungesës së eritritolit në placentën humane dhe në fetus. Si arsye plotësuese për rolin e vogël të infekzionit me brucelozë në abortet humane është prezenca e aktivitetit anti-brucelarë në lëngun amniotik human. Incidenca më e madhe e abortit është në trimestrin e parë dhe të dytë të shtatëzanisë gjatë brucelozës aktive (109).

**I. 18. Bruceloza pediatrike:** bruceloza është sëmundje që nuk zgjedh moshë, andaj kur atakohen fëmijët sidomos infantët manifestimi klinik nuk është specifik por simulan gjendje apo sëmundje tjera. Disa fëmijë mund të keq diagnostikohen dhe të trajtohen në drejtim të sëmundjeve tjera e që mundëson zhvillimin e ndërlikimeve. Kur diagnostikohet fëmiu me brucelozë zakonisht zbulohen edhe anëtarë tjerë të familjes me brucelozë gjatë skriningut.

Bruceloza pediatrike është më e shpeshtë në vendet endemike me brucelozë dhe duke e pasur parasysh këtë fakt klinicisti është më i shpejtë në diagnostikimin e kësaj sëmundjeje në stadin e hershëm. Shenja më e shpeshtë klinikë te bruceloza pediatrike është artriti me temperaturë të lartë ndërsa endokarditi dhe meningjiti janë shumë më të rralla se sa te adultët (108).

## I. 19. Diagnoza

Pasqyra klinike te bruceloza është polimorfe dhe vështirë mund të përcaktohet diagnoza vetëm në bazë të saj. Anamneza epidemiologjike ka rëndësi të madhe.

Brucelat mund të izolohen prej gjakut, urinës, sekretit urogenital, punktimit të gjëndrave dhe të palcës kockore, ndërsa identifikohen me kultivim, ose me eksperiment biologjik. Sëmundja vërtetohet me analiza serologjike, molekulare dhe me kulturë.

Në analizat hematologjike mund të jenë të pranishme: anemia, trombocitopenia, leukopenia me limfocitozë. Diagnostikimi klasik është i njohur nga fundi i shekullit të 19<sup>te</sup> : testi i aglutinimit dhe modifikimet e tij si dhe testi i fiksimit të komplementit të cilat ende janë metoda rutine diagnostikuese, dhe paraqesin bazën e diagnozës laboratorike të brucelozës në njerëz dhe në kafshë (142).

Testet klasike të cilat janë teknikisht të modifikuara, por të pandryshueshme në esencën e tyre janë p.sh. reaksiioni Wright i aglutinimit, me modifikimin e saj në formë të 2-merkaptoetanol testit dhe testit të fiksimit të komplementit e që kanë shërbyer me dakada dhe akoma sot e kësaj dite përdoren kryesisht për detektimin e rasteve të reja të brucelozës.

Testi Coomb's që detekton antitrupat specifik jokomplet që nganjëherë janë antitrupat e vetme detektabile te bruceloza kronike është një nga testet klasike të vlefshme dhe test plotësues i domosdoshëm

**I.19.1. Reaksiioni i aglutinimit (reaksioni Wright):** është provë më klasike e diagnostikimit të cilën e kanë futur në praktikë A. Wright dhe Smith më 1897.

Me këtë reaksiion detektohen aglutininet anti-brucelare në serum. Ky reaksiion konsiston në lidhjen e brucelave me antitrupat specifik të cilët janë prezent në mostrat e ekzaminuara. Kjo rezulton me ramjen e mbushjes elektrike dhe ndryshimit në strukturën fizike dhe kimike të qelizës bakterore. Karakteri i tyre hidrofilik ndryshon në atë hidrofobik. Kjo bën të formohen grumbuj, të cilat në tubën e aglutinimit bijnë në fundin e tubës së testimit ose pllakës së testimit në formë të sedimentit. Antitrupat e aglutinuara kryesisht formohen nga imunoglobulinet e klasës IgM. Koha e perzistencës së tyre në trup variron. Ato lajmërohen herët qysh në stadin e parë të sëmundjes, zakonisht 6-7 ditë pas infeksionit.

Një titër 1: 160 konsiderohet pozitiv, ndërsa me titra më të ulta konsiderohen të dyshimta dhe duhen përsëritur pas 2 javësh. Titri Wright mbi 1:160 konsiderohet diagnostik në vendet joendemike në korrelacion me prezantimin klinik kompaktibil.

Sidoqoftë në vendet endemike, titri 1:320 konsiderohet specifik diagnostik.

Në formën akute dhe subakute të brucelozës humane reaksioni i aglutinimit jep rezultate pozitive me titra të lartë. Sipas Bileckit reaksiioni i aglutinimit mund të jetë pozitiv edhe në ecurinë e sëmundjeve tjera infektive për shkak të komponentës së ngajshme antigenike që kanë tularemia, tifoja ekzantematike, tuberkulozi ose te personat e vaksinuar kundër kolerës dhe etheve tifoide.

Përveq kësaj, reaksionet serologjike të kryqëzuara mund të zhvillohen edhe në mes të Yersinia enterocolitica 03 dhe 09, dhe specieve klasike të gjinisë brucela (112).

Rezultatet negative të reaksionit të aglutinimit mund të zhvillohen te:

- 1). Individ i posa infektuar (kur aglutininet anti-brucelare ende nuk kanë mbërri të prodhohen)
- 2). Individët me brucelozë kronike (tek të cilët niveli i aglutinineve arrin vlerën zero).
- 3). Te individët me imunitet të kompromituar (112).

**I. 19. 2. Rose Bengal testi:** është eseji i aglutinimit të shpejtë që bëhet me shtamin e B. abortus në pH 3.6-3.7 dhe në serum të thjeshtë. Është metodë mjaft e thjeshtë dhe e shpeshtë në përdorim si skrining test te bruceloza humane qka mund ta kenë edhe laboratoret e vogla. Sidoqoftë, udhërfyesit e OBSH rekomandojnë që ky test të konfirmohet nga testet tjera.

Shumë autorë raportojnë për senzitivitet të ulët sidomos te rastet kronike dhe specificitet të ulët në vendet endemike (180,184).

**I. 19. 3. Testi i fiksimit të komplementit:** paraqet testin e dytë diagnostik të brucelozës humane. Ky test është specifik dhe senzitiv. Kjo është metodë e detektimit të nivelit të antitrupave të klasës IgG, të cilat lajmërohen zakonisht në ditën e 20<sup>te</sup> të sëmundjes. Titrat e lartë janë observuar gjatë vitit të parë dhe të dytë të sëmundjes përderisa disa vite më vonë pas infeksionit rezultatet e studimeve mund të janë seronegative.

Ky është reaksiuni dy fazor me participim të 5 komponenteve të cilat krijojnë sistemin bakterolitik (test sistemi, Faza I); antitrupi+antigeni, dhe sistemi hemolitik (sistemi indikator, Faza II); komplementi+hemolizina+ elementet qelizore të gjakut.

Komponentet individuale aplikohen në volume të barabarta dhe me koncentrim strikt specifik të vendosur nga titri i testimit. Testi konsiston në fiksimin e komplementit nga komplekset imune specifike antitrup-antigen ose në sistemin indikator.

Nëse serumi i testuar nuk përmban antitrupa specifik për antigenin e dhënë anti-brucelarë, komplementi i pafiksuar në fazën I shkakton hemolizën e elementeve qelizore të gjakut në fazën e II –të gjegjësisht reaksion negativ (112).

**I. 19. 4. Reaksiuni Coombs- antiglobulin:** është test me vlerë të lartë diagnostike. Ky reaksion është posaqërisht i vlefshëm në studimet retrospektive, mundëson detektimin e antitrupave jokomplete në rastet me brucelozë kronike.

Titrat e antitrupave jokomplete prezentojnë veten për kohë të gjatë dhe janë me vlera të larta të konsiderueshme se sa titrat e antitrupave komplete. Coombs reaksiuni i antiglobulineve aplikohet me mostra të cilat kanë reaguar në Wright reaksiunin e aglutinimit me vlerë negative (112).

**I. 19. 5. Testi i koagulimit:** është tip i reaksiunit në të cilin Cowan I proteina A është e aftë të bënë lidhjen me pjesën Fc të gamma globulinës dhe të detekton antitrupat jokomplete anti-brucelare. Vlerë e lartë diagnostike e këtij reaksiuni është që lejon diagnostikimin e rasteve me brucelozë kronike, me detektimin e antitrupave jokomplete (112).

Pika fillestare për zhvillimin e këtij testi është reaksiuni klasik i aglutinimit që zbutet në serum nga 1/25-1/200. Ky test gjithashtu sikurse Coombs reaksiuni i antiglobulineve përdoret në mostrat që kanë reaguar me rezultat negativ në reaksiunin Wright të aglutinimit.

**I.19.6. Testi i 2-mercaptopropanoal aglutinimit ('reduction' reaction):** në diagnostikimin serologjik të brucelozës, gjithnjë e më shumë është theksuar dhe aktualisht është zëvendësuar me reaksionet kualitative, të cilat pamundësojnë diferencimin e antitrupave të klasës IgG dhe IgM. Shumica e këtyre reaksiioneve janë të bazuara në principet e reduktimit të reaksiunit të aglutinimit duke inaktivizuar ose duke bërë largimin selektiv të antitrupave të klasës IgM nga serumi i ekzaminuar.

Inaktivizimi i imunoglobulineve IgM mund të bëhet duke i redukuar me anë të përdorimit të 2-ME ose të hidroklorid cisteinës, duke ulur pH -në e ambientit të reaksiunit ose duke elevuar temperaturën e reaksiunit të inkubacionit.

Sipas teknikës së inaktivizimit të IgM, janë aplikuar reaksionet kualitative të rradhës: 2-ME – merkaptoethanol testi, dhe testi i inkativizimit të nxehtësisë (Heat Inactivation Test), aglutinimi me acid antigen (Card Test or Rose Bengal Test) dhe Rivanol Testi. Nga këto teste të përmendura, reaksiuni me 2-ME është testi më së shpeshti i përdorur si në mjekësinë humane ashtu edhe në veterinari.

Mekanizmi i efektit të reduktuar të këtij testi (2-ME) konsiston në prishjen ‘breaking’ e – S – S – lidhjeve. Kjo rezulton në humbjen e aktivitetit biologjik nga IgM e që me këtë humbet aftësia e tij e aglutinimit. Zhdukja totale e evidencave të reaksionit të aglutinimit (aglutininet aktive i takojnë klasës IgM) dhe e kundërta mungesa e efektit të reduktimit të titrit mbas reduktimit të 2-ME është evidencë se aglutininet prezente në serumin e ekzaminuar i takojnë klasës IgG.

Nga ana tjeter, redukimi parcial në reaksiunin e aglutinimit nën efektin e 2-ME tregon që aglutininet prezente në serum i takojnë pjesërisht IgM, dhe pjesërisht klasës IgG. Sa më e lartë është shkalla e reaksiunit të aglutinimit aq më i lartë është raporti i antitrupave IgM/IgG (142).

**I. 19. 7. Brucelacapt testi:** është test i kapjes imune të aglutinimit që sygjeron për zëvendësues të mundshëm të Coombs testit në diagnostikimin e brucelozës humane dhe ndoshta marker edhe më i mirë i aktivitetit të sëmundjes.

Në vitet e fundit, brucellacapt testi është raportuar të ketë detektuar antitrupat e aglutinuar dhe të paaglutinuar me senzitivitet shumë të lartë.

Me këtë test për dallim nga testet klasike shërbëhemë për grupet më të mëdhaja të pacientëve me brucelozë me forma të ndryshme të manifestimit të sëmundjes në një periudhe të zgjatur kohore (111).

**I. 19. 8. Testi kutan alergjik i Burnetit:** është test që përdoret posaçërisht në rastet e dyshuara me infeksion të brucelozës, atëherë kur reaksiunet serologjike janë të paqarta. Ky reaksiون është senzitiv dhe specifik. Reaksiuni pozitiv i Burnet-it tregon manifestimin alergjik të organizmit si rezultat i infeksionit dhe mund të perzistojë shumë gjatë edhe pas shërimit. Ky reaksiون konsiston në injektimin intradermal më anën e mbrendshme të parakrahut, të 0.05-0.1 ml të Brucelinës diagnostike.

Rezultati lexohet pas 24 dhe 48 orëve. Reaksiuni lokal mund të zhvilohet në formë të skuqjes dhe infiltrimit të madhësive të ndryshme, më së shpeshti si vezikulë, ose edhe si ndryshim nekrotik më

pjesën qëndrore të ndryshimit kutan me status subferil ose febril të pacientit, me zhvillim të simptomeve të përgjithshme dhe fokale të brucelozës.

Fillimisht, për reaksionin e Burnetit është përdorur Brucelina PS e fituar nga kulturat e ngrira dhe të pa ngrira të brucelave disa herë, në doza 0.02-0.05ml. Sidoqoftë, kjo është zëvendësuar nga Brucelin PD me doza 0.05-0.1ml. Në diagnostikimin e brucelozës duhet mbajtur në mend, Brucelin testi nuk duhet ti paraprijë testeve serologjike, sepse nxit reaksione pozitive (aglutinimit, të fiksimit të komplementit), e që ky status pozitiv mund të zgjasë 8-10 javë (112).

**I. 19. 9. ELISA (Indirect enzyme-linked immunosorbent assays):** është test që shfrytëzon proteinet citoplazmatike si antigjenë. ELISA bën matjen e imunoglobulineve të klasës IgM, IgG dhe IgA, çka mundëson interpretim më të mirë të situatës klinike dhe të mangësive të testeve të aglutinimit. Në krahasim me testet e aglutinimit, ELISA jep senzitivitet dhe specificitet më të lartë (142).

ELISA është test imunoenzimatik dhe është mjaft i dobishëm sidomos për diagnozën e relapseve, të neurobrucelozës dhe si konfirmues kur testet e aglutinimit janë negative ose të dyshimta.

Stadi akut ka titra të lartë të IgM dhe titra në rritje të antitrupave IgG ndaj antigjenit LPS, kurse në stadin kronik ka vetëm titra të rritur të IgG (181).

Në fazat akute dhe subakute përcaktohen titra të lartë të antitrupave IgG dhe titra të moderuar të IgM dhe IgA; në fazat kronike ka përqëndrime të larta të IgG por jo të IgM ose IgA; rastet me titra të ulta reziduale të IgG paraqesin infeksion të kaluar.

Në rastet kur titri i IgG mbetet i lartë ose ringritet kemi të bëjmë me relaps.

Specificiteti dhe senzibiliteti i ELISA IgM dhe IgG është 100% dhe 96% (95).

**I. 19. 10. Pika e shpejtë e testeve të kujdesit (Rapid point-of-care assays):** testi i aglutinimit, testi Coombs, ELISA dhe BrucellaCapt testi kërkojnë laboratore mirë të pajisura e që në vendet e varfëra ku sëmundja është edemike ka mungesë të shpeshtë në qendrat shëndetësore të tyre.

Testet rapide siq janë testi imunoesh i polarizimit fluorescent (FPA) për brucelozë dhe testi eseji i rrjedhjes laterale imunokromatografike të IgM/IgG të brucelave (LFA), verzioni i simplifikuar i ELISA-s, janë teste me potenciale të mëdhaja (113,114).

Testi FPA zhvillohet me inkubimin e mostrave të serumit me LPS antigenin O e brucelave të lidhura me provat fluorescente (113,182,183).

Senzitiviteti i këtij testi në vlerat e cut-off -it të selektuar është 96% për brucelozën e vërtetuar me kulturë, dhe specificiteti është i determinuar të jetë 98% për mostrat e marura nga dhuruesit e shëndoshë të gjakut.

Testi LFA shfrytëzon një pikë të gjakut të marur nga gishti, nuk kërkon trajnim specifik dhe është i lehtë në interpretim si dhe mund të shfrytëzohet te pacienti në shtrat të tij.

Komponentet janë të stabilizuara dhe nuk kërkojnë frigorifer për transport të tyre ose dhoma për bartje (115). Senzitiviteti dhe specificiteti i LFA është i lartë mbi 95% dhe mund të përdoret në të gjitha stendet e sëmundjes.

Studimet e mëtjeme do të nevojitet të konfirmojnë shfrytëzueshmërinë e këtyre testeve të reja (new point-of-care tests) në mjjedise të ndryshme klinike në zonat endemike, me vëmendje të veqantë në diagnostikimin e pacientëve me brucelozë akute dhe me relaps.

Nevoja e pajisjeve specifike dhe reagjentëve mund të bëjë që FPA testi të jetë shumë i shtrenjtë, por testi i thjeshtë që është LFA mund të jetë më ideal për testimin e grupeve të rrezikut (114). Një aplikim i përshtatshëm për këto teste është skriningu i kontakteve të pacientëve me brucelozë (116,117,118, 184).

**I. 19. 11. PCR (Polimerase chain reaction):** është metodë e përshtatshme për diagnostikimin të brucelozës humane në nivel molecular, e cila ka senzitivitet të krahasueshëm me kulturë (119). Shumica e sistemeve PCR me gjenin specifik janë zhvilluar duke shfrytëzuar palët primare që targetojnë 16S RNA sekuencat dhe gjenet e proteineve të ndryshme të membranës së jashtme (120, 121,122,123, 124,125).

Secili sistem PCR prodhon produkt diskret DNA, gjatësia e të cilit është identike dhe specifike për të gjitha speciet e brucelës.

Queipo-Ortuno me bashkëpunëtorë (126) kanë gjetur 100% senzitivitet dhe 98.3% specificitet duke shfrytëzuar palët primare B4/B5 duke amplifikuar fragmentin 223-bp të gjenit *bcsp31* të krahasuar me 70% senzitivitet për kulturë të gjakut. Inkorporimi i metodës së fuqishme të ekstrahimit të DNA -së, siq është metoda e diatom-guanidinium isotiocianatit, e cila në mënyrë efektive largon inhibitorët që janë shpesh prezent në mostrat e ndryshme klinike, mund të vërteton senzitivitetin dhe reproduktivitetin (127).

PCR është i përshtatshëm për përdorim sidomos te pacientët me komplikime specifike siq është neurobrucelozë, ose infekzionet tjera të lokalizuara, pasiqë testet tjera shpesh dështojnë në këta pacientë (128, 129, 130).

Sido që të jetë, PCR është sistem kompleks, kërkon kohë dhe jep rrisk të lartë të kontaminimit, andaj është më pak i përshtatshëm për përdorim rutinor (130,131,132,133,134,135,136).

Sidoqoftë, kostoja e lartë e këtyre esejeve bën restriksion të shfytëzimit të tyre.

**I. 19.12. Aplikimet për vlerësimin e trajtimit të brucelozës:** relapsi i brucelozës është një sfidë tjetër e diagnostikimit ku do të shërben më së miri PCR e që kohëve të fundit është përdorur për të vlerësuar efikasitetin e trajtimit.

PCR tregon perzistimin e niveleve të ulta të brucela DNA në serum te pacientët e trajtuar, 1-2 vite pas përfundimit të trajtimit.

Bakteret mund të perzistojnë në gjak te pacientët e trajtuar për kohë të gjatë, mbrenda makrofagëve që mund të konsiderojmë si dështim të madh të trajtimit dhe zhvillim të relapseve. Në të vërtetë një studim i bërë ka vërtetuar se perzistimi i DNA-së së brucelës korrelon me trajtim jo efektiv dhe relaps.

Për këtë arsy, PCR mund të përdoret si alternativë e kulturës së gjakut në konfirmimin e brucelozës, monitorimin e trajtimit te brucelozat e konfirmuara, monitorimin e efikasitetit të trajtimit, dhe diagnostikimin e relapseve te pacientët me brucelozë të konfirmuar (130,137).

**I. 19. 13. Aplikimet tjera të PCR:** gjithashtu mund të përdoret në diferencimin e specieve dhe biotipizimin e izolateve. Sekuencat e përsëritura të nukleotideve të shkurtëra prezente në lokuse të ndryshme të gjenomit të brucelave, tregojnë variacione të gjëra në numër të sekuencave të përsëritura në mes të specieve dhe izolateve (138,139).

PCR amplifikimi i këtyre variablate të përsëritjes është më i fuqishëm se sa metoda klasike e tipizimit të specieve dhe identifikimit të biovareve dhe është më e fuqishme se metodat tjera molekulare siq është tipizimi i proteineve të membranës së jashtme (133,140), të IS711 tipizimit (122) ose tipizimi me fragment të amplifikuar të polimorfizmit (141).

**I. 19. 14. Hemokultura:** kultura e gjakut është standard i artë (gold standard) në diagnostikimin e infeksioneve bakterore si dhe të brucelozës. Ekzistojnë tri tipe kryesore të teknikës së hemokulturës:

- 1). Metoda tradicionale Ruiz-Castaneda
- 2). Sistemet e automatizuara
- 3). Metodat e dhënjes optimale siq është teknika e koncentrimit të lizës(142,143).

Metoda tradicionale Ruiz-Castaneda kërkon më shumë kohë deri në disa javë ndërsa sistemet e automatizuara mund të detektojnë brucelat në 36%-48% mbrenda 7-10 ditë (144,145, 146, 147). Bactec 9240 dhe 9120 sistemet e automatizuara mund të jepin kultura pozitive deri në 95% të rasteve mbrenda 4 - 7 ditë (145,147,148).

Kultura Bact/Alert e automatizuar jep 51% të rasteve rezultate pozitive mbrenda 4-5 ditë, përderisa sistemi i kulturave të bujonit mund të arrin deri në 100% izolat të brucelës mbrenda 5 ditësh (149). Këto teknika janë lehtë për tu përdorur, kanë kosto të ultë dhe janë relativisht të sigurta në krahasim me metodat tradicionale të vjetra të hemokulturës (143,150).

Kulturat e palcës kockore-mielokulturat jepin senzitivitet edhe më të lartë, jepin izolate me kohë më të shkurtër, dhe mund të janë superiore ndaj kulturës së gjakut kur të evaluan te pacientët me përdorim paraprak të antibiotikëve (115,152,153,154).

Brucelat gjithashtu mund të mbjellen në kultura nga qelbi, mostra të indeve, nga lëngu trunoshpinor, pleural, artikularë ose nga asciti. Pasiqë brucela është një nga infeksionet që shpesh mund të fitohet në laboratore, duhet të përdoret kujdes i veçantë kur përdoret metoda e lizës së centrifuguar me qëllim që të shmangim infeksionin nga aerosolet e kontaminuara (155,156,157,158).

**I. 19. 15. Diagnozat diferenciale të brucelozës:** tuberkuloza, sarkoidoza, sifilisi, ethet tifoide, malaria, kala-azar, limfoma Hodgkin, mycoplazma infeksionet, tularemia, çrregullimet reumatike dhe gjendjet febrile me etiologji të panjohur (158, 159, 160).

## I. 20. Terapia

Qëllimi i terapisë kundër brucelozës është që të menaxhojë simptomet sa më shpejtë që është e mundur për të prevnuar komplikacionet dhe relapset.

Trajtimi i brucelozës humane duhet të përfshijë antibiotikët të cilët penetrojnë makrofagët dhe mund të vaprojnë në mjedis acidik mbrendaqelizorë (242).

Regjimi i multiterapisë antimikrobike është shtyllë e trajtimit ngase me qasjen e monoterapisë janë raportuar numër i madhë i rasteve me relapse (161,200).

Në vitin 1986, Organizata Botërore e Shëndetësisë ka lëshuar një udhërëfyes për trajtimin e brucelozës. Sipas këtij udhërëfyesi janë dy regjime, në të dyja aplikohet doksiciklina gjashtë javë, në kombinim ose me streptomycin për tre javë ose me rifampicin për 6 javë.

Të dy kombinimet janë mjaft të popullarizuara në mbarë botën, edhepse nuk përdoren në mënyrë univerzale.

Streptomicina është më efektive në prevenimin e relapseve. Rifampicina rregullon nivelin e doksiciklinës në serum. Në anën tjetër në vendet ku bruceloza është endemike, ku edhe tuberkulozi është endemik, rrit brengosjen për zhvillimin e rezistencës ndaj rifampicinës në komunitet (242). Kombinimet alternative gjithashtu përdoren duke aplikuar gentamicinën ose netilmicinën.

Autorët e OSHB-së për regjimet e rekomanduara e sygjerojnë TMP /SMX –in i cili mund të përdoret si antibiotiku plotësues i tretë (dhe vetëm si i tretë).

Një çështje e rëndësishme sa i përket aplikimit të TMP/SMX-it në trajtimin e brucelozës është zhvillimi i rezistencës ndaj *B. melitensis*. Studimet e mëhershme kanë sygjeruar që TMP/SMX është në asociacion me rritjen e rasteve me rezistencë ndaj *B. melitensis*, nganjëherë deri në 62% (164,165).

Alternativë janë edhe fluorokinolonet. Gjenerata e re e fluorokinoloneve: torvafloksacin, moksifloksacin, ofloksacin, grepafloksacin, gatifloksacin dhe sitafloksacin kanë treguar aktivitet të shkëlqyeshëm in vitro kundër 160 shtameve te *B. melitensis* (168).

Sipas dy rishikimeve të fokusuara në regjin e përbërë nga fluorokinolonet kanë konkluduar se kombinimi që përfshinë fluorokinolonet mund të jetë alternativë e pranueshme, por nuk rekomandoen si opcion i linjës së parë për trajtimin e brucelozës (162, 163).

Aktiviteti i makrolideve është i dobët në mjedisin fagolizozomal acidik andaj nuk janë të përshtatshëm.

Shumica e ndërlikimeve të brucelozës munden në mënyrë adekuate të trajtohen me regjimin standard.

Trajtimi i neurobrucelozës sipas përshkrimeve të fundit rekomandohet të bëhet në kombinim të tre ose katër antibiotikëve për shkak të penetrimit më të mirë në indet e SNQ dhe për shkak të gjysëm kohës së eleminimit më të gjatë. Doksiciklina ka aftësi të mirë të penetrimit në SNQ dhe ka gjysëm kohë të eliminimit të gjatë, gjithashtu edhe rifampicina me TMP/SMX kanë penetrim të mirë.

Ceftriaksoni për shkak të aktivitetit dhe penetrimit të mirë në LTHS mund të jetë zgjedhje por si medikament i tretë i kombimit ose te pacientët që nuk mund të marin terapinë perorale.

Terapia zgjatë përderisa të fitohen vlera normale të LTHS dhe gjendjes së përgjithshme të përmirësuar të pacientit ngase vlerat e testeve serologjike nuk janë relevante për të përcaktuar kohëzgjatjen e terapisë te neurobrucelozë (170).

Spondiliti trajtohet së paku tre muaj. Rifampicina është shtyllë në trajtimin e brucelozës gjatë shtatëzanisë.

Në Nëntor të vitit 2006, është mbajtur Takimi i I International për trajtimin e brucelozës humane në Janinë, Greqi, dhe është bashkë organizuar nga Instituti për Edukim të Vazhdueshëm i Janinës dhe Shoqatës Internacionale për Kemoterapi.

Paneli i autorëve të këtij takimi ka sygjeruar që trajtimi optimal i brucelozës së pakomplikuar bazohet në regjim gjashtë favor të doksiciklinës së kombinuar me streptomycin 2-3 javë, ose me rifampicinë për gjashtë javë.

Gentamicina gjithashtu miret në konsiderim si alternativ e pranueshme, përderisa të gjitha kombinimet tjera duhet të aplikohen si linjë e dytë e trajtimit.

Tabela 4. Antibiotikët që përdoren në trajtimin e brucelozës humane

Table 4. Antibiotics Used in the Treatment of Brucellosis in Humans.			
Antibiotic	Minimum Inhibitory Concentration ( $\mu\text{g}/\text{ml}$ )	Dose	Combinations
Doxycycline	0.06–1	100 mg twice daily for 6 wk	Doxycycline combined with streptomycin, with rifampin, with gentamicin, or with ciprofloxacin; doxycycline and streptomycin combined with rifampin or trimethoprim-sulfamethoxazole; doxycycline combined with rifampin and trimethoprim-sulfamethoxazole
Streptomycin	0.25–16	15 mg/kg of body weight intramuscularly for 2–3 wk	Streptomycin and doxycycline; streptomycin and doxycycline combined with rifampin or trimethoprim-sulfamethoxazole
Rifampin	0.1–2	600–1200 mg/day for 6 wk	Rifampin and doxycycline; rifampin and doxycycline combined with streptomycin or trimethoprim-sulfamethoxazole; rifampin and ofloxacin; rifampin and ciprofloxacin
Gentamicin	0.25–2	5 mg/kg/day in 3 divided intravenous doses for 5–7 days	Gentamicin and doxycycline
Trimethoprim-sulfamethoxazole	0.38–8	960 mg twice daily for 6 wk	Trimethoprim-sulfamethoxazole combined with doxycycline, with rifampin, or with streptomycin; trimethoprim-sulfamethoxazole and doxycycline combined with streptomycin or with rifampin
Ofloxacin	0.1–2	400 mg twice daily for 6 wk	Ofloxacin and rifampin
Ciprofloxacin	0.25–1	500 mg twice daily for 6 wk	Ciprofloxacin with doxycycline or rifampin

Bruceloza te fëmijët trajtohet me kombinim të bazuar në rifampicin dhe TMP/SMX dhe me aminoglikozide.

Tabel 5. Antibiotikër për trajtim të brucelozës pedjatrike (204).

Antibiotiku	Dozimi
Rifampicin	20 mg/kg/ditë në dy doza të ndara (max. 600 mg)
Doksiciklin	5 mg/kg/ditë në dy doza të ndara (max. 200 mg) (vetëm për fëmijët mbi moshën 8 vjece)
TMP/SMX	10 mg trimetoprim/kg/ditë (max. 480 mg)
Gentamicin	5–7.5 mg/kg/ditë IM ose IV ose një dozë ose në tri doza
Streptomycin	15 mg/kg IM ose IV një herë në ditë (max. 1 g/ditë) (vetëm për fëmitë mbi moshën 8 vjece)

Relapset trajtohen me terapi të njëjtë. Njëkohësisht relapset duhet të hulumtohen në gjetjen e infekzionit okult të lokalizuar si p.sh. endokarditin, abscesin hepatik ose lienal, sakroileitin, spondilitin ose meningjitin.

Në raste kur detektohen fokuset supurative, indikohet drenimi (perkutan ose kirurgjik) dhe trajtim medikametoz më i gjatë (169, 172).

Metoda e re me gentamicin të ngarkuar me mikropartikula, neutralizimi i mjedisit ku brucela reziduon dhe shfrytëzimi i antibiotikëve siqë është tigeciklina mund të kenë rol të rëndësishëm në të ardhmen.

Në të ardhmen duhet të evaluohet në të gjitha fazat e sëmundjes roli i aplikimit të imunomodulacionit përveq te bruceloza kronike (173).

Kortikoterapia për shkak të efektit antiinflamatorë, antiedematoz dhe antiflogjistik aplikohet te neurobruceloza, manifestimet artikulare me kufizim të lëvizjeve aktive dhe pasive, orhitet si dhe te format hipertoksiqe.

**I. 21. PEP:** sa i përket profilaksës pas ekspozimit janë evidenca të vogla për dobinë e saj ndaj brucelozës humane. BICHT ka rekomanduar 3-6 javë doksiciklinë ose TMP/SMX, me rifampicin (177).

**I. 22. Prevenimi:** i brucelozës humane bazohet në higjenën profesionale dhe higjenën alimentare. Të gjitha produktet e qumështit duhet të preqatiten nga qumështi termikisht mirë i përpunuar. Qumështi dhe produktet e qumështit të papasterizuar duhet shmangur.

Mishi duhet termikisht në mënyrë adekuate të përpunohet.

Shëndeti publik duhet promovuar higjenën alimentare dhe profesionale (veshjen adekuate protektive: pallton, platforma plastike ose prej gomës, dorezat plastike, qizmet, mburrojë të fytyrës si dhe syzet).

Për prevenimin dhe kontrollin ndaj kësaj sëmundjeje aplikohet vaksinimi në kafshët shtëpiake me vaksina të gjalla të atenuuara.

Personeli që punon në laboratore Biosiguria duhet të jetë e nivelit 3.

**I. 23. Vaksinimi:** Vaksinë humane të licencuar akoma nuk ka. Ekzistojnë vaksinat e kafshëve shtëpiake siq është vaksina B. abortus shtami 19 imunizon lopët dhe gjedhat ndërsa vaksina RB51 imunizon delet dhe dhitet. Eradikimi bëhet me testimonin e kafshëve dhe mbytjen e tyre nëse janë të infektuara.

Programet edukative dhe informative janë esenciale për bashkëpunim të të gjitha niveleve me komunitetin (174, 175, 176).

## **II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PUNIMIT**

- Pasqyrimi i ndërlikimeve të brucelozës dhe trajtimi i tyre te të sëmurët e mjekuar në klinikën Infektive në Prishtinë në periudhën 2006-2011

### **A: Qëllimi i studimit ka qenë:**

“ Menaxhimi kliniko-diagnostik dhe terapeutiko-profilaktik i ndërlikimeve të brucelozës në Kosovë.”

### **B: Objektivat:**

- Prezentimi i numrit të të sëmurëve me brucelozë sipas viteve në periudhën 2006-2011
- Prezentimi i të sëmurëve sipas gjinisë dhe grupmoshës
- Prezentimi i të sëmurëve sipas komunave
- Prezentimi i të sëmurëve sipas muajve
- Analizimi i simptomeve dhe ecurisë klinike te të sëmurët me brucelozë
- Analizimi i rezultateve hematologjike-biokimie
- Përcjellja e dinamikës serologjike te të sëmurët 2 javë mbas fillimit të mjekimit
- Prezentimi i ndërlikimeve dhe përcjellja e rasteve që kanë kaluar në kronicitet
- Analizimi i terapisë dhe kohëzgjatjes së saj
- Analizimi i mungesave diagnostike gjatë kesaj periudhe

### **II. 1. METODOLOGJIA**

Në studimin tonë “Menaxhimi kliniko-diagnostik dhe terapeutiko-profilaktik i ndërlikimeve të brucelozës në Kosovë” kemi realizuar një studim retrospektiv me 124 pacientë të trajtuar në klinikën Infektive në Prishtinë, të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) gjatë periudhës 2006-2011.

Me qëllim të realizimit të punimit të dhënat janë marrë nga historitë mjekësore të të sëmurëve, ku janë përfshirë anamneza, ekzaminimet klinike, analizat laboratorike duke shfrytëzuar formularin e standardizuar për këtë qëllim.

Ekzaminimet hematologjike janë bërë në Klinikën Infektive, ndërsa ato biokimike në Institutin e Biokimisë të QKUK-së. Ato janë bërë që në ditën e shtrirjes në spital dhe janë përcjellë në dinamikë gjatë ecurisë akute të sëmundjes. Ekzaminimet rëntgenologjike dhe ekosonografike janë bërë në Klinikën Infektive.

Gjatë këtyre viteve 2006-2011 meqenëse në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës nuk ka qenë mundësia testimit me ELISA test dhe hemokultura jemi shërbyer me metoda serologjike të zakonshme ASHB (aglutinimi i shpejtë në brucela) dhe Wright reaksionin të cilat janë punuar në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

## **II. 2. ANALIZAT STATISTIKORE**

Analiza e të dhënave është realizuar me Statistical Package for the Social Sciences (SPSS) versioni 20.

Për paraqitjen e të dhënave në këtë hulumtim është përdorur statistika deskriptive, ndërsa për të analizuar të dhënat dhe për të gjetur signifikancën statistikore janë përdorur metoda të ndryshme. Është përdorur testi  $\chi^2$  dhe Fisher's exact test për krahasimin e përqindjes ndërmjet variablate dhe për vlerësimin e trendit. Variablat e vazhdueshëm janë përbledhur si mesatare  $\pm$  devacionin standard (SD). Për variablat kategorike është llogaritur përqindja e pacientëve në çdo kategori. Analiza e shpërndarjes së të dhënave është bërë me testin Shapiro-Wilk.

Është përdorur testi i studentit  $t$  për krahasimin e kohës nga fillimi i shenjave të sëmundjes deri në paraqitjen në klinikë sipas rezultatit laboratorik, si dhe për krahasimin e mesatareve të variablate me distribucion normal të të dhënave .

Në rastet e distribucionit jo normal është përdorur Mann-Whitney.

Për krahasim e mesatarës së më shumë se dy grupeve është përdorur Kruskal-Wallis.

Për korrelacionin në mes të dy variablate është përdorur korrelacioni Spearmen. Ndërsa në rastet e të dhënave kategorike analiza është bërë me testin Chi-Square.

Kufiri i signifikancës statistikore është përcaktuar të jetë  $p=<0.05$ .

### III. REZULTATET

Tabela 1. Rastet me brucelozë të trajtuara në Klinikën Infektive të QKUK, sipas viteve

Viti i spitalizimit	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
2006	8	18.2	5	6.3	13	10.5
2007	1	2.3	7	8.8	8	6.5
2008	12	27.3	8	10.0	20	16.1
2009	3	6.8	15	18.8	18	14.5
2010	10	22.7	25	31.3	35	28.2
2011	10	22.7	20	25.0	30	24.2
Gjithsej	44	100.0	80	100.0	124	100.0

Në periudhën 6 vjeçare 2006-2011 në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë trajtuar 124 raste me brucelozë me mesatare vjetore prej 20.7 raste.

Sipas viteve, numrin më të madh të rasteve e kemi pasur në vitin 2010 me 35 raste ose 28.2% dhe vitin 2011 me 30 raste ose 24.2% te të gjitha rasteve. Ndërsa, numrin më të vogël të rasteve e kemi pasur në vitin 2007 me 8 raste ose 6.5% dhe vitin 2006 me 13 raste ose 10.5%. (Tabela 1, Grafiku 1).

Grafiku 1. Rastet me brucelozë të trajtuara në Klinikën Infektive të QKUK, sipas viteve




Tabela 2. Rastet me brucelozë sipas vendbanimeve dhe Komunave

Komuna	Vendbanimi	N	%
Drenas	Abri e Epërme	1	0.8
	Bajince	1	0.8
	Negroc	1	0.8
	Orllat	1	0.8
	Zabel i ultë	1	0.8
Ferizaj	Gjithsej	5	4.0
	Bablok	1	0.8
	Cernilleke	1	0.8
	Komogllavë	1	0.8
	Zllatar	1	0.8
Gjilan	Gjithsej	4	3.2
	Gjakovë	3	2.4
	Cernicë	2	1.6
Gjilan	Përlepnicë	1	0.8
	Gjithsej	3	2.4
	Junik	1	0.8
Kamenice	Dashinc	1	0.8
	Kamenice	1	0.8
	Gjithsej	2	1.6
Kaçanik	Biqevc	1	0.8
	Dubravë	2	1.6
	Kaçanik	1	0.8
	Gjithsej	4	3.2
Klinë	Drenoc	3	2.4
	Gllarevë	1	0.8
	Qeskovë	1	0.8
	Ujmir	1	0.8
	Gjithsej	6	4.8
Lipjan	Brus	4	3.2
	Janjeve	7	5.6
	Kleqk	1	0.8
	Krojmir	2	1.6
	Magurë	2	1.6
	Ribar i madh	1	0.8
	Rufc	1	0.8
	Topliqan	1	0.8
	Vrellë	1	0.8
Malishevë	Gjithsej	20	16.1
	Bellanicë	1	0.8
	Drenoc	1	0.8
	Mirushë	2	1.6
	Temeqin	4	3.2


Gjithsej	8	6.5
Mitrovicë	3	2.4
Obiliq	1	0.8

Tabela 2b. Rastet me brucelozë sipas vendbanimeve dhe Komunave

Komuna	Vendbanimi	N	%
Podujevë	Dumnicë	1	0.8
	Halabak	2	1.6
	Kushevic	1	0.8
	Podujevë	1	0.8
	Gjithsej	5	4.0
Prishtinë	Ajvali	1	0.8
	Fushë Kosovë	1	0.8
	Makovc	1	0.8
	Marec	1	0.8
	Prishtinë	19	15.3
	Gjithsej	23	18.5
Prizren	Landovic	2	1.6
	Lubizhd	1	0.8
	Mamush	1	0.8
	Orllat	1	0.8
	Prizren	1	0.8
	Gjithsej	6	4.8
Rahovec	Rahovec	3	2.4
	Skënderaj	1	0.8
	Suharekë	1	0.8
Shterpcë	Kashtanjevë	3	2.4
	Gjithsej	3	2.4
Shtime	Godanc	3	2.4
	Mollopoljc	1	0.8
	Shtime	4	3.2
	Gjithsej	8	6.5
Viti	Buzovik	1	0.8
	Kabash	1	0.8
	Lubizhdë	1	0.8
	Terpezë	2	1.6
	Gjithsej	5	4.0
Vushtrri	Ceceli	3	2.4
	Dubovc	1	0.8
	Maxhunaj	2	1.6
	Skram	2	1.6
	Stanovc	1	0.8


Gjithsej	9	7.3
Gjithsej	124	100.0

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve sipas komunave




Siq shihet në tabelën 2, 2b, grafikun 4 rastet me brucelozë ishin nga 61 vendbanime (qytete dhe fshatra) të Kosovës, gjegjësisht nga 20 komuna të Kosovës. Numri më i madh i pacientëve ishte nga komuna e Prishtinës 23 (18.5%) pastaj Lipjani 20 (16.1%), Vushtria 9 (7.3%), Shtimja dhe Malisheva me nga 8 (6.5%) pacientë, Prizreni dhe Klina me nga 6 (4.8%) pacientë.

Grafiku 3. Numri i rasteve sipas vendbanimit rurale dhe urbane



Sipas regjioneve gjeografike konstatojmë se 67.7% e pacientëve ishin nga regjionet rurale ndërsa 32.6% nga ato urbane (Grafiku 3).

Grafiku 4. Rastet me brucelozë sipas gjinisë



Nga 124 rastet me brucelozë 80 ose 64.5% ishin të gjinisë mashkullore dhe 44 ose 35.5% të gjinisë femërore. Me  $\chi^2$ -test kemi fituar dallim me signifikancë të rëndësishme statistikore në numrin e rasteve sipas gjinisë ( $\chi^2$ -testi=10.45, P=0.001), (Grafiku 4).

Tabela 3. Mosha mesatare e rasteve me brucelozë.

	Gjinia		Gjithsej
	F	M	
N	44	80	124
Mesatarja	30.0	31.2	30.8
DS	17.5	17.2	17.2
Min	2	4	2
Max	72	74	74
T-test	T=0.23, P=0.895		

Mosha mesatare e rasteve me brucelozë ishte 30.8 vjet (DS±17.2 vjet), rangu 2-74 vjet. Mosha mesatare e rasteve te gjinisë femërore ishte 30.0 vjet (DS±17.5 vjet), rangu 2-72 vjet. Mosha mesatare e rasteve te gjinisë mashkullore ishte 31.2 vjet (DS±17.2 vjet), rangu 4-74 vjet. Me t-test

te mesatares nuk kemi fituar dallim me singifikancë të rëndësishme statistikore në mes moshës mesatare sipas gjinisë,  $T=0.23$ ,  $P=0.895$  (Tabela 3).


Tabela 4. Mosha mesatare e pacientëve Fshat/ Qytet

Mesatarja e moshës në fshat		28.04
95% Confidence Interval for Mean	Lower Bound	24.77
	Upper Bound	31.30
	Bound	

Mosha mesatare e pacijentëve në qytet


Mesatarja e moshës në vite		36.14
95% Confidence Interval for Mean	Lower Bound	29.83
	Upper Bound	42.46
	Bound	

Grafiku 5. Mosha mesatare e rasteve sipas vendbanimit rural / urban



Me testin Mann-Whitney, ekziston dallim signifikant ( $p=0.041$ ) në mes pacientëve nga fshati dhe qyteti për sa i përket mesatarës së moshës. Pacientët nga fshati janë më të rinj me moshë mesatare 28.04 vjet, ndërsa ata nga qyteti 36.14 vjet (Grafiku 5, Tabela 4)

Grafiku 6. Numri i rasteve sipas moshës kategorike




Në klinikën Infektive në Prishtinë nga tërë numri total i pacientëve në periudhën 6 vjeçare 2006-2011 janë trajtuar 20 respektivisht 16 % pacientë me brucelozë të moshës nën 16 vjeçare ndërsa adulte 104 apo 84% (Grafiku 6).


Tabela 5. Pacientët sipas grup-moshës dhe gjinisë

Grup-mosha (vjet)	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
<5	2	4.5	1	1.3	3	2.4
5-14	7	15.9	9	11.3	16	12.9
15-24	10	22.7	22	27.5	32	25.8
25-34	12	27.3	21	26.3	33	26.6
35-44	3	6.8	12	15.0	15	12.1
45-54	5	11.4	4	5.0	9	7.3
55-64	4	9.1	4	5.0	8	6.5
65+	1	2.3	7	8.8	8	6.5
Gjithsej	44	100.0	80	100.0	124	100.0

Grafiku 7. Struktura e rasteve me brucelozë sipas grup-moshës




Grafiku 8. Struktura e rasteve sipas grup-moshës dhe gjinisë



Me distribuimin e rasteve me brucelozë të trajtuar në Kliniken Infektive të QKUK sipas grup-moshës shohim se më shumë se gjysma e rasteve 52.4% ishin të grup-moshës 15-34 vjeç. Strukturë të ngjashme kemi fituar edhe me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe gjinisë (Tabela 5, Grafiku 7, 8).

Grafiku 9. Llojet e transmisionit të brucelozës



Pacientët me brucelozë të trajtuar në klinikën Infektive në Prishtinë 60 (48.4%) prej tyre rrugë të transmisionit të sëmundjes kanë pasur kontaktin direkt me kafshët shtëpiake të infektuara, 13 (10.5%) e tyre kanë konsumuar qumësht dhe produkte të qumështit të kontaminuar përderisa 51(41.1%) pacientë nuk kishin njohuri për burim të infeksionit (Grafiku 9).

Tabela 6. Lloji i ekspozimit


Ekspozimi	Numri	Kolona N %
I panjohur	51	41.1%
Kontakt me lope	12	9.7%
Kontakt me dele	12	9.7%
Kontakt me dhi	14	11.3%
Lope dhe tjera	20	16.1%
Konsum të produkteve të qumështit (të dhive, deleve)	13	10.5%
Ekspozim professional	2	1.6%

Sipas llojit të ekspozimit, 16.1% kanë pasur kontakt me lopë, dele dhe dhi, 11.3% vetëm me dhi, 9.7% me dele dhe 9.7% vetëm me lopë. Ekspozim professional (veterinar dhe teknik i veterinarisë) kanë pasur 1.6% ndërsa konsumim të produkteve të qumështit 10.5% (Tabela 6).

Tabela 7. Numri i rasteve sipas muajve

Muaji	N	%
Janar	4	3.2
Shkurt	3	2.4
Mars	11	8.9
Prill	4	3.2
Maj	9	7.3
Qershor	19	15.3
Korrik	16	12.9
Gusht	9	7.3
Shtator	18	14.5
Tetor	12	9.7
Nëntor	10	8.1
Dhjetor	9	7.3
Gjithsej	124	100.0

Grafiku 10. Numri i rasteve sipas muajve




Pjesa më e madhe e pacientëve të hospitalizuar kanë qenë gjatë muajit Qershorr, gjithsejt 19 (15%) dhe në Shtator 17 (14%) ndërsa numri më i vogël në Shkurt 3 (2.4%) pacientë të pranuar në klinikë (Tabela 7, Grafiku 10)

Tabela 8. Rastet me brucellose sipas gjinisë dhe profesionit

Profesioni	Gjinia				Gjithsej	
	F	M			N	%
	N	%	N	%	N	%
Amvise	24	54.5	-	-	24	19.4
Nëpunës	3	6.8	2	2.5	5	4.0
Bujk ose blegtor	-	-	14	17.5	14	11.3
Kamarier	-	-	2	2.5	2	1.6
Kuzhinier	-	-	1	1.3	1	0.8
Nxënës	11	25.0	27	33.8	38	30.6
Pensionist	1	2.3	4	5.0	5	4.0
Portir	-	-	1	1.3	1	0.8
Punëtore	1	2.3	7	8.8	8	6.5
Rast social	-	-	2	2.5	2	1.6
Student	2	4.5	2	2.5	4	3.2
Vetirinar ose tek. i veterinës	-	-	2	2.5	2	1.6
Tregtar	-	-	1	1.3	1	0.8
Vozitës	-	-	1	1.3	1	0.8
Pa punë	-	-	2	2.5	2	1.6
Fëmijë	2	4.5	1	1.3	3	2.4
Panjohur	-	-	11	13.8	11	8.9
Gjithsej	44	100.0	80	100.0	124	100.0

Grafiku 11. Rangu i rasteve me bruceloze sipas profesionit



Rastet me brucellosë ishin të profesioneve të ndryshme, 30.6% ishin nxënës, 19.4% amvise, 11.3% bujq ose blegtor, 6.5% punëtorë, 4.0% pensionist, 4.0% nëpunës, 3.2% student, 2.4% fëmijë, nga 1,6% veterinar ose teknik i veterinës dhe kuzhinier, 1.6% të papunë, nga 0.8% kamarier, portir, tregtarë dhe vozitës (Tabela 8 dhe Grafiku 11).

Tabela 9. Anamneza pozitive për brucelozë në familje


Nr i anëtarëve familjarë me brucelozë		
	N	%
1 Anëtarë	23	19%
2-3 Anëtarë	6	5%
4-5 Anëtarë	9	7%
8 <	1	1%
Total:	39	31.5%

Sipas të dhënave anamnestike të pacientëve, 39 (31.5%) prej tyre kanë pohuar për brucelozë në anëtarë tjerë të familjes që nënkuption në epidemi familjare (Tabela 9).

Tabela 10. Kohëzgjatja e hospitalizimit të pacientëve me brucelozë sipas gjinisë

Kohëzgjatja e spitalizimit (ditë)	Gjinia		Gjithsej	
	F	M	N	%
<10	3	6.8	17	21.3
10-19	10	22.7	14	17.5
20-29	13	29.5	20	25.0
30-39	6	13.6	4	5.0
40-49	7	15.9	12	15.0
50-59	2	4.5	7	8.8
60+	3	6.8	6	7.5
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>	<b>80</b>	<b>100.0</b>
			<b>124</b>	<b>100.0</b>

Grafiku 12. Struktura e rasteve sipas kohës së hospitalizimit




Numri më i madh i rasteve me brucelozë, 33 (26.6%) ka qendruar në klinikë prej 20-29 ditë, pastaj 24 (19.4%) prej 10-19 ditë, më pak se 10 ditë, 20 (16.1%) dhe kemi pasur raste që kanë qëndruar më shumë se dy muaj në klinikë (Tabela 10 dhe Grafiku 12).

Tabela 11. Mesatarja e kohëzgjatjes së hospitalizimit (ditë) sipas gjinisë

Kohëzgjatja e spitalizimit (ditë)	Gjinia		
	F	M	Gjithsej
N	44	80	124
Mesatarja	29.5	28.4	28.8
DS	16.9	19.7	18.7
Min	3	2	2
Max	77	83	83

Mann-Whitney test      U=1893, P=0.489

Grafiku 13. Parametrat e kohëzgjatjes së hospitalizimit sipas gjinisë



Kohëzgjatja mesatare e hospitalizimit të pacientëve të përfshirë në hulumtim ishte 28.8 ditë (DS  $\pm 18.7$  ditë), rangu 2 deri 83 ditë. Kohëzgjatja mesatare e hospitalizimit te pacientëve të gjinisë femërore të përfshirë në hulumtim ishte 29.5 ditë (DS  $\pm 16.9$  ditë), rangu 3 deri 77 ditë.

Kohëzgjatja mesatare e hospitalizimit te pacientëve të gjinisë mashkullore të përfshirë në hulumtim ishte 28.4 ditë (DS  $\pm 19.7$  ditë), rangu 2 deri 83 ditë. Me Mann-Whitney test nuk kemi fituar dallim me singifikancë statistikore në mes kohëzgjatjes mesatare sipas grupeve ( $U' = 1893$ ,  $P=0.489$  pra  $P>0.05$ ), (Tabela 11 dhe Grafiku 13).

Tabela 12. Kohëzgjatja e hospitalizmit sipas moshës

		Mosha	Kohezgjatja e spitalizimit (dite)
Spearman's rho	Correlation Coefficient	1.000	.169
	Sig. (2-tailed)	.	.063
	N	124	122
	Correlation Coefficient	.169	1.000
	Sig. (2-tailed)	.063	.
	N	122	122


Me korrelacionin Spearmen kemi analizuar kohëzgjatjen e spitalizimit sipas moshës dhe ka rezultuar se nuk ka lidhje signifikante në mes moshës dhe ditëve të trajtimit në klinikë ku

P=0. 063, borderline (Tabela 12).

Tabela 13. Mesatarja e ditëve të spitalizimit ndarë sipas viteve

<u>Viti</u>	<u>Ditët e hospitalizimit</u>
2006	29.92
2007	23.38
2008	24.80
2009	20.50
2010	26.11
2011	37.30

Grafiku 14. Mesatarja e ditëve të hospitalzimit sipas viteve.



Sipas testit Kruskal Wallis, ekziston dallim signifikant në mesataren e kohëzgjatjes së hospitalzimit sipas viteve të spitalizimit me P value=0.012. Në vitin 2011 pacientët kanë qëndruar më gjatë në klinikë 37.3 ditë në krahasim me vitet tjera (Tabela 13, Grafiku 14).

Tabela 14. Rastet me brucelozë sipas numrit te hospitalizimeve në klinikën infektive

Hospitalizimi në Klinikën Infektive	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
I pare	40	90.9	75	93.8	115	92.7
I dytë	3	6.8	4	5.0	7	5.6
I tretë	1	2.3	1	1.3	2	1.6
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>	<b>80</b>	<b>100.0</b>	<b>124</b>	<b>100.0</b>
Fisher test						
Pare/Tjere			P=0.719			

Për 92.7% të rasteve me brucelozë ky ishte spitalizimi i parë në klinikën infektive (Femra 90.9% vs. Mashkuj 93.8%), për 5.6% spitalizimi i dytë (Femrat 6.8% vs. Meshkujt 5.0%) dhe për 1.6% spitalizimi i tretë (Femrat 2.3% vs. Meshkujt 1.3%). Me testin ekzakt të Fisherit nuk kemi fituar dallim me singifikancë të rëndësishme statistikore në mes numrit të hospitalizimeve dhe gjinisë (P>0.05), (Tabela 14).

Tabela 15. Spitalet/Klinikat e diagnostikimit të parë me brucelozë

Klinika/Spitale		
	N	%
Ne Kliniken e Gjinekologjise	1	1%
Ne Kliniken e Neurokirurgjis	1	1%
Ne Kliniken e Neurologjise	6	5%
Ne Kliniken e Ortopedise	10	8%
Ne Kliniken e Pedijatrise	2	2%
Ne Kliniken e Reumatologji	10	8%
Ne Kliniken e Urologjise	1	1%
Ne Spitalin e Gjilanit	1	1%
Ne Spitalin e Pejes	1	1%
Ne Spitalin e Prizrenit	3	2%
Total:	36	29%


Para hospitalizimit të pacientëve në klinikën Infektive në Prishtinë 36 gjegjësish 29% e tyre kanë qenë të shtrirë paraprakisht dhe të diagnostikuar me brucelozë në klinika dhe spitale tjera prej të cilëve më së shumti ishin me përqindje të njëjtë në klinikën e Ortopedisë dhe në klinikën e Reumatologjisë 10 (8%), (Tabela 15).

Tabela 16. Pacientët me diagnostikim ambulantorë para pranimit

Diagnostikimi ambulantorë			P-value
	N	%	
I diagnostikuar	61	49%	0.312
Status Ferbilis	12	10%	n/a


Ndërsa 61 (49%) pacientë të pranuar në klinikën tonë kanë qenë të diagnostikuar me brucelozë në mënyrë ambulantore dhe pastaj janë deleguar në klinikën tonë, 12 (10%) pacientë tjerë janë pranuar si gjendje febrile të tjerët të dyshuar në observim për brucelozë (Tabela 16)

Grafiku 15. Mesatarja e ankesave në ditë e rasteve




Me testin Mann-Whitney kemi analizuar numrin e ditëve me ankesa para hospitalizimit në mes të femrave dhe meshkujve ( $P=0.605$ ), mesatarja e ditëve me ankesa te femrat ishte 65.6 ditë ndërsa te mashkujt është 54.9 ditë dhe konkludojmë se nuk ka dallime signifikante (Grafiku 15).

Grafiku 16. Mesatarja e ankesave sipas viteve




Mesatarja e ankesave para spitalizimit sipas viteve është analizuar me testin Kruskall Wallis ku gjejmë dallim signifikant në numrin e ditëve me ankesa para hospitalzimit sipas viteve me  $P=0.045$ . Mesatarja e ditëve të ankesave ishte më e lartë në vitin 2007 me 89 ditë dhe viti 2009 me 78 ditë të ankesave të pacientëve para hospitalzimit (Grafiku 16).

Grafiku 17. Mesatarja e ankesave sipas moshës



Sipas korrelacionit Spearmen ekziston lidhje pozitive signifikante e moshës dhe ankesave të sëmundjes para spitalzimit ku  $P=0.000$ , Spearmen koeficienti= $0.377$ . ( $P=0.000$ ). Kjo interpretohet: sa më e madhe mosha aq më shumë ditë ankesa para hospitalizimit kanë pasur pacientët. Dmth pacientët e vjetër kanë ardhur më vonë në klinikë se sa atë të rinjë (Grafiku 17).

Grafiku 18. Mesatarja e ankesave sipas moshës kategorike




Sipas Mann-Whitney testit është analizuar mosha kategorike dhe mesatarja e ankesave të sëmundjes para hospitalizimit në ditë dhe kemi fituar dallim signifikant në mes fëmijëve dhe adulteve.  $P=0.005$ . Adultët kanë mesatarisht 64.64 dite ankesa për dallim nga fëmijët me 26.42 ditë (Grafiku 18).

Tabela 17. Ecuria klinike e rasteve

AKUT		SUBAKUT		KRONIK		RELAPS	
N	%	N	%	N	%	N	%
98	79%	23	18.6%	3	2.4%	8	6.5%

Grafiku 19. Ecuria klinike e rasteve



Sipas kohëzgjatjes së ankesave te pacientët tanë, me ecuri klinike akute ishin 98 (79%), me ecuri klinike subakute 23 (18.6%) dhe 3(2.4%) formë kronike (Tabela 17, Grafikoni 19).

Tabela 18. Rangu i simptomeve kryesore te rastet me brucelozë të përfshira në hulumtim

	Gjinia						P-value	
	F		M		Gjithsej			
	N	%	N	%	N	%		
Gjithsej	44	100.0	80	100.0	124	100.0		
Djersitje	26	59.1	58	72.5	84	67.7	P=0.184	
Lodhje e plogështi	31	70.5	51	63.8	82	66.1	P=0.577	
Temperaturë	24	54.5	52	65.0	76	61.3	P=0.341	
Anorexi	26	59.1	46	57.5	72	58.1	P=0.863	
Ethe	19	43.2	49	61.3	68	54.8	P=0.08	
Vjellje	3	6.8	4	5.0	7	5.6	P=0.697	
Marramendje	1	2.3	2	2.5	3	2.4	P=1.00	
Mundim	2	4.5	1	1.3	3	2.4	P=1.00	

Simptoma me e shpeshtë ka qenë Djersitja e cila është hasur te 67.7% e rasteve me brucelozë të përfshira në hulumtim ( Femrat 59.1% vs. Meshkujt 72.5% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), pastaj Lodhje e plogështi 66.1% ( Femrat 70.5% vs. Meshkujt 63.8% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), Temperaturë 61.3% ( Femrat 54.5% vs. Meshkujt 65.0% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), Anoreksi 58.1% ( Femrat 59.1% vs. Meshkujt 57.5% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), Ethe 54.8% ( Femrat 43.2% vs. Meshkujt 61.3% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), Vjellje 5.6% ( Femrat 6.8% vs. Meshkujt 5.0% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), Maramendje 2.4% ( Femrat 2.3% vs. Meshkujt 2.5% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ) dhe Mundim 2.4% ( Femrat 4.5% vs. Meshkujt 1.3% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), (Tabela 18).

Tabela 19. Prezenca e dhembjes sipas lokalizimit dhe gjinisë

Dhembje	Gjinia						P-value	
	F		M		Gjithsej			
	N	%	N	%	N	%		
Gjithsej	44	100.0	80	100.0	124	100.0		
Artik.								
Koksofemoral	20	45.5	33	41.3	53	42.7	$P=0.792$	
Lumbale	16	36.4	17	21.3	33	26.6	$P=0.107$	
Polartralgji	10	22.7	23	28.8	33	26.6	$P=0.607$	
Gjuri	13	29.5	10	12.5	23	18.5	$P=0.030$	
Koke	4	9.1	8	10.0	12	9.7	$P=0.869$	
Shpine	2	4.5	8	10.0	10	8.1	$P=0.492$	
Krahu	4	9.1	4	5.0	8	6.5	$P=0.452$	
Barku	2	4.5	5	6.3	7	5.6	$P=1.000$	
Qafe	2	4.5	-	-	2	1.6	$P=1.000$	
Shputave	2	4.5	-	-	2	1.6	$P=1.000$	
Gjoksi	-	-	1	1.3	1	0.8	$P=1.000$	
Veshit	-	-	1	1.3	1	0.8	$P=1.000$	

Dhembja ka qenë simptomë mjaft e shpeshtë shoqëruese e rasteve me brucelozë. Ajo është lokalizuar në pjesë të ndryshme të trupit më e shpeshta ka qenë në artikulacionin kokso femoral me 42.7% e rasteve me brucelozë të përfshira në hulumtim ( Femrat 45.5% vs. Meshkujt 41.3% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), pastaj dhembja në pjesën lumbale në 26.6% ( Femrat 36.4% vs. Meshkujt 21.3% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), poliartralgji në 26.6% ( Femrat 22.7% vs. Meshkujt 28.8% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), dhembje gjuri në 18.5% ( Femrat 29.5% vs. Meshkujt 12.5% me dallim signifikant sipas gjinisë  $P<0.05$ ), dhembje koke në 9.7% ( Femrat 9.1% vs. Meshkujt 10.0% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), dhembje shpine në 8.1% ( Femrat 4.5% vs. Meshkujt 10% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), dhembje krahu në 6.5% ( Femrat 9.1% vs. Meshkujt 5.0% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), dhembje barku në 5.6% ( Femrat 4.5% vs. Meshkujt 6.3% por pa dallim signifikant  $P>0.05$ ), dhembje qafe dhe shputave në nga 1.6% dhe atë vetëm te femrat, dhembje gjoksi dhe dhembje veshi nga një rast ose 0.8% dhe atë vetëm te pacientët e gjinisë mashkullore (Tabela 19).

Tabela 20. Simptomat tjera prezente te rastet me brucelozë sipas gjinisë

Simptomat tjera	Gjinia				Gjithsej			<i>P-value</i>	
	F		M						
	N	%	N	%	N	%			
Gjithsej	44	100.0	80	100.0	124	100.0			
Kollë	3	6.8	4	5.0	7	5.6		$P=1.000$	
Depresion	1	2.3	1	1.3	2	1.6		$P=1.000$	
Ajtje e artikulacionit	2	4.5	-	-	2	1.6		$P=1.000$	
Konjuktivit	1	2.3	1	1.3	2	1.6		$P=1.000$	
Afte	-	-	1	1.3	1	0.8		$P=1.000$	
Dizuri	1	2.3	-	-	1	0.8		$P=1.000$	

Kolla ka qenë prezente te 5.6% e rasteve me brucelozë (Femrat 6.8% vs. Meshkujt 5.0% pa dallim signifikant sipas gjinisë  $P>0.05$ ), Depresioni ka qenë prezent te 1.6% e rasteve me brucelozë (Femrat 2.3% vs. Meshkujt 1.3% pa dallim signifikant sipas gjinisë  $P>0.05$ ), Ajtja e artikulacionit ka qenë prezente te 1.6% e rasteve me brucelozë (Femrat 4.5% pa dallim signifikant sipas gjinisë  $P>0.05$ ), Konjuktiviti ka qenë prezent te 1.6% e rasteve me brucelozë (Femrat 2.3% vs. Meshkujt 1.3% pa dallim signifikant sipas gjinisë  $P>0.05$ ), Aftet kanë qenë prezente te 0.8% e rasteve me

brucelozë (Meshkujt 1.3% pa dallim signifikant sipas gjinisë P>0.05), Dizuria ka qenë prezent te 0.8% e rasteve me brucelozë (Femrat 2.3%, pa dallim signifikant sipas gjinisë P>0.05), (Tabela 20).

Tabela 21. Vlerat e SE te rastet me brucelozë sipas gjinisë

SE	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
Normal	11	25.0	22	27.5	33	26.6
I rritur	33	75.0	58	72.5	91	73.4
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>	<b>80</b>	<b>100.0</b>	<b>124</b>	<b>100.0</b>
<b>X<sup>2</sup>-test</b>		<b>X<sup>2</sup>=0.009, P=0.929</b>				
Mesatarja ± DS	26.9 ± 22.6		22.5 ± 17.4		24.1 ± 19.4	
Rangu	4 – 95		3 – 80		3 – 95	

Në 73.4% të rasteve vlerat e SE kanë qenë të rritura (Femrat 75.0% vs. Meshkujt 72.5% por pa dallim signifikant sipas gjinisë, P>0.05). Vlera mesatare e SE te pacientëve të përfshirë në hulumtim ishte 24.1 (DS ±19.4), rangu 3 deri 95. Vlera mesatare e SE te pacientëve të gjinisë femërore të përfshirë në hulumtim ishte 26.9 (DS ±22.6), rangu 4 deri 95. Vlera mesatare e SE te pacientëve të gjinisë mashkullorë të përfshirë në hulumtim ishte 22.5 (DS ±17.4), rangu 3 deri 80 (Tabela 21).

Tabela 22. Vlerat e eritrociteve sipas gjinisë

Eritrocitet	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
Normal	18	40.9	53	66.3	71	57.3
Të zvogluara	26	59.1	27	33.8	53	42.7
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>	<b>80</b>	<b>100.0</b>	<b>124</b>	<b>100.0</b>
<b>X<sup>2</sup>-test</b>	<b>X<sup>2</sup>=6.44, P=0.011</b>					
Mesatarja ± DS	3.8 ± 0.5		4.3 ± 0.6		4.1 ± 0.6	
Rangu	3 - 5.2		3.2 - 5.8		3 - 5.8	

Në 42.7% të rasteve vlerat e eritrociteve kanë qenë të zvogluara (Femrat 59.1% vs. Meshkujt 33.8% me dallim signifikant sipas gjinisë, P<0.05). Numri mesatar i eritrociteve te pacientët e përfshirë në hulumtim ishte  $4.1 \times 10^6$  (DS ±0.6x10<sup>6</sup>), rangu 3 deri  $5.8 \times 10^6$ . Numri mesatar i

eritrociteve te pacientëve të gjinisë femërore të përfshirë në hulumtim ishte  $3.8 \times 10^6$  (DS  $\pm 0.5 \times 10^6$ ), rangu 3 deri  $5.2 \times 10^6$ . Numri mesatar i eritrociteve te pacientëve të gjinisë mashkullorë të përfshirë në hulumtim ishte  $4.3 \times 10^6$  (DS  $\pm 0.6 \times 10^6$ ), rangu 3.2 deri  $5.8 \times 10^6$ , (Tabela 22).

Tabela 23. Vlerat e hemoglobinës te rastet me brucelozë sipas gjinisë

Hemoglobina	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
Normal	25	56.8	57	71.3	82	66.1
E zvogëluar	19	43.2	23	28.8	41	33.1
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>	<b>80</b>	<b>100.0</b>	<b>124</b>	<b>100.0</b>
<b>X<sup>2</sup>-test</b>	<b>X<sup>2</sup>=2.03, P=0.153</b>					
Mesatarja $\pm$ DS	$11.4 \pm 1.5$		$12.4 \pm 1.8$		$12.0 \pm 1.7$	
Rangu	8.2 - 15.5		8.4 - 16.1		8.2 - 16.1	

Në 33.1% të rasteve vlerat e hemoglobines kanë qenë të zvogluara (Femrat 43.2% vs. Meshkujt 28.8% por pa dallim signifikant sipas gjinisë, P>0.05). Vlera mesatare e hemoglobinës te pacientëve të përfshirë në hulumtim ishte 12.0 (DS  $\pm 1.7$ ), rangu 8.2 deri 16.1. Vlera mesatare e hemoglobines te pacientëve të gjinisë femërore të përfshirë në hulumtim ishte 11.4 (DS  $\pm 1.5$ ), rangu 8.2 deri 15.5. Vlera mesatare e hemoglobines te pacientëve të gjinisë mashkullorë të përfshirë në hulumtim ishte 12.4 (DS  $\pm 1.8$ ), rangu 8.4 deri 16.1, (Tabela 23).

Tabela 24. Vlerat e leukociteve sipas gjinisë

Leukocitet	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
Normal	38	86.4	71	88.8	109	87.9
Të ulura	6	13.6	9	11.3	15	12.1
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>	<b>80</b>	<b>100.0</b>	<b>124</b>	<b>100.0</b>
<b>X<sup>2</sup>-test</b>	<b>X<sup>2</sup>=0.001, P=0.918</b>					
Mesatarja $\pm$ DS	$6.4 \pm 3.5$		$7.3 \pm 3.7$		$7.0 \pm 3.6$	
Rangu	4.4 - 15.4		3.7 - 14.8		3.7 - 15.4	

Në 12.1% të rasteve vlerat e leukociteve kanë qenë të ulura (Femrat 13.6% vs. Meshkujt 11.3% por pa dallim signifikant sipas gjinisë, P>0.05). Numri mesatar i leukociteve te pacientët e përfshirë në hulumtim ishte  $7.0 \times 10^9$  (DS  $\pm 3.6 \times 10^9$ ), rangu 3.7 deri  $15.4 \times 10^9$ . Numri mesatar i

leukociteve te pacientëve të gjinisë femërore të përfshirë në hulumtim ishte  $6.4 \times 10^9$  (DS  $\pm 3.5 \times 10^9$ ), rangu 4.4 deri  $15.4 \times 10^9$ . Numri mesatar i leukociteve te pacientëve të gjinisë mashkullore të përfshirë në hulumtim ishte  $7.3 \times 10^9$  (DS  $\pm 3.7 \times 10^9$ ), rangu 3.7 deri  $14.8 \times 10^9$ , (Tabela 24).

Tabela 25. Përqindja e limfociteve në formulën leukocitare

Numri i limfociteve	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
I rritur	9	20.5	9	11.3	18	14.5
Normal	35	79.5	71	88.8	106	85.5
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>	<b>80</b>	<b>100.0</b>	<b>124</b>	<b>100.0</b>
<b>X<sup>2</sup>-test</b>	<b>X<sup>2</sup>=1.237, P=0.260</b>					

Vetëm te 14.5% e rasteve ka qenë i rritur numri i limfociteve (Tabela 25).

Tabela 26. Rezultatet e Trombociteve sipas gjinisë

Trombocitet	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
Normal	21	100.0	47	92.1	68	94.4
Të ulura	0	00.0	4	7.8	4	5.5
<b>Gjithsej</b>	<b>21</b>	<b>100.0</b>	<b>51</b>	<b>100.0</b>	<b>72</b>	<b>100.0</b>
<b>X<sup>2</sup>-test</b>	<b>X<sup>2</sup>=3.967, P=0.913</b>					
Mesatarja $\pm$ DS	$271 \pm 16.14$		$238 \pm 66.13$		$249 \pm 69.52$	
Rangu	151 – 390		116 – 388		116 – 390	

Në 5.5% të rasteve vlerat e trombociteve (të punuara në 72 raste) kanë qenë të ulura dhe atë vetëm te gjinia mashkullore,  $P>0.913$ . Numri mesatar i trombociteve te pacientët e përfshirë në hulumtim ishte 238.000 (DS  $\pm 66.13$ ), rangu 116 deri 390 (Tabela 26).

Tabela 27. Rezultatet e CRP te rastet me brucelozë sipas gjinisë

CRP	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
Normale	9	46.4	8	42.5	17	21.0
Të rritura	18	53.5	46	57.5	64	79.0
<b>Gjithsej</b>	<b>27</b>	<b>100.0</b>	<b>54</b>	<b>100.0</b>	<b>81</b>	<b>100.0</b>
<b>X<sup>2</sup>-test</b>	<b>X<sup>2</sup>=0.003871, P=0.04</b>					

Në 79.0% të rasteve vlerat e CRP (e punuar në 81 patientë) kanë qenë të rritura (Femrat 53.5% vs. Meshkujt 57.5% me dallim signifikant sipas gjinisë, P<0.04 (Tabela 27).

Tabela 28. Rezultatet e Bil T te rastet me brucelozë sipas gjinisë

BilT	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
Normal	43	97.7	77	96.3	120	96.8
Rritur	1	2.3	3	3.8	4	3.2
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>	<b>80</b>	<b>100.0</b>	<b>124</b>	<b>100.0</b>
<b>Fisher test</b>	<b>P&gt;0.05</b>					
Mesatarja ± DS	10.0 ± 4.6		12.3 ± 6.3		11.4 ± 5.8	
Rangu	2.6 - 19.7		2.1 - 26.3		2.1 - 26.3	

Siq shihet në tabelën 28, në 3.2% të rasteve vlerat e bilirubine totale kanë qenë të rritura (Femrat 2.3% vs. Meshkujt 3.8% por pa dallim signifikant sipas gjinisë, P>0.05). Vlera mesatare e bilirubinës totale te patientët e përfshirë në hulumtim ishte 11.4 µmol/L (DS ±5.8 µmol/L), rangu 2.1 deri 26.3 µmol/L. Vlera mesatare e bilirubinës totale te patientëve të gjinisë femërore të përfshirë në hulumtim ishte 10.0 µmol/L (DS ±4.6 µmol/L), rangu 2.6 deri 19.7 µmol/L. Vlera mesatare e bilirubinës totale te patientëve të gjinisë mashkullorë të përfshirë në hulumtim ishte 12.3 µmol/L (DS ±6.3 µmol/L), rangu 2.1 deri 26.3 µmol/L.

Tabela 29. Rezultatet e Bil D te rastet me brucelozë sipas gjinisë

BilD	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
Normal	41	93.2	78	97.5	119	96.0
Rritur	3	6.8	2	2.5	5	4.0
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>	<b>80</b>	<b>100.0</b>	<b>124</b>	<b>100.0</b>
<b>Fisher test</b>	<b>P&gt;0.05</b>					
Mesatarja						
± DS	$9.9 \pm 20.1$		$4.3 \pm 4.6$		$6.9 \pm 14.2$	
Rangu	0.2 - 83.1		0.2 - 20.2		0.2 - 83.1	

Siq shihet në tabelën 29, në 4.0% të rasteve vlerat e bilirubines direkte kanë qenë të rritura (Femrat 6.8% vs. Meshkujt 2.5% por pa dallim signifikant sipas gjinisë, P>0.05). Vlera mesatare e bilirubinës direkte te pacientët e përfshirë në hulumtim ishte  $6.9 \mu\text{mol/L}$  ( $\text{DS} \pm 14.2 \mu\text{mol/L}$ ), rangu 0.2 deri  $83.1 \mu\text{mol/L}$ . Vlera mesatare e bilirubinës direkte te pacientëve të gjinisë femërore të përfshirë në hulumtim ishte  $9.9 \mu\text{mol/L}$  ( $\text{DS} \pm 20.1 \mu\text{mol/L}$ ), rangu 0.2 deri  $83.1 \mu\text{mol/L}$ . Vlera mesatare e bilirubinës direkte te pacientëve të gjinisë mashkullorë të përfshirë në hulumtim ishte  $4.3 \mu\text{mol/L}$  ( $\text{DS} \pm 4.6 \mu\text{mol/L}$ ), rangu 0.2 deri  $20.2 \mu\text{mol/L}$ .

Tabela 30. Rezultatet e AST te rastet me brucelozë të përfshira në hulumtim sipas gjinisë

AST	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
Normal	10	22.7	30	37.5	40	32.3
Rritur	22	50.0	38	47.5	60	48.4
Nuk është bërë	12	27.3	12	15.0	24	19.4
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>	<b>80</b>	<b>100.0</b>	<b>124</b>	<b>100.0</b>
<b>X<sup>2</sup>-test</b>	<b>X<sup>2</sup>=1.01, P=0.314</b>					
Mesatarja	$37.2 \pm 23.1$		$43.7 \pm 35.7$		$41.6 \pm 32.2$	
Rangu	13 - 114		11 - 250		11 - 250	

Në 48.4% të rasteve vlerat e AST kanë qenë të rritura (Femrat 50% vs. Meshkujt 47.5% por pa dallim signifikant sipas gjinisë, P>0.05). Vlera mesatare e AST te pacientët e përfshirë në hulumtim ishte 41.6 UI/L (DS  $\pm$ 32.2 UI/L), rangu 11 deri 250 UI/L. Vlera mesatare e AST te pacientëve të gjinisë femërore të përfshirë në hulumtim ishte 37.2 UI/L (DS  $\pm$ 23.1 UI/L), rangu 13 deri 114 UI/L. Vlera mesatare e AST te pacientëve të gjinisë mashkullorë të përfshirë në hulumtim ishte 43.7 UI/L (DS  $\pm$ 35.7 UI/L), rangu 11 deri 250 UI/L (Tabela 30).

Tabela 31. Rezultatet e ALT te rastet me brucelozë sipas gjinisë


ALT	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
Normal	20	45.5	46	57.5	66	53.2
Rritur	10	22.7	23	28.8	33	26.6
Nuk është bërë	14	31.8	11	13.8	25	20.2
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>	<b>80</b>	<b>100.0</b>	<b>124</b>	<b>100.0</b>
<b>X<sup>2</sup>-test</b>	<b>X<sup>2</sup>=0.00, P=0.999</b>					
Mesatarja $\pm$ DS	$35.1 \pm 27.9$		$48.7 \pm 48.1$		$44.6 \pm 43.3$	
Rangu	5 – 126		10 – 245		5 – 245	

Në 26.6% të rasteve vlerat e ALT kanë qenë të rritura (Femrat 22.7% vs. Meshkujt 28.8% por pa dallim signifikant sipas gjinisë, P>0.05). Vlera mesatare e ALT te pacientët e përfshirë në hulumtim ishte 44.6 UI/L (DS  $\pm$ 43.3 UI/L), rangu 5 deri 245 UI/L. Vlera mesatare e ALT te pacientëve të gjinisë femërore të përfshirë në hulumtim ishte 35.1 UI/L (DS  $\pm$ 27.9 UI/L), rangu 5 deri 126 UI/L. Vlera mesatare e ALT te pacientëve të gjinisë mashkullorë të përfshirë në hulumtim ishte 48.7 UI/L (DS  $\pm$ 48.1 UI/L), rangu 10 deri 245 UI/L (Tabela 31).

Tabela 32. Ehosonografia e ekzaminimit të abdomenit

	Numri	C %
ECHO abdomen	Pvp	28
	Hepatomegali	42
	Splenomegali	11
	Hepatosplenomegali	9
	Kalcifikate ne melqi	1
	Hepatomegalia, steatosis	1

Grafiku 20. Gjetjet patologjike me ehosonografi të abdomenit



Me Echo te abdomenit te 9.8% e pacientëve është zbuluar hepatosplenomegali, 45.7% hepatomegali dhe 12% splenomegali (Tabela 32, Grafiku 20).

Tabela 33. Rezultatet e titrit Wright sipas gjinisë


Wright	Gjinia					
	F		M		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
1 : 40	1	2.3	-	-	1	0.8
1 : 80	-	-	1	1.3	1	0.8
1 : 160	7	15.9	2	2.5	9	7.3
1 : 320	7	15.9	10	12.5	17	13.7
1 : 640	9	20.5	19	23.8	28	22.6
1 : 1280	9	20.5	24	30.0	33	26.6
1 : 2560	11	25.0	24	30.0	35	28.2
Gjithsej	44	100.0	80	100.0	124	100.0

Titri më i shpeshtë në fillim të trajtimit ishte 1:2560 në 28,2% pastaj titri 1:1280 në 26,6% të rasteve, (Tabela 33).


Tabela 34: Shkalla e prevalences se komplikimeve në mesin e të pacientëve të egzaminuar

Karakteristikat	Gjinia					
	Femra		Meshkuj		Totali	
	N	%	N	%	N	%
Me ndërlikime	18	40.9	34	42.5	52	41.9
Pa ndërlikime	5	11.4	7	8.8	12	9.7
Nuk është punuar	21	47.7	39	48.8	60	48.4
Totali i pacienteve (N)	44	100.0	80	100.0	124	100.0

Grafiku 21. Prevalenca e ndërlikimeve në mesin e pacientëve të ekzaminuar




Grafiku 22. Prevalenca e ndërlikimeve në mesin e pacientëve sipas gjinisë



Shkalla e prevalences se komplikimeve në mesin e 64 (51,2%) pacientëve të evaluuar për ndërlikime ishte 52 gjegjësisht 41,9% (Tabela 34, Grafiku 21, 22).

Grafiku 23. Prevalenca e llojeve të ndërlikimeve në mesin e të gjithë pacientëve të ekzaminuar



Prevalenca më e lartë e llojeve të ndërlikimeve te të gjithë të ekzaminuarit ishte Synoviti C/F në 20,2% të rasteve pastaj Bronchopneumonia në 11,3%, Sacroileiti në 6,5% të rasteve (Grafiku 23.)

Tabela 35. Prevalenca e llojeve të ndërlikimeve në mesin e të gjithë pacienteve të egzaminuarve sipas gjinisë


Ndërlikimet	Gjinia					
	Femra		Meshkuj		Totali	
	N	%	N	%	N	%
Synoviti C/F	8	18.2	17	21.3	25	20.2
Bronkopneumonia	4	9.1	10	12.5	14	11.3
Sacroileitis	4	9.1	4	5.0	8	6.5
Radikulopati te vertebrave L/S	1	2.3	4	5.0	5	4.0
Scleroze C/F	2	4.5	3	3.8	5	4.0
Pneumonia	0	0.0	3	3.8	3	2.4
Spondilit	0	0.0	3	3.8	3	2.4
Gonitis	2	4.5	0	0.0	2	1.6
Scleroze vertebrave thorakale	0	0.0	2	2.5	2	1.6
Thromboze VF dhe VP	0	0.0	2	2.5	2	1.6
Meningjit seroz	1	2.3	1	1.3	2	1.6
Osteomijelit L2/L3 me fractura kompresive vertebrale	1	2.3	0	0.0	1	0.8
Polineuropatia	1	2.3	0	0.0	1	0.8
P.V.P	5	11.4	7	8.8	12	9.7
Nuk eshte punuar	21	47.7	39	48.8	60	48.4
Totali i pacienteve (N)	44	100.0	80	100.0	124	100.0

Tabela 35. Sipas gjinisë prevalencë më e lartë e ndërlikimeve ishte te meshkujt e që ishte Synoviti C/F në 21,3% dhe Bronchopneumonia në 12.5% të rasteve.

Tabela 36. Prevalenca e llojeve të ndërlikimeve në mesin e të gjithë pacientëve të egzaminuar sipas moshës


Ndërlikimet	Mosha					
	Fëmijë		Adult		Totali	
	N	%	N	%	N	%
Synoviti C/F	9	34.6	16	16.3	25	20.2
Bronkopneumonia	2	7.7	12	12.2	14	11.3
Sacroileitis	1	3.8	7	7.1	8	6.5
Radikulopati te vertebrave L/S	0	0.0	5	5.1	5	4.0
Scleroze C/F	1	3.8	4	4.1	5	4.0
Pneumonia	0	0.0	3	3.1	3	2.4
Spondilit	0	0.0	3	3.1	3	2.4
Gonitis	0	0.0	2	2.0	2	1.6
Scleroze vertebrave thorakale	0	0.0	2	2.0	2	1.6
Thromboze	0	0.0	2	2.0	2	1.6
Meningjit seroz	0	0.0	2	2.0	2	1.6
Osteomijelit L2/L3 me fractura kompresive vertebrale	0	0.0	1	1.0	1	0.8
Polineuropatia	0	0.0	1	1.0	1	0.8
P.V.P	3	11.5	9	9.2	12	9.7
Nuk është punuar	12	46.2	48	49.0	60	48.4
Gjithsej pacientë (N)	26	100.0	98	100.0	124	100.0

Grafiku 24. Korrelacioni i ndërlikimeve dhe kohëzgjatjes së hospitalizimit




Pacientët pa ndërlikime kanë qenë të hospitalizuar mesatarisht 23.39 ditë, përkundër atyre me ndërlikime 36.86. Testi Mann-Whitney tregon që ekziston dallim signifikant për kohëzgjatjen e spitalizimit (ditë) në mes të pacientëve me komplikime dhe atyre pa komplikime.  $P=0.000$ . (Grafiku 24).

Grafiku 25. Korrelacioni i SE me ndërlikimet




Me Mann Whitney test nuk ka dallime signifikante të mesatarës së SE në mes të pacientëve me ndërlikime dhe atyre pa ndërlikime  $p=0.822$  (Grafiku 25).

Grafiku 26. Korrelacioni i mesatares së Le me ndërlikimet



Sa i përket mesatarës së Le në mes të pacientëve me ndërlikime dhe atyre pa ndërlikime me ann-Whitney test nuk kemi fituar dallim me signifikancë  $p=0.147$  (Grafiku 26).

Grafiku 27. Korrelacioni i ndërlikimeve dhe mesatares së CRP



Mann-Whitney test tregon që nuk ka dallime signifikante të mesatarës së CRP-së në mes të pacientëve me ndërlikime dhe atyre pa ndërlikime.,  $p=0.694$ , (Grafiku 27).

Tabela 37. Koinfekzionet, pacientet gravide dhe mbas lindjes me brucelozë


Tularemi	2 (1.6%)
Coxit septik me Otit supurativ (Eksudati synovial: Streptococcus Pneumoniae)	1 (0.8%)
Coxit tuberkular (Eksudati synovijal: BK+LOW pozitiv)	1 (0.8%)
Hepatit kronik B	1 (0,8%)
Gravide ml IV, VIII	2 (1.6%)
Status post partum	1 (0.8%)
Cistits me E. Coli dhe me Citrobacter spp.	3(2,4%) 1(0,8%)

Në mesin e pacientëve tanë 1 (1.6%) kanë pasur koinfektion me Tularemi, 1(0.8%) coxit bakteror supurativ dhe 1(0.8%) coxit tuberkularë, 2(1.6%) cistit me E. Coli dhe 3 (2.4%) cistit me Citrobakter si dhe 1(0.8%) me Hepatit kronik B. Ndërsa 2 (1.6%) paciente ishin gravde në muajin e IV dhe Vlll lunar si dhe 1 (0.8%) paciente pas lindjes (Tabela 37).

Tabela 38. Trendi i titrit Wright pas 2 javë të trajtimit

	Numri	%
Wright Titri	Njëjtë	22
	Ulje	35
	Rritje	10
	Total	67
		100%

Grafiku 28 . Trendi Wright i punuar pas 2 javë të trajtimit



Titri Wright i pacientëve i punuar për herë të dytë pas 2 javë te 67 (54%) pacientë tregon që 35 apo 52.2% ka pasur ulje, në 22 apo 32.8% ka qenë akoma i njëjtë ndërsa në 10 gjegjësisht 14.9% të pacijentëve ka pasur akoma rritje (Tabela 37, Grafiku 28 ).

Tabela 39. Antibiotikët e aplikuar në mjekimin e pacientëve me brucelozë


	N	%
Gjithsej	124	100.0
Streptomycin	92	74.2
Gentamicin	18	14.5
Doksiciklin	105	84.7
Rifampicin	104	83.9
TMP/SMX	11	8.9
Kortikoterapi	22	17.7

Te pacientet e trajtuar ne kliniken infektive në Prishtinë më së shpeshti është ordinuar Doksicilin 84.7%, pastaj Rifampicin 83.9%, Streptomicin 74.2%, Gentamicin 14.5% dhe TMP/SMX 8.9%. Te 22 pacientë ose 17.7% është ordinuar edhe kortikoterapia perveq antibiotikëve dhe 1.6% antikoagulantë (Tabela 38).

Tabela 40. Kombinimet e aplikuara të antibiotikëve në trajtim të pacientëve

Terapia e kombinuar antibiotike	Numri i pacientëve	Përqindja e pacientëve
Streptomicin+Doksiciklin+Rifadin	90	72.6%
Gentamicin+Doksiciklin+Rifadin	12	9.7%
Gentamicin+Rifadin+TMP/SMX	8	6.5%
Streptomicin+Rifadin+TMP/SMX	3	2.4%
Doksiciklin+Rifadin	8	6.5%
Rifadin+TMP/SMX	2	1.6%
Doksiciklin	1	0.8%

Grafiku 29. Paraqitja grafike e kombinimeve antibiotike të aplikuara te pacientët me brucelozë.



Sa i përket kombinimit të antibiotikëve në trajtim të pacientëve me brucelozë, 72.6% e rasteve janë trajtuar me tre javë Streptomycin dhe Doksiciklin, duke vazhduar më tej së paku edhe katër javë tjera me Doksiciklin dhe Rifampicin. Ndërsa vetëm një rast gjatë kësaj periudhe kohore 6 vjecare, ka qenë trajtuar me monoterapi Doksiciklin në vitin 2006 dhe që ky pacient i moshës 14 vjecare ka pasur tri herë relapse (Tabela 39, Grafiku 29)

#### **IV. DISKUTIMI**

Bruceloza, e njohur edhe si “ Ethet undulante ”, “Ethet Mediterane” ose “Ethet e Malta-s” është zoonozë që transmetohet me kontakt direkt ose indirekt me kafshët e infektuara ose produktet e tyre. Kjo sëmundje atakon njerëzit e të gjitha moshave dhe të dy gjinitë.

Edhepse është arritur progres në kontrollin e sëmundjes në shumë vende të botës, ende mbeten vende ku infeksioni perziston në kafshët shtëpiake, dhe transmisioni në njerëz ndodhë shpesh. Bruceloza është e shpeshtë në shumë pjesë të botës sidomos në vendet Mediterane të Evropës, Afrikën veriore dhe lindore, Lindjen e Mesme, Azinë jugore dhe qëndrore, Amerikën qëndrore dhe jugore dhe ende është e pa detektuar dhe shpesh e paraportuar (1).

Në Kosovë rastet e para me brucelozë janë paraqitur në vitin 1980 me tetë raste (29). Sipas një hulumtimi të bërë në Kosovë në vitin 2001 nga British Veterinary Association, ekzaminimi i kulturave të qumështit të lopëve në katër raste ka rezultuar me izolim të *B. melitensis* biovar 3 dhe nga gjaku i deleve në një rast, pastaj *B. abortus* biovar 2 është izoluar nga qumështi i lopës në një rast, dhe *B. abortus* biovar 1 është izoluar nga delet në dy raste. Shtami i paspecifikuar i *B. abortus* ka qenë i izoluar në një rast nga gjaku i deles.

Sidoqoftë prevalanca më e madhe e brucelozës është konstatuar në dele dhe dhi se sa në lopë dhe gjedhe dhe me predominim të *B. melitensis* sepse këto kafshë janë bujtës natyror të saj ndërsa *B. abortus* është e rrallë në dele e dhi.

Në studimin tonë kemi analizuar 124 raste me brucelozë të cilat janë trajtuar në klinikën Infektive në Prishtinë nga muaji janar i vitit 2006 deri në fund të muajit dhjetor të vitit 2011.

Konstatojmë se gjatë kësaj periudhe 6 vjeçare numri më i madh i rasteve të hospitalizuara ishte në vitin 2010 me 28.2% pastaj në vitin 2011 me 24.2%. Numri më i vogël i rasteve ishte në vitin 2007 me 6.5% të rasteve.

Pra, numri i rasteve kishte tendencë të rritjes. Një nga arsyet e rritjes së numrit të rasteve mund të ndërlidhet me rritjen e mundësive ekonomike të popullatës për blerjen e kafshëve shtëpiake për zhvillimin e ekonomisë familjare dhe në anën tjetër tregëtia ilegale e kafshëve shtëpiake në vendin tonë nga vendet fqinje për shkak të kostos më të ultë e që në fakt shpesh nuk janë kafshë të kontrolluara dhe të identifikuara në brucelozë.

Bruceloza edhe me tutje paraqet problem shëndetësor dhe social në Kosovë.

Sipas të dhënave nga Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik të Kosovës, në vitin 1991 janë raportuar 241 raste dhe incidenca vjetore gjatë viteve 1990-ta ka qenë mes 3-5 raste në 100,000 banorë. Gjate periudhës 2000-2004 në 11 komuna të Kosovës, mesatarja e morbiditetit ka qenë 2.97/100,000 banorë (31).

Ndërsa, incidenca më e lartë e rasteve me brucelozë nga viti 2006-2011 ishte në vitin 2010 me MB 4.9/100,000 banorë që përputhet me numrin e rasteve të trajtuar në klinikën tonë në po këtë vit.

Sipas Institutit të Shëndetit Publik, incidenca vjetore në Shqipëri në vitin 2003 ka qenë 31.6/100.000 banorë, ndërkohë që 10 vite më parë ka qenë 0.1 raste /100.000 banorë (73). Në Sicili në vitin 2002 incidenca ishte 8.0/100.000 banorë (185).

Sipas OBSH shkalla e incidencës së raportuar në vit e brucelozës humane në zonat endemike në mbarë botën varirojnë  $< 0.01$  deri në  $>200$  raste për 100,000 njerëz. Në vitin 2005, shkalla e incidencës së raportuat në vit për 100,000 njerëz ishte: 160.30 në Siri, 60.60 në Mongoli, 26.20 në Turqi dhe 21.40 në Arabinë Saudite (18).

Regjione të shumta, Franca dhe Amerika Latine, kanë arritur kontrollin ndaj kësaj sëmundje. Në disa vende siq janë Portugalia, Spanja, Tunizia dhe Jordania, incidenca e brucelozës në mënyrë signifikante është ulur.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë në Kuvajt, në vitin 2006 incidenca e popullatës nga 68.9/100.000 banorë në vitin 1985 ka zbritur në 2.1/100.000 (18, 186).

Në Greqinë qëndrore, në Larissa, nga viti 2003-2005 incidenca e brucelozës humane ishte 32,49 MB/100,000 banorë (187).

Në kantonin e Bosnes qëndrore, nga viti 2003-2012, janë të regjistruar 528 pacientë, kryesisht komuna e Travnik-ut. Në vitin 2007, incidenca e brucelozës humane ishte 57.2/100.000 banorë ndërsa numri më i madhë ka qenë në vitin 2008 me MB 64.8/100.000 banorë.

Përndryshe në këtë kanton rasti i parë me brucelozë është paraqitur në vitin 1978 (188).

Nga viti 1980-2009, sipas autorit Donev mesatarja e shkallës së incidencës në Maqedoni ka rezultuar 18.9/100.000 (19).

Përkundër kësaj, incidenca është në rritje në vendet siq janë Turqia, Algjeria, në regjione të shumta në Evropën jugore dhe në Afrikë, përderisa situata në vende të tjera si Siria është përkeqësuar në mënyrë rapide (18).

Në Turqi, bruceloza është mjaft e shpeshtë, sidomos në regjionet e Anatolisë së mesme, lindore dhe juglindore. Sipas raportimit të Ministrisë së Shëndetësisë së Turqisë në vitin 2004 shkalla e incidencës është 25.67/100.000 (190).

Sipas një publikimi të autorëve Izraelit, në vitin 2009 shkalla e incidencës për 100.000 banorë ka qenë 7.0 te popullata arabe ndërsa ajo hebreje 0.2 (190).

Bruceloza është eradikuar në Angli, shtetet e Evropës veriore, Australi, Zelandë të re dhe Kanada (157)

Në pjesën lindore të Arabisë Saudite, shkalla e incidencës për 100.000 banorë ka qenë e rritur nga 13 në 70 në mes të vitëve 1983-1987, pastaj ka zbritur në MB 9/100.000 banorë në vitin 2006 (25).

Rastet me brucelozë të trajtuarat në klinikën Infektive në Prishtinë ishin nga 61 vendbanime gjegjësish nga 20 Komuna të Kosovës.

Numri më i madh i tyre ishte nga komuna e Prishtinës, 18.5% pastaj nga Lipjani 16.1%, Vushtria 7.3%, Shtimja dhe Malisheva 6.5% , Prizreni 4.8%.

Siç shihet, numri i rasteve me brucelozë nga komuna e Prizrenit ishte jo i madh nëse nisemi nga fakti që ky regjion njihet si zonë më endemike e brucelozës në Kosovë. Kjo për arsyen se shumica e pacientëve të kësaj komune trajtohen në repartin Infektiv në Prizren, si dhe nga komuna e Malishevës, Suharekës dhe Rahovecit, për shkak të afërsisë territoriale.

Nga studimi ynë shihet që Lipjani edhe më tej qëndron si regjion i njojur endemik i brucelozës në Kosovë dhe që bashkë me pacientët nga komuna e Vushtrisë, Podujevës dhe Vitisë kanë qenë më frekuentë në klinkën tonë.

Shikuar sipas regjioneve gjeografike, 67.7% e pacientëve ishin nga regjionet rurale ndërsa 32.6% nga ato urbane që përputhet edhe me statistikat e Agjencionit Statistikor të Kosovës ku përqindja e shtrirjes së popullsisë në vende rurale dhe urbane është në raport të drejtë ( popullata rurale 62% vs urbane 34%) sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, të përditësuar me 26.05.2015.

Në shumë publikime të jashtme gjejmë të dhëna të njëjtë të dominimit të popullatës rurale në prevalcën e të sëmurëve me brucelozë (15, 37,192, 193, 194).

Një fakt tjetër që e mbështetë këtë argument është se popullsia rurale profesion bazë e ka bujqësinë dhe blegtorinë, që do të thotë se ka kontakt më të shpeshtë me kafshët shtëpiake dhe produktet e tyre. Një fakt tjetër mund ta përmendim arsimimin më të ulët të popullatës rurale në krahasim me

atë urbane. Shkak tjetër është mungesa e kushteve higjenike dhe sanitare si dhe atyre infrastrukturore respektivisht mungesë të shërbimit të mirëfilltë veterinarë e shëndetësorë.

Nga 124 rastet me brucelozë, 64.5% ishin të gjinisë mashkullore dhe 35.5% të gjinisë femërore. Me  $X^2$ -test kemi fituar dallim me signifikancë të rëndësishme statistikore në numrin e rasteve sipas gjinisë ( $X^2$ -testi=10.45,  $P=0.001$ ). Sipas të dhënave të Agjensionit Statistikor Kosovar në Kosovë 50.3% e banorëve janë të gjinisë mashkullore dhe 49.7% të gjinisë femërore, kjo është në proporcion të zhdrojtë me rezultatin e studimit tonë.

Kjo do të thotë se ky dallim në bazë gjinore sa i përketë pacientëve mashkuj në numër më madhë ka lidhje me rrëthanat jetësore në vendet rurale ku me punët rreth blegtorisë në përqindje më të madhe meren mashkujt, andaj kjo prevalencë më e madhe e tyre mund të spjegohet me këtë fakt. Të dhëna të përaferta të prekjes më të shpeshtë të gjinisë mashkullore me brucelozë gjejmë në publikime të shumë autorëve të huaj (15, 23, 187, 193, 198, 199).

Në Itali, gjate periudhës 1997-2002, raporti i pacientëve sipas gjinisë mashkull me femër ishte 62% me 38% që përkon me studimin e pacientëve tanë (185).

Mosha mesatare e rasteve me brucelozë ishte 30.8 vjet, rangu 2-74 vjeç.

Mosha mesatare e rasteve te gjinisë femërore ishte 30.0 vjeç, rangu 2-72 vjeç ndërsa e gjinisë mashkullore ishte 31.2 vjeç, rangu 4-74 vjeç.

Me t-test të mesatares nuk kemi fituar dallim me signifikancë të rëndësishme statistikore në mes moshës mesatare sipas gjinisë  $T=0.23$ ,  $P=0.895$ .

Kjo është moshë relativisht e re dhe aktive në profesione të ndryshme që ndërlidhen edhe me punë rreth kafshëve shtëpiake. Këtë e mbështetë e dhëna që ka të bëjë me numrin e madh të popullatës së re në Kosovë. Mesataren e ngajshme të moshës e gjejmë te shumë autorë të huaj në publikimet e tyre (22, 193, 194, 203).

Mosha mesatare në Shqipëri është 38 vjeç ndërsa në Bosnën qëndrore 39.1 vjeç, Maqedoni 36 vjeç, në Iran 26.9 vjeç. Në Turqi mosha mesatare e pacientëve është 36.8 por me dominim të gjinisë femërore 75.5%. Në Australinë veriore mosha mesatare e të sëmurëve me brucelozë është 35 vjeç dhe e veqanta është që numri total i pacientëve në këtë studim kanë qenë mashkuj kryesisht gjuetarë të derrave të egër (203, 204, 205, 206, 207).

Sa i përket mesatarës së moshës sipas vendbanimit rural dhe urban kemi fituar dallim signifikant,  $p=0.041$  ngase pacientët nga fshati janë më të rinj me moshë mesatare 28.04 vjeç, ndërsa ata nga qyteti 36.14 vjeç. Kjo shpjegohet nga fakti që shumë familje blegtorësh që mbajnë kafshë shtëpiake

personale, fëmijët e tyre të moshës shkollore ndihmojnë rrith punëve të bagëtisë, ndërsa fëmijët parashkollarë lozin me kafshët sidomos me kafshët e posalindura.

Në 48.4% të pacientëve rrugë të transmisionit të sëmundjes kanë pasur kontaktin direkt me kafshët shtëpiake të infektuara, 10.5% kanë konsumuar qumësht dhe produkte të qumështit të kontaminuar përderisa 41.1% pacientë nuk kishin njohuri për burim të infeksionit

Strukturë të ngjashme kemi fituar edhe me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe gjinisë. Kjo korespondon me të dhënrat e Agjensionit Statistikor Kosovar ku grup mosha 15-34 vjeç mer pjesë me 32% apo 1/3 e numrit total të popullsisë në Kosovë. Ky kontakt direkt i përfshinë qoftë blegtorët, fermerët, barinjët, amviset, personat që miren me therjen e kafshëve, qethjen e tyre, tregëtarët e kafshëve si edhe veterinarë e teknikë të veterinarisë (30, 214, 220, 224, 225).

Ky rezultat që prezenton prekjen e grup moshës më të re në Kosovë siç e thamë edhe më lartë dhe njëkohësisht më aktive në punë ndërlidhet me ruajtjen dhe kujdesin e bagëtisë, punë kjo që bëhet në ndihmë prindërve apo familjes apo edhe në ferma private të kafshëve ku shumë të rinjë gjatë pushimeve sezonale punojnë për pagë mujore në ferma të ndryshme, edhe kjo mënyrë e ndihmës familjare.

Në Iran hasim grup moshën më të shpeshtë, 15-24 vjeç por autorë të shumtë në studimet e tyre japin konkludime të grup moshave të ndryshme si përshebull, në Greqi është karakteristikë grup mosha 40-49 vjeç që eshtë dukshëm më e vjetër se në studimin tonë.

Në Turqi ishte grup mosha 46-60 vjeç sipas autorit Aydin, në Bosnjë dhe Hercegovinë grup mosha më e shpeshtë është 35-45 vjeç (219,225, 234, 235).

Ndërsa, 10.5% kanë konsumuar qumësht dhe produkte të qumështit të kontaminuar posaçërisht djathin e dhive nga qumështi i pa pasterizuar i cili njihet si djathi më i shijshëm dhe delikatesë.

Këta pacientë ishin më shumë të profesionale intelektuale, nënpunës dhe penzioner.

Një studim në Bosnjë dhe Hercegovinë mes viteve 2001-2008, ka prezantuar si rrugë kryesore të transmisionit konsumimin e qumështit dhe produkteve të papasterizuara të qumështit (234).

Gjithashtu edhe në një studim 1 vjeçarë në pjesën juglindore të Turqisë, ingjestioni alimentarë ishte rruga kryesore e transmisionit ashtu si edhe në shumë vende tjera të botës (236, 237, 238).

Mirëpo, panjohuri për burimin e infeksionit kishin 41.1% pacientë.

Për këtë numër të rasteve me panjohuri në burimin e infeksionit ndoshta mund të ndërlidhem me të dhënrat e literaturës që mund te jetë transmisioni nga ambienti i kontaminuar me brucela. Është vështirë të dokumentohet, por me gjasë ndodh më shpesh se që është e njohur. Kafshët e infektuara

të cilat kalojnë nëpër zonat e populluara ose mbahen afër shtëpisive mund të prodhojnë kontaminim të lartë të rrugëve, oborreve dhe vendeve ku mbahen tregjet, posaqërisht nëse aty ndodhin abortet e tyre. Nga kjo mund të rezultojë inhalimi i brucelave si pasojë e ekspozimit ndaj pluhurit të kontaminuar me fekalie të thara. Infekzioni mund të zhvillohet edhe me kontaminimin e lëkurës dhe të konjuktivave nga sipërfaqet e ndotura. Burimet e ujit siq janë puset, gjithashtu mund të jenë të kontaminuara nga abortet e kafshëve ose me anë të qarkullimit të ujit të shiut nga zonat e kontaminuara (32,33,34,35, 36, 37).

Por, ka raste kur nuk e tregojnë aktivitetin e tyre të punës me kafshë sidomos studentët për arsyetë ndryshme personale, që si punë sezonale zgjedhin fermat e mëdhaja apo ndoshta në vendet pitoreske rurale, apo edhe në restorane ku ofrohet më shumë ushqim fshati si më joshës, ekziston mundësia e marjes së infeksionit.

Pjesa më e madhe e pacientëve, 15,3 % ishin të hospitalizuar gjatë muajit qershor, ndërsa 14,5% në muajin shtator. Kjo sezonë, koincidon me pikun e periudhës së aborteve dhe lindjeve të kafshëve në ferma në stinën e verës, prandaj ekspozimi është shumë i madhë ndaj organeve dhe indeve të kafshëve të infektuara si dhe konsumimi i qumështit të tyre.

Kjo i përket më shumë vendeve me klimë të butë dhe të ftohtë siq është vendi i ynë perkundër që në vendet tropikale dhe subtropikale, ku mbarësimi i kafshëve zgjatë gjatë tërë vitit, nuk ka influencë sezonale në incidencën e brucelozës (33, 33, 34, 35, 36, 37).

Ngajshmëri me këtë rezultat kemi hasur në publikime të shumë autorëve të jashtëm si dhe nga të dhënat e literaturës (39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 219).

Rastet me brucelozë ishin të profesioneve të ndryshme, 30.6% ishin nxënës (më së shumti të nivelit shkollor të mesëm), 19.4% amvise, 11.3% bujqë ose blegtori, 6.5% punëtorë, 4.0% pensionist, 4.0% nëpunës, 3.2% studentë, 2.4% fëmijë parashkollarë, nga 1,6% veterinarë ose teknik i veterinerës dhe kuzhinier, 1.6% të papunë, nga 0.8% kamarier, portir, tregtar dhe vozitës.

Në punimet e shumë autorëve të huaj rastet me brucelozë i kanë prezantuar me numër më të madhë amviset ose fermerët për dallim nga studimi ynë, kjo për shkak se në vendin tonë moshat e reja kanë kontakt të shpeshtë me kafshët shtëpiake, duke ju referuar përqindjes më të madhe të popullatës së re rurale (27, 189, 234).

Sipas të dhenave anamnestike të pacientëve, 31.5% kanë pasur anëtarë tjerë në familje me brucelozë, kjo nënkupton epidemi familjare. Të dhëna të ngjashme gjemë në shumë publikime të huaja (144,145, 192, 242).

Sipas një studimi në Maqedoni, 54.5% e pacientëve të tyre kanë qenë me anamnezë pozitive familjare që nënkupton përqinje më të lartë se studimi ynë, pastaj sipas autorit Buzgan, 17.8% (189, 204).

Kohëzgjatja mesatare e hospitalizimit të pacientëve të përfshirë në hulumtim ishte 28.8 ditë, rangu 2 deri 83 ditë. Kohëzgjatja mesatare e hospitalizimit të pacientëve të gjinisë femërore të përfshirë në hulumtim ishte 29.5 ditë, rangu 3 deri 77 ditë, ndërsa te pacientët e gjinisë mashkullore ishte 28.4 ditë, rangu 2 deri 83 ditë. Pra, nuk fituam dallim singifikant statistikor sipas gjinisë ( $P>0.05$ ). Kemi analizuar kohëzgjatjen e hospitalizimit edhe sipas moshës dhe ka rezultuar se nuk ka dallim signifikant ( $P=0.063$  ; borderline) ndërsa kohëzgjatja e hospitalizimit sipas viteve rezultoi me dallim signifikant ( $P$  value=0.012) meqë në vitin 2011 pacientët kanë qëndruar më gjatë në klinikë 37.3 ditë në krahasim me vitet tjera.

Në një publikim të autorëve nga Kuvajti prezentojnë kohëzgjatjen mesatare të hospitalizimit 8 ditë, njëjtë edhe në Bangladesh ndërsa në Egjipt 4 ditë. Mesatarja e hospitalizimit në një studim Turk ishte 21.2 ditë. Mesatarja e qëndrimit në spital në një publikim të autorëve nga Izraeli ishte 6.7 ditë. Në një studim grek nga autori Podrimatas, pacientët me brucelozë dhe që kanë pasur ndërlikim orhiepididimitin, mesatarja e qëndrimit në spital ka qenë 7.11 ditë.

Sipas një prezentimi tjetër të autorëve nga Izraeli mesatarja e kohëzgjatjes së hospitalizimit ka qenë 7.6 ditë ndërsa e diagnostikimit 2 ditë.

Autorja e prezentimit të Dr. Satran ka thënë, citat: "Brucellosis carries a good prognosis and [too] much ... testing and hospitalisation are occurring unnecessarily," said Robert Satran, MD, Soroka University Medical Center, Beer-Sheva, Israel. Sipas tij hospitalizimet e gjata janë të panevojshme dhe kosto e lartë e shëndetësisë shtetërore (186, 192, 220, 221, 222).

Me mesatare të madhe të kohëzgjatjes së hospitalizimit kemi hasur në studimet e bëra në pacientë me endokardit brucellarë, si për shembull një studim 6 vjeçar i 10 pacientëve në një klinikë të Turqisë ku mesatarja e hospitalizimit ka qenë 52.6 +/- 11.2 ditë.

Në Angli, në një analizë dyvjeçare të viteve 2002-2003, në Departamentin e Shëndetësisë është konkluduar që mesatarja e kohëzgjatjes së hospitalizimit është 19.3 ditë. Në një studim tjetër Turk të vitit 2003 mesatarja e kohëzgjatjes se hospitalizimit ishte 22.5 ditë (223, 224, 225).

Kohëzgjatjen të madhe të hospitalizimit te ne për dallim prej shumë vendeve tjera, mund ta argumentojmë së pari me diagnostikimin jo shumë të shpejtë në brucelozë.

Një fakt tjetër janë edhe sëmundjet tjera shoqëruese dhe që në ndërkohë kryejmë edhe shërbime gjegjësish trajtime të atyre sëmundjeve kronike dhe metabolike.

Për 92.7% të rasteve me brucelozë ky ishte spitalizimi i parë në klinikën infektive, 5.6% spitalizimi i dytë dhe 1.6% spitalizimi i tretë. Me këtë analizë nuk kemi fituar dallim me singifikancë të rëndësishme statistikore në mes numrit të hospitalizimeve në bazë të gjinisë ( $P>0.05$ ).

Para hospitalizimit të pacientëve në klinikën Infektive në Prishtinë, 29% e tyre kanë qenë të shtrirë dhe janë diagnostikuar paraprakisht me brucelozë në klinika dhe spitale tjera regionale prej të cilëve më së shumti ishin në klinikën e Ortopedisë dhe në klinikën e Reumatologjisë me nga 8% e tyre. Kjo arsyetohet ngase ankesat kryesore nga ana e sistemit osteoartikular te këta pacientë ka bërë që nga mjekët e tyre familjarë të udhëzohen fillimisht në këto klinika. Këtë praktikë e gjejmë edhe në studim të autorit Mangalgi në Indi (212).

Të diagnostikuar me brucelozë në mënyrë ambulantore dhe pastaj të deleguar te ne ishin 49% ndërsa 10% janë pranuar si gjendje febrile me etiologji të panjohur, të tjerët ishin të dyshuar dhe në observim për brucelozë.

Në një analizë nga autorë Izraelit 43% e pacientëve të tyre janë pranuar në klinikë me diagnozë për dyshim në brucelozë ndërsa 59% kanë qenë paraprakisht të diagnostikuar me brucelozë, numër ky i përafërt me rezultatin tonë (220).

Mesatarja e ditëve me ankesa te femrat ishte 65.6 ditë ndërsa te mashkujt është 54.9 ditë, fituam  $P=0.605$  do të thotë pa dallim signifikant.

Shikuar sipas viteve, mesatarja e ankesave para hospitalizimit gjithashtu ka rezultuar me dallim signifikant me  $P= 0.045$ , me mesatare më të lartë në vitin 2007 me 89 ditë pastaj viti 2009 me 78 ditë.

Ndoshta një kohëzgjatje e tillë mund të ndërlidhet me neglizhencën e të sëmurëve ndaj gjendjes së tyre shëndetësore apo të konsideruar si “ftohje” apo gjendje gripale. Gjithashtu, edhe vështirësitë më të mëdhaja të transportit në vitet e kaluara nga regionet rurale për udhëtimin me kohë të personave të sëmurë konsiderohet si arsyë relevante. Këtu mund ti referohemi edhe të dhënavë nga literatura kur është fjala për formën e lehtë apo abortive të brucelozës që është mjaft e shpeshtë në

mbi 50% të rasteve sipas disa studimeve. Kjo formë karakterizohet me tablo klinike të një infekzioni banal ose të një gripi, me temperaturë të lartë dhe me një syndromë diskrete myoartralgjike (76).

Por, ka edhe raste kur janë të vizituara në ambulanta të afërta dhe nuk udhëzohen për testim në brucelozë, trajtohen me terapi të ndryshme duke u maskuar simptomet dhe shenjat klinike të pacientit.

Sipas autores Anna S. Dean me koautorë kanë konkluduar mesataren e ankesave para diagnostikimit dhe trajtimit 40 ditë, mirëpo rastet me lokalizime osteoartikulare kanë mesatare më të gjatë të ankesave deri në 6 muaj.

Shikuar mesataren e ankesave te pacientët në vende tjera, gjejmë që në Tuzla, në Bosnën qëndrore ishte 37.54 ditë, në një studim Bullgar ishte 115 ditë.

Sipas ecurisë klinike, pacientët me ecuri akute ishin 79%, subakute 18.6% dhe formë kronike në 2.4% të rasteve. Relapset u manifestuan në 6.5% të rasteve (202).

Në një studim maqedon, relapset u manifestuan në 17.5% të rasteve, pastaj në Gjeorgji u regjistruan në 14.7%, në Turqi 3.2%, në Tuzla të Bosnës qëndrore me 14.2% (27, 234, 240).

Të dhënat tona përkojnë me shumë autorë të tjera (189).

Pacientët me ecuri akute, simptom dominant kishin artralgjinë në 86.7%, prej tyre me lëvizje të kufizuara në 48.9% të rasteve dhe me kokëdhembje 12.2%, djersitje në 69.3%, lodhje dhe plogshti në 65.3%, temperaturë në 61.2% e shoqëruar me ethe në 54% të rasteve.

Ngajshmëri gjejmë me të dhënat e autorit Bosilkovski, cili prezanton artralgjinë në 81.8% të rasteve akute dhe 71.5% djersitjen si simptome më të shpeshta (204).

Në një studim turk gjejmë artralgjinë në 73.7% të rasteve akute si simptom kryesor (189).

Bruceloza është sëmundje multisistemike, mund të atakojë të gjitha organet.

Si forma më të rralla të lokalizimit ndryshimet në lëkurë te bruceloza lajmërohen në rreth 5% të të sëmurëve (76). Në 4% të pacientëve tanë gjetëm manifestime makulopapuloze. Në një studim turk, gjejmë 2.4% raste me manifestim të ekzantemave (189).

Sa i përket ndërlikimeve, sistemi osteoartikularë i evaluar me imazheri në 51,6% të pacientëve, ishte lokalizimi më i shpeshtë në 41.9% të rasteve. Ato u evaluuan me ekzaminime imazherike siq janë me ehosonografi të artikulacioneve koksofemorale, radiografi konvencionale që punohen në klinikën tonë, më rrallë është përdorur tomografia e kompjuterizuar, rezonanca magnetike,

scintigrafia e kockave (arsye të ndryshme, në rend të parë vështirësitet teknike në atë periudhë kohore).

Autori Bosilkovski në studimin e tij prezentoj 59.2% të rasteve me ndërlikime osteoartikulare (240). Sipas literaturës, lokalizimi osteoartikular lajmërohet në 20-85% të të sëmurëve me brucelozë në të gjitha fazat e sëmundjes (80,81).

Proçesi në artikulacione më së shpeshti fillon si synovit prej nga infekzioni përhapet në sipërfaqet artikulare të vetë kockës, duke kaluar fazat nga artroza dhe skleroza e skajeve deri në erozionet e vogla ose të mëdhaja në kocka.

Lokalizimi më i shpeshtë osteoartikularë i brucelave është në formë të sakroiletit. Manifestimi është me dhembje në kofshë, e nganjëherë përhapet përgjatë tërë këmbës duke e imituar ishialgjinë. Arsyja e atakimit më të shpeshtë të artikulacionit sakroiliak është vaskularizimi më i dobët në këtë regjion (82, 84, 85).

Në studimin tonë evidentuam synovitin koksofemoral në 20,2% të rasteve si manifestim më i shpeshtë i ndërlikimeve osteoartikulare, pastaj Sakroileiti në 6.5% të rasteve. Rezultate të ngjajshme gjejmë edhe te shumë autorë tjerë (189, 234, 240).

Në studimin tonë kemi gjetur 4,0 % të rasteve me lezione radikulare të nivelit lumbosakral dhe 0,8 % me polineuropati.

Në literaturë janë të përshkruara rastet me radikulite brucelare të plexusit lumbo-sakral dhe brahial (97, 96, 99, 100, 101) si dhe polineuropatitë brucelare (96, 102).

Meningjiti brucelarë mund të lajmërohet si akut, rekurent, tranzitor dhe kronik (84, 86). Te forma akute e meningjxitit lëngu trunoshpinor është i kthjellët, me pleocitozë limfo-monocitare të moderuar, hiperproteinorahi dhe hipoglikorahi.

Në studimin tonë ishin 1.6% e rasteve me meningjit akut, me pleocitozë të moderuar me hiperproteinorahi dhe hipoglikorahi jo të theksuar.

Që të dy rastet ishin mosha të rritura një femër dhe një mashkull, një me ecuri akute dhe një subakute. Ndërsa 4.7% e pacientëve kishin syndrom depressive me dominim të mashkujve. Çregullimet psikiatrike konsiderohen më të shpeshta në vendet endemike andaj duhet pasur parasysh si diagnozë diferenciale në këto regjione edhe brucelozën. Depresioni sipas një studimi në Egjipt është evidentuar në 29.2% të rasteve (239).

Lokalizimi genito-urinar është i rrallë në 5-10% të rasteve në formë të nefritit intersticial, pyelonefritit akut, glomerulonefritit eksudativ dhe nefropatisë IgA (106), prostatitit (105)

orhiepididimitit në 20% dhe mund të zhvillohen atrofitë e tubuleve seminifere ose edhe më rrallë në formë të endometritit dhe adneksitit ose absceseve të pevikut (106).

Në studimin tonë lokalizimi i këtij trakti ishte shumë i vogël me vetëm 1 (0.8%) pacientë me orhiepididimit. Në një studim turk gjejmë të dhëna për 3.4% të rasteve me orhiepididimit (189).

Si pasojë e afinitetit të bacileve të brucelozës ndaj endotelit të vazave të gjakut mund të lajmërohen: tromboza e e enëve të gjakut të trurit, më rrallë tromboza e enëve të gjakut të palcës kurrizore, tromboflebiti i enëve të gjakut të ekstremiteteve sidomos atyre të poshtme (106).

Te rastet tona u diagnostikuan 1.6% e moshave adulte me trombozë të ekstremiteteve të poshtme gjegjësisht një rast me trombozë në venën femorale dhe një në venën popliteale, që të dy rastet mashkuj njëri me ecuri akute dhe tjetri subakute të sëmundjes.

Ndërlikimet brucelare në sistemin respirator u zhvilluan në 11,3% me Bronchopneumoni dhe 2,4 % me Pneumoni të të sëmurëve (7). Rruja më e shpeshtë e infekzionit është aerogjene e më rrallë hematogjene gjatë sepsës. Mund të lajmërohen të gjitha format e brucelozës dhe atë si: bronkit, bronkopneumoni, pneumoni, pleurit, empiem, efuzion pleural, absces pulmonal. Të gjeturat më të shpeshta rëndgenologjike janë bronhopneumonitë perihilare, intersticiale dhe pneumonitë bazale. Në studimin tonë, incidenca e involvimit pulmonar arrin 13.7%, që paraqet një përqindje të lartë. Manifestimet respiratore akoma konsiderohen të rralla si formë e lokalizuar e brucelozës, zakonisht rrallë janë serioze.

Megjithëse në periudhën e studimit tonë nuk është punuar hemokultura në brucela, përvëq imazherisë kryesisht radiografisë që u shërbyem për evaluim, në këto raste përjashtuan me sputum dhe me PPD  $\beta$  testin tuberkulozin, infekzionet streptokoksike, dhe me serologji mykoplasma pneumonie, infekzionet me klamydie si dhe legionella pneumofilia.

Komplikacion tjetër mund të zhvillohet anemia me hipersplenizëm, leukopenia dhe trombocitopenia si pasojë e veprimit hipoplastik në lozën eritocitare, leukocitare dhe trombocitare (29, 105).

Studimi ynë rezultoi, në 42.7% të rasteve vlerat e eritrociteve kanë qenë të zvogluara ku te 59.1% ishin femra, do të thotë me dallim signifikant sipas gjinisë,  $P<0.05$ , ndërsa 33.1% të rasteve ishin me vlera të ulura të hemoglobines, por pa dallim signifikant sipas gjinisë  $P>0.05$ .

Në 12.1% të rasteve vlerat e leukociteve kanë qenë të- ulura, pa dallim signifikant sipas gjinisë,  $P>0.05$ , e në 5.5% të rasteve vlerat e trombociteve (të punuara në 72 raste) kanë qenë të ulura dhe atë vetëm te gjinia mashkulllore,  $P>0.913$ .

Konkludojmë që pacientët tanë nuk patën incidencë të anemisë, leukopenisë dhe trombocitopenisë më të lartë se sa në studime të autorëve të huaj siq të është nga autorë të Iranit, tek të cilët gjemjë anemi në 52.1% të pacientëve që te ne është përqindje e përafërt sidomos me gjininë femërорë ndërsa leukocitet dhe trombocitet në shumicën e pacientëve ishin në vlera normale raport ky i ngjajshëm me studimin tonë (27, 189, 234, 243).

Analiza e markerëve inflamatorë në studimin tonë rezultoi me, 73.4% të rasteve me vlerat të larta të sedimentacionit, por pa dallim signifikant sipas gjinisë  $P>0.05$ , ndërsa proteina C-reaktive e punuar në 81 pacientë, ishte e lartë në 79.0% me dallim signifikant sipas gjinisë  $P<0.04$ . Të dhëna të ngjajshme gjemjë te shumë autorë të huaj ( 217, 220, 243).

Sa i përket vlerave të hepatogramit, në 3.2% të rasteve vlerat e bilirubinës totale ishin të rritura çka i përgjigjet edhe numrit të rasteve me ikter, ndërsa elevim të vlerave të AST dhe ALT ishin në 48.4% dhe 26.6% të rasteve, pa dallim signifikant sipas gjinisë,  $P>0.05$ .

Sipas literaturës, çrregullimi i funksionit të mëlçisë mund të gjendet te rrith 50-70% të të sëmurëve me hepatomegali, si dhe rritja e vlerave të transaminazave për shkak të zhvillimit të nekrozës së hepatociteve. Çrregullimi i metabolizmit të bilirubinës është më i rrallë (103).

Me ehosonografi të abdomenit të punuar në klinikën tonë u evidentuan 45.7% e rasteve me hepatomegali, 12% me splenomegali dhe 9.8% me hepatosplenomegali.

Sipas literaturës, te 25-50% e të sëmurëve zhvillohet hepatomegalia. Melçi është lehtë e rritur, e butë, e lëmuar, lehtë e ndijshme në prekje (103). Ndërsa splenomegalia mund të zhvillohet në të gjitha fazat e sëmundjes dhe është mjaft e shpeshtë 20-66% (105).

Sa i përket analizave serologjike të brucelozës, në këtë peridhë 6 vjeçare u shërbymë me test të aglutinimit të shpejtë dhe reaksionin Wright. Në këtë periudhë kohore në Departamentin e Mikrobiologjisë në Prishtinë akoma nuk punohej ELISA testi dhe hemokulturat për brucelozë.

Sidoqoftë, në 28.2% të rasteve gjetëm titrin Wright 1:2560, në 26.6% ishte 1:1280 dhe 1:640, në 13.7% të rasteve 1:320, 7.3% me 1:160 dhe në 0.8% ishte 1:80.

Sipas analizës së korrelacionit mes moshës dhe grupeve sipas titrit Wright ka rezultuar pa dallim signifikant,  $P$  value=0.359.

Sa i përket pacientëve të moshës kontinuele por edhe të moshave kategorike nuk ka dallim moshor signifikant në mes pacientëve me limfadenit dhe atyre pa limfadenit., $P=0.08/P=0.119$ .

Mesatarja e numrit të leukociteve në mes të pacientëve me ndërlilikime dhe atyre pa ndërlilikime nuk ka dhënë dallim signifikant,  $p=0.147$ .

Gjithashtu edhe mesatarja e vlerës së CRP në mes të pacientëve me ndërlikime dhe atyre pa ndërlikime nuk rezultoi me dallim signifikant  $P=0.694$ .

Në analizat tona të mëtejme, nuk fituam dallim signifikant të mesatares së aspartat-aminotransferazës në mes të pacientëve me ndërlikime dhe atyre pa ndërlikime ( $P=0.558$ ) si dhe të mesatares së vlerave të alanin-aminotransferazës ( $P=0.980$ ).

Me T test, nuk fituam dallim signifikant të trombociteve në mes të pacientëve me ndërlikime dhe atyre pa ndërlikime,  $P=0.073$ .

Sipas korrelacionit Spearman fituam korrelacion pozitiv por jo signifikant (në kufi) në mes të mesatares së sedimentacionit dhe kohëzgjatjes së hospitalizimit. Koeficienti i korrelacionit është  $P=0.058$ .

Titri Wright i pacientëve i punuar në 54% të rasteve, 2 jave pas fillimit të trajtimit me antibiotikë tregon që 52.2% e tyre kishin ulje pas fillimit të trajtimit, në 32.8% titri ishte akoma i njëjtë ndërsa në 14.9% të pacientëve ka pasur akoma ngritje.

Konsiderojmë që kjo ulje e titrit Wright te  $\frac{1}{2}$  e pacientëve të ritestuar pas fillimit të terapisë është rezultat i mirë që dëshmon një benefit pozitiv të trajtimit të brucelozës kur ka diagnostikim të shpejtë, aplikim të terapisë me kohë, regjim i kombinuar terapeutik, dozim adekuat dhe kohëzgjatje adekuate të terapisë.

Ndërsa titri Wright në rritje te 14.9% mund të supozojmë që sëmundja ka qenë në zhvillim e sipër andaj edhe titri krahas saj ka qenë në rritje, kjo duke iu referuar ecurisë akute.

Sipas gjinisë titri Wright pas dy javësh është analizuar me Chi-square testin dhe rezultoi pa dallim signifikant në mes të femrave dhe mashkujve  $P=0.581$ .

Sa i përket koinfektioneve, patëm 2 pacientë me Tularemi me titër 1/320.

Ajo që duhet thënë është që në këto dy raste terapia e cila është ordinuar për trajtim të brucelozës ka veprim si linjë e parë e trajtimit edhe të tularemisë e që janë aminoglikozidet, tetraciklinet, fluorokinolonet.

Në këtë rast trajtimi ka qenë me streptomicin dhe doksiciklin, në fakt ishin dy sëmundje me një trajtim terapeutik.

Një pacientë 14 vjeç i cili ishte i hospitalizuar për herë të dytë me relaps të brucelozës fitoi infekcion të veshit të mesëm supurativ streptokoksik dhe gjendje të septikemisë me lokalizim septik supurativ në artikulacionin kokso femoral të majtë. Në punksionin e lëngut synovial me

ekzaminim mikrobiologjik gjetëm streptococcus pneumoniae i cili në realitet është edhe shkaktari i parë etiologjik i otiteve supurative.

Ky pacient i është nënshtuar intervenimit kirurgjik ortopedik, është trajtuar me antistreptokoksikë dhe më pas rihospitalizohet në klinikën tonë për të vazhduar më tej terapinë antibrucelare, streptomycin dhe doksiciklin 3 javë duke e vazhduar doksiciklinën me rifampicin.

Koinfektion tjetër kemi pasur një pacient të moshës 17 vjeç tek i cili titri Wright ishte 1/320 por që nga punktati i aspiruar në artikulacionin koksofemoral, në baciloskopji direkte dhe Löwenshtajn, u izolua bacili i Kochut.

Në këtë rastë është bërë artrotomia dhe më pas trajtimi antituberkułarë.

Supozojmë që dy pacientët me lokalizim brucelar në artikulacionin kokso femoral kanë pasur “*locus minoris rezistentie*” të zhvilluar paraprakisht në këto regjione anatomike, të cilat nuk kanë vaskularizim të madhë andaj edhe bakteret sekondare kanë zhvilluar më lehtë supuracione. Më pas kishim një pacient me hepatit kronik B dhe dy pacientë me cystit (*E. coli* dhe *Citrobakter species*).

Bruceloza është sëmundje zoonotike e cila haset edhe gjatë shtatëzanisë. Kjo sëmundje mund të zhvillojë abort te gruaja shtatëzënë, infeksion kongjenital dhe neonatal si dhe infeksion të mundshëm të ekipit mjekësor që bën lindjen. Trajtimi i gruas shtatëzane është mjaft sfidues por që duhet të fillojë menjëherë me kombinim të rifampicinës dhe TMP/SMX, me qëllim që të prevenohen ndërlikimet e mundshme (107).

Përndryshe dy paciente ishin gravide ( ml IV / Vlll) dhe një lehonë.

Besohet se abortin spontan bruceloza humane e shkakton më rrallë se sa te kafshët për shkak të mungesës së erythritolit në placentën humane dhe në fetus. Si arsyet plotësuese për rolin e vogël të infeksionit me brucelozë në abortet humane është prezencia e aktivitetit anti-brucelarë në lëngun amniotik human. Incidenca më e madhe e abortit është në trimestrin e parë dhe të dytë të shtatëzanisë gjatë brucelozës aktive (109).

Ne kemi testuar keto tri raste si dhe foshnjet e tyre 1 vit pas lindjes dhe kanë rezultuar me rezultate negative të titrit Wright.

Qëllimi i terapisë kundër brucelozës është që të menaxhojë simptomet sa më shpejtë që është e mundur për të prevenuar ndërlikimet dhe relapse. Trajtimi i brucelozës humane duhet të përfshijë antibiotikët të cilët penetrojnë makrofagët dhe mund të veprojnë në mëdis acidik mbrendaqelizor (242). Regjimi i kombinuar i terapisë antimikrobiqe është shtyllë e trajtimit ngase me qasjen e

monoterapisë janë raportuar numër i madhë i rasteve me relapse (161,200). Në vitin 1986, Organizata Botërore e Shëndetësisë ka lëshuar një udhërëfyes për trajtimin e brucelozës. Sipas këtij udhërëfyesi janë dy regjime, në të dyja aplikohet doksiciklina gjashtë javë, në kombinim ose me streptomycin për tre javë ose me rifampicin për 6 javë. Të dy kombinimet janë mjaft të popullarizuara në mbarë botën, edhe pse nuk përdoren në mënyrë univerzale. Streptomicina është më efektive në prevenimin e relapseve. Rifampicina rregullon nivelin e doksiciklinës në serum. Te pacientët e trajtuar ne klinikën Infektive më së shpeshti është ordinuar doksiciklina në 84.7%, pastaj rifampicina në 83.9% dhe streptomicina në 74.2% të rasteve.

Kortikoterapia u ordinua në 17.7% të rasteve, zakonisht te format me intoksikim të përgjithshëm më të rëndë dhe me lëvizje të kufizuara të artikulacioneve.

Në 1.6% të rasteve ordinuan antikoagulantë për shkak të dy rasteve me trombozë.

Sa i përket kombinimit të antibiotikëve, 72.6% e rasteve janë trajtuar me tre javë streptomycin dhe doksiciklin, duke vazhduar më tej së paku edhe katër javët tjera me doksiciklin dhe rifampicin.

Ndërsa vetëm një rast ka qenë trajtuar me doksiciklin si monoterapi në vitin 2006 tek i cili janë zhvilluar dy relapse.

Shikuar të dhënat e autorëve të huaj, kemi të dhëna të ndryshme siq është ai i autorit Bosilkovski me koautorë (240).

Sipas Keren Skalsky me koautorë, regjimit terapeutik të kombinuar streptomycin me tetraciklin për dallim nga kombinimi tetraciklin me rifampicin, i japin vlerësim superior por që nuk e prezentojnë gentamicinën inferiore ndaj streptomycinës. Sipas tyre trajtimi optimal me streptomycin është 2 javë.

Si zëvendësim të doksiciklinës i rekomandojnë tetraciklinet të cilat kanë kosto më të ulët edhe pse rekomandimi primar është doksiciklina (16).

Autori grek Panos Andriopoulos në studimin e tij ka prezantuar trajtimin e moshave mbi 14 vjeç me 1 gram streptomycin intramuskular 21 ditë dhe 2 muaj me doksiciklin. Ndërsa moshat nën 14 vjeç janë trajtuar me terapi orale rifampicin dhe TMP/SMX për 6 javë. Rezultatet e tyre janë prezantuar me vetëm 3% relapse (241).

Në një punim tjeter në Kuvajt gjemë trajtim me kombinim të rifampicinës dhe doksiciklinës te të gjithë pacientët përveq te ata me neurobrucelozë të cilët në 14 ditët e para janë trajtuar me streptomycin intramuskular. Rezultatet e këtij trajtimit kanë treguar largim të simptomeve 5 -15 ditët e para të trajtimit (186).

Sipas autorit autorit Wafa Al-Nassir, edhepse antibiotikët e shumtë jepin rezultate të mira in vitro kundër brucelave, përgjegjet klinike nuk janë të njëjta. Sipas tij, antibiotikët të cilët jepin shkallë më të vogël të relapseve janë: doksiciklina, gentamicina, streptomicina, rifampicina dhe TMP/SMX për dallim nga kloramfenikoli, imipenem-cilastatina, tigecyclina dhe fluororkinolonet. Mirëpo nëse ndodhin relapset nuk do të thotë që janë pasojë e rezistencës së brucelave ndaj tyre (161).

Andaj, konkludojmë që regjimi i kombinuar i tre antibiotikëve është i domosdoshëm, dhe atë si linjë e parë doksiciklin dhe rifampicin në kombinim me një aminoglyozid (streptomicin ose gentamicin). Ky është kombinimi më superior ndaj kombinimeve tjera.

Trajtimi duhet të ketë kohëzgjatje së paku 6 javë duke pasur për bazë fokusin e lokalizimit, gjendjen e përgjithshme të pacientit, analizat serologjike dhe hematologjike me ato biokimike dhe evaluimet imazherike.

Në fund të diskutimit, duhet të cekim që në studimin tonë u konstatua se ndërlikime të rënda të sistemit nervor qëndrorë nuk u regjistruan, nuk u evidentuan raste me endokardit ose me prekje të veshkëve dhe nuk patëm raste të letalitetit.

## V. PËRFUNDIME

1. Numri më i madh i rasteve të trajtuara në klinikën infektive në Prishtinë ishte në vitin 2010 me 28.2%.
2. Dominoi gjinia mashkullore me 64.5% dhe mosha mesatare e pacientëve me brucelozë ishte  $30.8 \pm 17.2$  vjeç.
3. Shumica e rasteve ishin nga pjesët qëndrore të Kosovës, ku vendbanimet rurale përfaqësojnë 67.7% të të diagnostikuarve me brucelozë.
4. Stina me incidencën më të madhe të paraqitjes së pacientëve ishte vera, piku në muajin Qershor me 15% .
5. Simptomat dominante ishte artralgjia në 68.5%. djersitja 54.8%, lodhja 51.6% dhe temperatura në 48.3% të rasteve. 79% e rasteve u trajtuan për brucelozë akute.
6. Pacientët paraqitën anemi, leukopeni dhe trombocitopeni. 73.4% e pacientëve shfaqën vlera të larta të sedimentacionit, ndërsa proteina C-reaktive, ishte e lartë në 79.0% me dallim signifikant sipas gjinisë.
7. Në 54% të rasteve ku u realizua titri Wright, 2 javë pas fillimit të trajtimit në 52.2% të pacientëve patëm ulje të titrit, në 32.8% titri ishte akoma i njëjtë ndërsa në 14.9% të pacientëve rezultoi i rritur.
8. Shkalla e prevalences së komplikimeve në mesin e 51,2% pacientëve të evaluuar për ndërlikime ishte 41,9%. Synoviti koksofemoral u manifestua në 20,2% të rasteve, Bronchopneumonia në 11,3% dhe Sakroileiti në 6,5% të rasteve.
9. Në 72.6% të rasteve është aplikuar regjimi terapeutik tre javë Streptomicin dhe Doksiciklin, me vazhdim të kombinimit Doksiciklin me Rifampicin edhe tre apo katër javë.
10. Për diagnostikimin e hershëm, diagnostikimin e komplikacionevedhe ndjekjen e tyre evidentuam mungesa të tillë si: ELISA Testi në brucela, Hemokultura, tomografia kompjuterike, resonancë magnetike, shintigrafia, të cilat luajnë rol thelbësor në ndjekjen e këtyre pacientëve.

## **VI. REKOMANDIME**

1. Duhet shmangur konsumimin e produkteve nga qumështi i papasterizuar si dhe konsumimin e mishit jo mirë të përpunuar termikisht
2. Aplikimi i masave parandaluese speciale në laboratore
3. Shëndeti publik duhet të promovojë edukimin për higjienën alimentare, higjienën profesionale si dhe të ekspozimeve tjera ndaj kafshëve shtëpiake
4. Rastet me artralgji me ose pa temperaturë nga vendet endemike, rekomandohet të testohen në brucelozë
5. Me qëllim të prevencës së relapseve, komplikacioneve dhe formave kronike, rekomandojmë diagnostikimin e sëmundjes me kohë dhe trajtimin me kombinim të tre antibiotikëve me dozim adekuat dhe kohëzgjatje së paku 6 javëshe.
6. Të aplikohet profilaksë pas ekspozimit 3-6 javë doksiciklinë ose TMP/SMX, me Rifampicin sipas rekomandimeve të BICHAT (the European Commission's Task Force on Biological and Chemical Agent Threats).

## VII. BIBLIOGRAFIA

1. World animal health data, including brucellosis in animals and humans, are contained in Handistatus II and are also available in a hardcopy publication entitled World Animal Health. This information is collected from Veterinary Services of OIE, FAO and WHO Member Countries by the OIE Central Bureau, Paris, France, using a joint annual questionnaire and can be accessed through the following address: <http://www.oie.int>
2. Baquero, F., 2012. Metagenomic epidemiology: a public health need for the control of antimicrobial resistance. *Clinical Microbiology and Infection*, 18(s4), pp.67-73.
3. Moreno, E., Stackebrandt, E., Dorsch, M., Wolters, J., Busch, M. and Mayer, H., 1990. Brucella abortus 16S rRNA and lipid A reveal a phylogenetic relationship with members of the alpha-2 subdivision of the class Proteobacteria. *Journal of Bacteriology*, 172(7), pp.3569-3576.
4. Akhvlediani, T., Clark, D.V., Chubabria, G., Zenaishvili, O. and Hepburn, M.J., 2010. The changing pattern of human brucellosis: clinical manifestations, epidemiology, and treatment outcomes over three decades in Georgia. *BMC infectious diseases*, 10(1), p.1.
5. Ferooz, J. and Letesson, J.J., 2010. Morphological analysis of the sheathed flagellum of *Brucella melitensis*. *BMC research notes*, 3(1), p.333.
6. Al-Anazi, K.A. and Al-Jasser, A.M., 2013. Brucellosis: A global re-emerging zoonosis clinical aspects, associations and brucellosis in specific conditions. *Bacterial and Mycotic Infections in Immunocompromised Hosts: Clinical and Microbiological Aspects*. Maria Teresa Mascellino (Ed). OMICS Group Incorporation, Foster City, CA.

7. Salata, R.A. and Ravdin, J.I., 1985. Brucella species (brucellosis). *Principles and practice of infectious diseases*. New York: John Wiley, pp.1283-90.
8. Alton GG, Forsyth JRL. In: Baron S, editor. *Brucella*. Medical Microbiology. 4th edition. Galveston (TX): University of Texas Medical Branch at Galveston; 1996. Chapter 28.
9. DelVecchio VG, et al., 2002. The genome sequence of the facultative intracellular pathogen *Brucella melitensis*. *Proc Natl Acad Sci USA* 99(1):443-448.
10. Paulsen IT, et al., 2002. The *Brucella suis* genome reveals fundamental similarities between animal and plant pathogens and symbionts. *Proc Natl Acad Sci USA* 99(20):13148-13153.
11. Halling SM, et al., 2005. Completion of the genome sequence of *Brucella abortus* and comparison to the highly similar genomes of *Brucella melitensis* and *Brucella suis*. *J Bacteriol* 187(8):2715-2726.
12. Chain PS, et al., 2005. Whole-genome analyses of speciation events in pathogenic *Brucellae*. *Infect Immun* 73(12):8353-8361.
13. Crasta OR, et al., 2008. Genome sequence of *Brucella abortus* vaccine strain S19 compared to virulent strains yields candidate virulence genes. *PLoS ONE* 3(5):e2193.
14. Seimenis A, Morelli D, Mantovani A (2006) Zoonoses in the Mediterranean region. Ann Ist Super Sanita 42: 437-445.
15. Hasanjani Roushan MR, Mohraz M, Hajihamdi M, Ramzani A, Valayati AA (2006) Efficacy of gentamicin plus doxycycline versus streptomycin plus doxycycline in the treatment of brucellosis in humans. Clin Infect Dis 42: 1075-1080.
16. Skalsky K, Yahav D, Bishara J, Pitlik S, Leibovici L, et al. (2008) Treatment of human brucellosis: systematic review and analysis of randomized controlled trials. BMJ 336: 701-704.
17. Cutler SJ, Fooks AR, van der Poel WH (2010) Public health threat of new, re-emerging and neglected zoonoses in the industrialized world. Emerg Infect Dis 16: 1-7.

18. Pappas G, Papadimitriou P, Akritidis N, Christou L, Tsianos EV (2006). The new global map of human brucellosis. *Lancet Infect Dis* 6: 91-99.
19. Donev D, Karadzovski A, Kasapinov B, Lazarevik V (2010) Epidemiological and public health aspects of brucellosis in the republic of Macedonia. *Prilozi* 31: 33-54.
20. Vassalo CM, Economou V, Vassalou E, Papadopoulou C (2009). Brucellosis in humans: why is it so elusive? *Rev Med Microbiol* 20:63-73.
21. Gwida M, Al Dahouk S, Melzer F, Rosler U, Neubauer H, et al. (2010) Brucellosis - regionally emerging zoonotic disease? *Croat Med J* 51: 289-295.
22. Seleem MN, Boyle SM, Srivanganathan N (2010) Brucellosis: a re-emerging zoonosis. *Vet Microbiol* 140: 392-398.
23. Russo G, Pasquali P, Nenova R, Alexandrov T, Ralchev S, et al. (2009) Reemergence of human and animal brucellosis, Bulgaria. *Emerg Infect Dis* 15: 314-316.
24. Farina F, Fuser R, Rossi M, Scotton PG (2008) Brucellosis outbreak in Treviso province caused by infected cheese from an endemic area. *Infez Med* 16: 154-157.
25. Al-Tawfiq JA, Abukhamsin A (2009) A 24-year study of the epidemiology of human brucellosis in a health-care system in Eastern Saudi Arabia. *J Infect Public Health* 2: 81-85.
26. Kadanali A, Ozden K, Altinparlak U, Erturk A, Parlack M (2009) Bacteremic and nonbacteremic brucellosis: clinical and laboratory observations. *Infection* 37: 67-69.
27. Akhvlediani T, Clark DV, Chubabria G, Zenaishvili O, Hepburn MJ (2010) The changing pattern of human brucellosis: clinical manifestations, epidemiology and treatment outcomes over three decades in Georgia. *BMC Infect Dis* 10: 346.
28. Annette H. Sohn, <sup>✉</sup>\* Will S. Probert, <sup>†</sup> Carol A. Glaser, <sup>\*†</sup> Nalin Gupta, <sup>\*</sup> Andrew W. Bollen, <sup>\*</sup> Jane D. Wong, <sup>†</sup> Elizabeth M. Grace, <sup>\*</sup> and William C. McDonald <sup>\*</sup> Human Neurobrucellosis with Intracerebral Granuloma Caused by a Marine Mammal *Brucella* spp. *Emerg Infect Dis*. 2003 Apr; 9(4): 485–488.

doi: 10.3201/eid0904.020576

29. Borivoje Sokolovski, Brucellosis; Skopje, 1990;44.
30. R. Jackson, L. Pite, R. Kennard, D. Ward, J. Stack, X. Domi, A. Rami, I. Dedushaj; Survey of the seroprevalence of brucellosis in ruminants in Kosovo The Veterinary Record, June 12, 2004(c) British Veterinary Association.
31. Muçaj, Sefedin; Kabashi, Serbeze; Gashi, Sanije; Kryeziu, R.; Hasani; Topographic Expansion of Brucellosis in Kosovo; June 2009 Materia Socio Medica;2009, Vol. 21 Issue 2, p75
32. Alton GG et al (1988). *Techniques for the brucellosis laboratory*. INRA, Paris.
33. Almuneef M, Memish ZA (2003). Prevalence of *Brucella* antibodies after acute Brucellosis. *Journal of Chemotherapy*, 15(2):148–51.
34. Corbel MJ, Beeching NJ (2004). Brucellosis, Ch 141. Pp. 914–917. In: *Harrison's Textbook of Internal Medicine*, 16th ed. McGraw-Hill, New York.
35. Corbel MJ (1999). *Brucella*. In: *Topley and Wilson's Microbiology and microbial Infection*, 9th ed. Balows A, Duerden BI, eds. Chapter 35, Volume II. Arnold, London.
36. Madkour MM (2001). *Madkour's Brucellosis*, 2nd ed. Springer, London.
37. Nielsen K, Duncan JR (1990). *Animal Brucellosis*. CRC Press, Boca Raton.
38. Kaufmann, A. F., M. I. Meltzer and G. P. Schmid, 1997. The economic impact of a bioterrorist attack. Are prevention and postattack intervention programmes justifiable? *Emerg. Infect. Dis.*, 3: 83– 94.
39. Supriya Christopher, Umapathy B L, Ravikumar K L. Brucellosis: Review on the Recent Trends in Pathogenicity and Laboratory Diagnosis Journal of Laboratory Physicians / Jul-Dec 2010 / Vol-2 / Issue-2
